



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 8 NËNTOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 8. NOVEMBRA 2012. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2012**

R e n d i i d i t ë s

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokaturën Shtetërore,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Regjistrimit Civil,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Auditimit për vitin 2011,
9. Ratifikimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e
Universitetit të Prizrenit dhe të Universitetit të Pejës,
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Ministrisë së Drejtësisë për formimin e
Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës,
11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me emërimin e
anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas.

D n e v n i r e d

1. Vreme za izjašnjavanje van dnevnog reda,
2. Vreme za skupštinska pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o stranim ulaganjima,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o državnoj advokaturi,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Agenciji za civilnu registraciju,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o vladinim organima i informatičkom društvu,
8. Razmatranje Godišnjeg revizijskog izveštaja za 2011. godinu,
9. Ratifikacija Odluke Vlade Republike Kosova za osnivanje Univerziteta u Prizrenu i
Univerziteta u Peći,
10. Razmatranje Predloga odluke Ministarstva pravde za formiranje Komisije za
polaganje pravosudnog ispita,
11. Razmatranje preporuke Zakonodavne komisije u vezi sa imenovanjem članova
Odbora za besplatnu pravnu pomoć.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hapi punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta. Në emër të grupit parlamentar 5 minuta, kurse në emër të deputetëve 3 minuta. E dini, replika nuk ka.

Vazhdojmë. Deputetët që i thërras për fjalë të tregojnë se në çfarë cilësie flasin. Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet, i nderuar ministër,

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Po flas në emrin tim dhe do ta shtroj një çështje që lidhet me Ngrohtoren e qytetit “Termokos”. Mbrëmë kam qenë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, në Prishtinë, dhe aty kam pa pacientë të shumtë, të cilët po vazhdojnë të përballen me probleme. Edhe pse kanë kaluar gati tri javë që nga fillimi zyrtar i sezonit dimëror të ngrohjes kolektive, ngrohësja e qytetit “Termokos” vazhdon të mos ofrojë shërbime për qytetarët e Prishtinës. Kjo gjendje i ka shqetësuar në masë të madhe qytetarët, të cilët thonë se kjo çështje po vazhdon të jetë çështja më problematike në këtë kohë.

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Në këtë kohë kur temperaturat në vend kanë shënuar rënie dhe kur meteorologët po paralajmërojnë dimër të ftohtë dhe të acartë, më së keqi po e pësojnë pacientët e shtrirë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, e veçanërisht Reparti i Pediatriisë, por edhe ai i Gjinekologjisë, në të cilët fëmijët e posalindur, por edhe lehonat, na ngrijnë nga të ftohtit. Do të thotë në këtë kohë të ftohtë kur “Termokosi” po përballlet me borxhet, por edhe me probleme financiare, e ka të pamundur të ofrojë shërbime për qytetarët. Qytetarët, duke mos pasur alternativë tjetër, kanë vendosur që të shkyçen nga kjo kompani, e cila, me gjithë faktin se nuk ka ofruar shërbime, nuk ka reshtur së dërguari fatura, me të cilat janë ngarkuar qytetarët e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë bëj thirrje nga kjo foltore e Kuvendit që kjo kompani t’i rregullojë një herë mirë problemet financiare që i ka dhe të ofrojë shërbime dhe këto probleme të mos jenë evidente, e veçanërisht ato nëna, ata fëmijë dhe ata të sëmurë në Qendrën Klinike Universitare, por edhe fëmijët e kopshteve në kryeqytet edhe ata në shkollat të mos

vazhdojnë të përballen edhe me të ftohtit që po mbretëron në këtë kohë në vend. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani, në emër të grupit.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kohëve të fundit, në veri të Kosovës është rritur numri i njerëzve të uniformuar, të cilët dyshohet se janë pjesë e strukturave ilegale, të mbështetura dhe të financuara nga Serbia.

Këto struktura që sipas dëshmitarëve, kryesisht shqiptarë, që jetojnë në veri, në disa raste janë edhe të armatosura, kanë ngrehur shqetësimet e qytetarëve shqiptarë dhe të të tjerëve që janë të komunitetit joserb në veri, të cilët të pambrojtur nga institucionet e Republikës së Kosovës po qëndrojnë nëpër shtëpitë e tyre dhe janë të vetmit që po e mbrojnë integritetin territorial të Kosovës tash e 13 vjet.

Mbrojtja e qytetarit është obligim kushtetues i institucioneve vendore. Prandaj, siguria e tyre nuk është një obligim që thjesht mund t'u bartet apo t'u hedhet institucioneve ndërkombëtare, përderisa ato vendore as nuk reagojnë për praninë e këtyre strukturave, që njihen me emrin "Civilna Zaštita" ("Mbrojtja Civile").

Në fillim të këtij viti, disa përfaqësues të serbëve të veriut të Kosovës patën konfirmuar edhe publikisht ekzistencën e kësaj mbrojtjeje.

Pavarësisht se çfarë roli luajnë ata dhe çfarë saktësisht janë funksionet e tyre, prania...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Tregova se në emër të grupit është. Fjala deputetes Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: ...e tyre e ka krijuar një pasiguri dhe ankth edhe më të madh te qytetarët shqiptarë dhe te qytetarët e komuniteteve tjera joserbe në atë pjesë të Kosovës.

Arrestimi i një qytetari serb në veri dhe dërgimi i tij në një gjykatë në Kralevë është edhe një nga rastet e shumta të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të Serbisë në Kosovë.

Institucionet e Kosovës, përveç që e kanë obligim mbrojtjen e jetës, pronës dhe lirisë së lëvizjes së atyre qytetarëve, duhet të reagojnë ashpër kundër kësaj ndërhyrjeje të vazhdueshme të strukturave të Serbisë brenda Kosovës, të cilat qartë e kanë për qëllim që ta përfundojnë projektin e tyre për spastrim etnik të asaj pjese nga shqiptarët.

Policia e Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Inteligjencës, si institucione që duhet ta garantojnë sigurinë e qytetarëve në tërë territorin e Kosovës, duhet t'i marrin këto shqetësime me seriozitet, e jo të injorojnë apo ta mohojnë ekzistimin e këtyre strukturave, siç kanë bërë. Dhe në përputhje me detyrat e tyre kushtetuese ligjore, t'i informojnë jo vetëm komisionet përkatëse parlamentare, por edhe publikun, në veçanti shqiptarët që

jetojnë në veri për veprimet e këtyre strukturave të quajtur “Mbrotja Civile”, si dhe për masat që po ndërmerren për t’i parandaluar veprimet e tyre dhe për ta mbrojtur jetën e qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit Thaçi po i pëlqejnë darkat. Para pak ditësh, një gazetë jona e përditshme tregoi se si kishte rënë në posedim të e-mail-eve të miqve ndërkombëtarë të kryeministrit Thaçi. Në këta e-mail-e zbulohet se si në një darkë kryeministri i kishte premtuar një kompanie të huaj se do t’ia shiste PTK-në dhe se do ta eliminonte një kompani tjetër, për pronarët e së cilës në media kryeministri ynë po ashtu na thotë se i ka miq të sinqertë. Kryeministri i ka të gjithë miq, pa dyshim. Veçse disa i eliminon në mënyrë të paligjshme. E disa të tjerë, të cilët e kanë korrupsionin shumë, siç duket, i bën miq më të mirë. Nuk e di nëse Prokuroria i ka ftuar gazetarët në fjalë për ofrimin e dëshmimeve për një rast kaq të rëndë, në të cilin kryeministri involvohet drejtpërdrejt në favorizimin dhe eliminimin e kompanive të huaja. Ai natën merret me këto punë, kurse ditën na flet për tregun e lirë të investimeve të huaja, për të cilat Kosova paska aq shumë nevojë.

Por, mbrëmë kryeministri e ka pasur po ashtu një tjetër darkë. Jo për pazarllëqet se si ta shesë pasurinë publike të Kosovës, por kësaj radhe pati darkë me vëllanë e vogël të Milosheviqit për një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Kjo Qeveri po na tregon dita-ditës se këta tashmë janë pajtuar me një autonomi për veriun. Kjo Qeveri nuk e ka hallin më se si ta shpëtojë veriun.

Kjo Qeveri e ka hallin se si t’ia shesë popullit më së miri kompromisin e ardhshëm. Qeveria jonë po hyn në këto negociata me Serbinë me Planin e Ahtisarit. E kjo është e mjaftueshme për ta kuptuar se kompromisi që do të vijë në fund do të jetë, sipas të gjitha gjasave, përtej Planit të Ahtisarit.

Vetë kryeministri këtu në Parlament na ka thënë se nuk ka shumë qejf të takohet me Daçiqin. Atëherë, shtrohet pyetja: Nëse ky takim nuk është me qejf, ku është zori pra? Prej nga vjen ky zor? A mos vjen ky zor nga fakti se Qeveria e kryeministrit i ka dosjet e korrupsionit në EULEX-in e Ketrin Eshtonit? Qeveritarët tanë e mbajnë pushtetin në kurriz të Kosovës dhe të popullit të saj. Këta njerëz pa pushtet janë zero. Krejt çka kanë këta është pushteti, të cilin e fitojnë në mënyrë të dyshimtë, e mbajnë me shtet policor, si dhe e shfrytëzojnë për t’u pasuruar dhe për ta ngrënë Kosovën. Mu sikur në darkën e mbrëmshme.

Në darkën e mbrëmshme është servuar vetëm një ushqim. Ky ushqim është Kosova. Këta njerëz i frikësohen një dite kur të mos e kenë pushtetin. Dhe, shtrohet pyetja: Pse frikësohen ata kaq shumë pa pushtet? A frikësohet njeriu i pastër, i ndershëm dhe i pakorrupsionuar?

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kjo që po na ndodh është turp, jo vetëm për Qeverinë. Kjo që po na ndodh është e turpshme edhe për opozitën. Në vend që opozita tash të bashkohet rreth një platforme të kushteve që duhet t'i mbajë Kosova në raport me Serbinë, partitë opozitare i bashkohen karvanit të Qeverisë, dhe ia japin kryeministrit gjithë mbështetjen. Thonë ne po ia japim mbështetjen, e nëse nuk i del fjalës, atëherë shohim. Po i besojnë njeriut që ishte në krye të manipulimit të zgjedhjeve; tha që nuk do të ketë negociata politike, e po i bën ato; tha që do ta bëjë sovranitetin, e nuk e bëri, e kështu me radhë. T'ia besosh këtij njeriu mbrojtjen e interesit të Kosovës, është sikur t'i besosh ujkut se do të t'i ruajë delet. Këso opozite do ta kishte ëndërruar çdo lider qeveritar autoritar, si tipi i Llukashenkos. Një opozitë që e përkrah Qeverinë blanko dhe gratis. Opozitë, e cila nuk e sfidon Qeverinë, por i nënshtrohet asaj.

Zonja dhe zotërinj,

Kryeministri Thaçi është njëfarë Azem Vllasi i kohës sonë. Ju e mbani mend Azem Vllasin. Kur ishte nevoja që ai ta mbronte autonominë, nuk e mbrojti as Republikën. Në këtë mënyrë, Hashim Thaçi nuk po e mbron as Planin e Ahtisarit, e lëre më Republikën e Kosovës.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Meqenëse sot dihet që nuk është debat për Projektbuxhetin e vitit 2013, po e shfrytëzoj mundësinë t'i shpreh shqetësimet e mia në lidhje me shpërndarjen e Buxhetit të Kosovës dhe me theks të veçantë ndërprerja e vazhdimit të magjistrales Prishtinë-Pejë, e cila është jetësore për një regjion të caktuar. Dhe, kjo ndërprerje, sipas këtij dokumenti, do të vazhdojë edhe në vitet pasuese. Ministri i Financave nuk është këtu. Por, ky është ndërrim i strategjisë së Qeverisë rreth infrastrukturës rrugore.

Në deklaratimet publike të Qeverisë së Kosovës është thënë që do të gjenden fonde jashtë buxhetit për rrugën Prishtinë - Hani i Elezit, e cila është paraparë në Projektbuxhetin për vitin e ardhshëm dhe kjo kosto fillestare do të jetë 29 milionë euro nga Buxheti i Kosovës. Ndërsa për magjistralen Prishtinë - Pejë - Gjakovë janë ndarë vetëm 6 milionë euro dhe atë vetëm për mirëmbajtje, pa u specifikuar destinimi i atyre mjeteve. Natyrisht, që kjo që unë po them sot në asnjë mënyrë nuk e zhvlerëson rëndësinë e rrugës Prishtinë - Hani i Elezit, dëshiroj të shpreh shqetësimin tim që nuk është hiç më pak e rëndësishme edhe magjistralla Prishtinë - Pejë - Gjakovë.

Me Projektligjin për buxhetin e vitit 2013, po ashtu kemi edhe 5 milionë euro investime të përbashkëta Qeveri - Komunë, e cila mban kodin 100/41, të cilat nuk sqarohen se për çfarë destinimi janë, e unë mendoj se këto mjete shumë lehtë mund të barten në investimet për magjistralen Prishtinë - Pejë.

Pa dashur të hyjë në detale rreth projektbuxhetit, ku gjendja më e keqe duket se është në shëndetësi, do ta kisha sugjeruar Qeverinë dhe me theks të veçantë Ministrinë e

Financave, që pas leximit të parë të projektbuxhetit të rishikohet edhe një herë mundësia e ndërrimit të destinimit të fondeve publike. Marrë në tërësi, Projektligji për buxhetin shihet se është një përshkrim nga viti i kaluar me disa ndryshime të vogla kozmetike në disa komuna perëndimore, por gjithsesi duke i diskriminuar projektet me rëndësi nacionale, siç është po ashtu magjistralia Prishtinë - Gjilan - Luginë e Preshevës.

Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa shpresoj se do ta marrin seriozisht shqetësimin të cilin e shtrova sot dhe do të gjejnë forma për vazhdimin e kësaj magjistraleje jetike për qytetarët e asaj pjese të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: I nderuari kryetar i Parlamentit,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,
Duke pasur parasysh dinamikën e punës së Kuvendit dhe ligjet e shumta që nxirren në kohë rekorde për krijimin e nevojshëm të infrastrukturës ligjore në vend, më lejoni që në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës t'i propozoj Kuvendit të Kosovës që në të ardhmen të shqyrtohet mundësia që të gjitha ligjet në fuqi, të cilat postohen në ueb-faqen e Kuvendit të Kosovës të bëhen edhe në versionin audio ose MP3, ku do të kenë mundësi që këto ligje t'i kenë në dispozicion edhe personat me aftësi të veçanta, në këtë rast personat e verbër, duke krijuar kështu qasje të barabartë për të gjithë.

Në këtë rast, komuniteti i të verbërve dhe ata me të pamur të dobësuar do të mund të njoftohen me të drejtat ligjore që u takojnë, sikur edhe qytetarët tjerë të Kosovës.

Duke u angazhuar në këtë drejtim, ne i plotësojmë kriteret themelore që kanë të bëjnë me të drejtën fundamentale për këtë komunitet të shoqërisë sonë.

Të nderuar deputetë,
Kjo kërkesë vjen si rezultat i takimeve të shpeshta që kemi me këtë komunitet dhe me përfaqësuesit e tyre. Në fund të fundit, e kemi obligim moral e mandatar që të angazhohemi që këta persona të mos ndihen të diskriminuar në asnjë mënyrë, por si pjesë e barabartë dhe e rëndësishme e kësaj shoqërie. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!
Unë dëshiroj ta ngre çështjen e Çarshisë së Vjetër në Gjakovë, e cila kohën e fundit po paraqet me të vërtetë një shqetësim për qytetarët e Gjakovës.

Dëshiroj të tregoj që Xhamia e Hadumit, Kisha e Shën Antonit të Padovës, dyqanet e vjetra në çarshi, hani, teqetë, Monumenti i Lidhjes së Prizrenit edhe shumë të tjera, në fakt, janë pjesë e kësaj Çarshie të Vjetër.

Çarshia e Vjetër është identitet i Gjakovës. Çarshia e Vjetër ishte ajo e para e cila në ditën e parë të luftës u shkatërrua, u dogj, u bombardua. Me këtë akt, në kohën e Milosheviqit dhe në fillimin e luftës është tentuar që të vritet kultura shqiptare, që të vritet historia e Gjakovës, edhe historia shqiptare.

Sot, me ndryshimet të cilat po bëhen në Çarshinë e Vjetër të Gjakovës, po humb identiteti kulturor, identiteti historik, edhe identiteti i qytetit të Gjakovës.

Prandaj, desha që nëpërmjet foltores së Kuvendit të Kosovës të ngre këtë çështje dhe të tregoj që Çarshia e Vjetër do të duhej të trajtohej me të vërtetë ashtu si e meriton, edhe me Ligjin për trashëgimi, edhe me kujdesin, jo vetëm të Komunës, por edhe kujdesin e gjithë shoqërisë kosovare, sepse ne kemi çka të mësojmë, edhe kemi me çka të krenohemi me Gjakovën, dhe pikërisht me Çarshinë e Vjetër të Gjakovës.

Dëshiroj t'i paraqes shqetësimet e qytetarëve edhe të kërkoj që Çarshia e Vjetër e Gjakovës të rikthehet, të restaurohet, por të mos e humbë identitetin e vjetër, identitetin i cili e simbolizon Gjakovën; të mbetet dhe të vazhdojë të jetë identitet me të cilën Gjakova dhe qytetarët e Gjakovës, edhe të Kosovës, do të krenohen me të. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Gjatë javës që shkoi, Televizioni Publik gjatë gjithë javës e njoftoi publikun me paralajmërimin e një interviste që do të ndodhte gati një javë më vonë.

Bëhej fjalë për promon e intervistës me ish-shefin e SHIK-ut, Kadri Veseli, e cila u transmetua për pesë ditë rresht, si asnjë emision tjetër, të paktën vitin e fundit në RTK.

Intervista në emisionin “Debat” prej 85 minutash përkoi me ditën e anëtarësimit të ish-shefit të SHIK-ut në Partinë Demokratike të Kosovës.

Ndërkohë që para kësaj interviste, në lajmet qendrore të datës 2 nëntor 2012, të premtën, lajmi i parë i përzgjedhur nga Redaksia e lajmeve në RTK ishte anëtarësimi në PDK i ish-shefit të SHIK-ut, kronika e së cilës paraqiste një mbledhje të degës të partisë në fjalë, në Mitrovicë.

Në intervistën 85-minutëshe, drejtuesi i emisionit, njëkohësisht edhe redaktor përgjegjës i lajmeve në RTK, është detyruar hapur, pra në transmetim të drejtpërdrejtë, ta ndërpresë emisionin pa i dhënë shpjegime publikut për arsyen. Nga mediet e tjera në vend, por edhe nga ajo çfarë u pa gjatë emisionit, duket qartë se i ftuari e orienton moderatorin e emisionit.

Më e pakta që mund të thuhet për këto çështje është se, së pari, Televizioni Publik nuk mund të jetë në shërbim të fushatës së brendshme të një partie politike, as në shërbim të promovimit të personazheve që garojnë apo anëtarësohen në të. Ekziston një dallim

esencial ndërmjet veprimeve shërbyese dhe informimit të publikut, e këtë profesionistët e fushës e dallojnë shumë mirë.

Së dyti, Ligji dhe Kodi i Etikës e detyron çdo person përgjegjës në RTK për informimin, pra për gazetarët apo redaktorët përgjegjës dhe drejtorët në politikën editoriale që të jenë të paanshëm dhe në shërbim të informimit publik. Praktikisht, kjo nuk është hera e parë që personat përgjegjës e kanë thyer hapur ligjin për RTK-në.

Së treti, trajtimi i këtij fenomeni të anëtarësimit në parti politike të njerëzve nga shërbimet sekrete përbën çështje me interes publik, sidomos për faktin që tregojnë për anëtarë të një strukture ilegale, siç është SHIK-u, e që janë bërë deputetë të kësaj partie, e së fundmi edhe shefi i tyre u bë anëtar, por jo edhe promovimi i këtij fenomeni.

Disa nga këta persona përgjegjës në Televizion mund ta hedhin pretendimin se po ndërhyjnë në politikën editoriale me këtë fjalim, por atyre po ua u kujtoj dhe një herë nenin 1 të Ligjit për RTK.

“Themelues i institucionit publik të RTK-së është Kuvendi i Kosovës. Do të jetë detyrë e themeluesit që ta mbrojë autonominë institucionale dhe pavarësinë editoriale të RTK-së dhe të sigurojë financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-së”.

E në këtë frymë të ligjit, i bëj thirrje Bordit të RTK, organ i zgjedhur nga Kuvendi, që t’i kontrollojë dhe t’i penalizojë përgjegjësit që kanë lejuar shkeljen në këtë masë të Kodit të Etikës dhe të Ligjit për Radio-Televizionin Publik.

Po ashtu, i bëj thirrje Kryesisë së Kuvendit që të kërkojë llogari se çfarë po ndodh në menaxhmentin e RTK-së...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju lutem, ju e dini Rregulloren e Punës. Këto janë deklarime jashtë rendit të ditës dhe secili mund të flasë sipas dëshirës së tij. Janë deklarime jashtë rendit të ditës.

I kisha lutur deputetët ose grupet parlamentare, nëse kanë diskutime në emër të grupit, të lajmërohen në fillim të seancës, e jo në mënyrë elektronike, te drejtuesi i seancës.

Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të Kabinetit qeveritar,

Në bisedimet e zhvilluara në Vjenë për statusin e Kosovës më 2006, janë hapur edhe shumë çështje që kanë të bëjnë me spastrimin e llogarive ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, siç është borxhi i jashtëm dhe ndarja e ish-pasurisë së ish-Federatës Jugosllave, me ç’rast edhe pjesën e Kosovës e ka marrë Serbia, dëmet e luftës, në pasurinë publike dhe private, pagat e humbura të 70% të kosovarëve të punësuar në

sektorin publik për 10 vjet me radhë, pensionet e humbura dhe Fondi Pensional i uzurpuar, çështja e kursimeve revizore në banka dhe dëmtimet në sistemin buxhetor të Kosovës. Për këto çështje nuk është arritur natyrisht marrëveshja dhe që atëherë ka mbetur pezull.

Qeveria e Kosovës duhet të ketë një qëndrim proaktiv që këto çështje të diskutohen në bisedimet, përkatësisht në negociatat që po zhvillohen tash.

Sot po e shtroj vetëm çështjen e dëmeve të luftës në pasurinë private.

Sipas studimeve, të cilat janë bërë me standarde ndërkombëtare menjëherë pas luftës, fondi i banimit në Kosovë ka qenë i zvogëluar për 40%, fondi i bagëtive dhe blegtorisë për 50%, pajisjet shtëpiake të grabitura ose të shkatërruara për 70%; ka pasur plaçkitje sendeve me vlerë dhe të parave kesh gjatë deportimit të 50% të popullatës së Kosovës. Dhe, vlerësimet vetëm për këtë segment të dëmeve nuk janë as 1, as 2, as 3, as 4 miliardë, por më tepër.

Institucionet e Kosovës, as bashkësia ndërkombëtare nuk ia kanë kushtuar kujdesin e duhur së drejtës së patjetërsueshme të këtyre personave dhe familjeve, e drejtë kjo humanitare dhe me të gjitha konventat që e kanë për zhdëmtimin e tyre.

Konsiderojmë se institucionet e Kosovës, shoqëria civile, organizatat e specializuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe të gjitha familjet dhe individët e dëmtuar duhet të insistojnë që Qeveria e Kosovës t'i ngrejë këto çështje atje dhe me aktivitetin e tyre duhet të ngrenë padi grupe ose individuale në gjykatat e Kosovës, në gjykatat e Serbisë dhe në ato ndërkombëtare për të kërkuar zhdëmtimin dhe kompensimin e këtyre dëmeve.

E-15-shi përshëndet iniciativën e Organizatën Joqeveritare “Ngritja e Zërit”, me seli në Skenderaj, si dhe aktivitetin që po zhvillon kryetari i Kuvendit të Komunës në Han të Elezit që të ngrihen padi për këto çështje.

Ne mendojmë se duhet t'u jepet mbështetje këtyre iniciativave, ato nuk duhet të mbeten të vetmuara. Andaj, kërkojmë nga institucionet qeveritare, kërkojmë nga instituti që e kemi formuar në Ministrinë e Drejtësisë, kërkojmë nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, nga asociacionet e juristëve që të mbështeten këto aktivitete...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani, në emër të Grupit.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Po tentojmë ta kthejmë edhe një herë vëmendjen te një proces i rëndësishëm në Kosovë, i cili ka kohë, ka disa javë që ka mbetur jashtë llupës së opinionit publik. E kam fjalën për liberalizimin e vizave me zonën Shengen të Bashkimit Evropian, përkatësisht me nevojën

për angazhim të pandalshëm, në plotësimin e kushteve që i janë paraqitur Kosovës nëpërmjet udhërrëfyesit.

Tashmë po bëhen 5 muaj prej kur Kosovës i është dorëzuar udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave dhe realisht ky Kuvend asnjëherë nuk ka dëgjuar nga Qeveria e Kosovës ndonjë raportim për punën e nevojshme dhe për punën që po bëhet për plotësimin e kushteve. E kam përshtypjen se edhe ky proces pati jehonë në opinionin publik vetëm tri ditë, e më pas gjithçka filloi të lihet në heshtje.

Ne duhet ta rrisim angazhimin tonë për mbikëqyrjen e Qeverisë, me qëllim që mos ta e lëmë Ekzekutivin që të bëhet neglizhues në këtë proces, ose në këtë çështje të rëndësishme për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Është e qartë se të gjitha 95 kushtet janë të arritshme. Është e qartë se asnjëra prej kushteve nuk është e pamundur për Kosovën. Por, po ashtu është e qartë se për t'i përmbushur këto kushte duhet shumë punë, shumë angazhim, përgjegjësi e plotë, qartësi në bërjen e prioriteteve të punës, si dhe përkushtim të plotë në të gjitha nivelet e administratës dhe nivelet politike.

Pavarësisht deklarimeve të ndryshme publike të udhëheqjes së vendit, gjatë këtyre 5 muajve ne nuk kemi vërejtur se përmbushja e kriterëve dhe kushteve për liberalizmin e vizave është kthyer vërtet në agjendë prioritare të insitucionave të vendit.

Më lejoni që edhe një herë të insistoj në nevojën jashtëzakonisht të madhe që Qeveria e vendit të bëjë të paktën pesë hapa kryesorë.

1. Koordinimin e përgjegjshëm të planeve të veprimit për secilin kusht veç e veç, ku përcaktohen detyrat, përgjegjësitë dhe afatet kohore për çdo institucion dhe për çdo sektor brenda institucionit;
2. Ndarja e nevojshme buxhetore për kërkesat e reja financiare për shkak të angazhimit më të fuqishëm në përmbushjen e kushteve të caktuara me udhërrëfyes;
3. Ngritja e profesionalizmit dhe kapacitetet në institucionet e zbatimit të ligjit, në rend të parë Policisë së Kosovës dhe mosndërhyrja politike e asnjë lloji në polici;
4. Ofrimi i garancive të mbrojtjes dhe mbështetjes së nevojshme për prokurorët dhe gjyqtarët që të kryejnë punët e veta, sidomos në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe
5. Të gjitha këto përkushtime dhe plane të veprimit duhet të raportohen në mënyrë të rregullt në Kuvendin e Kosovës, si pjesë e llogaridhënies së ekzekutivit para legjislativit të vendit.

Kushtet për liberalizmin e vizave nuk mund të përmbushen me fjalë, me deklarata apo me mbledhje të kohëpaskohshme, kushtet përmbushen me angazhim tepër të madh me

forcimin e institucioneve, me përgjegjësi në punë, e kjo po vazhdon të mungojë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot do të marrim vendim për propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për ta themeluar Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë dhe për Universitetin e Prizrenit. Kjo është një punë jashtëzakonisht e mirë e Qeverisë, të cilës i jemi gëzuar shumë, por kemi dashur shumë që edhe kësaj dite, edhe në këtë ditë ne të marrim një vendim për themelimin e Universitetit të Gjilanit, i cili realisht do të duhej që të ishte prioritet i Ministrisë.

Kjo për faktin se ky universitet paraqet një nevojë për shkak se e bën të mundur shkollimin e një numri shumë të madh të qytetarëve, jo vetëm të regjionit të Gjilanit që janë me shumicë, por edhe të Luginës së Preshevës, të cilët janë të privuar nga e drejta që ta kenë universitetin e tyre në vendin e tyre. Numri i tyre atje është rreth 100 000, dhe po ashtu kjo do të ishte edhe një nevojë për qytetarët e Kumanovës dhe Likovës, të cilët vetëm këto dy vjetët e fundit kanë filluar që të shkollohen në universitetin e tyre publik.

Në caktimin e prioriteteve do të ishte rendi dhe është e nevojshme të merren parasysh projektet ndërkufitare për faktin se këtu kemi të bëjmë me popullsinë tonë e cila do ta kishte marrë edhe një karakter simbolik me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Faleminderit!

KRYETARI: Dhe, i fundit, e ka fjalën kryetari i Grupit të LDK-së, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Unë do të doja në emër të Grupit të reagoj për një diskutim këtu edhe spekulativ, edhe fyes, edhe të pavërtetë që u bë nga zoti Konjufca.

Zoti Konjufca mund të flasë vetëm në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” dhe në asnjë variant nuk e ka të drejtën të tregojë se çfarë duhet të bëjë opozita, pjesa tjetër, flas për Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe se si po sillet.

Ajo që mund t’ju them me përgjegjësinë e plotë, është që LDK-ja e ka thënë vazhdimisht që dialogu është pjesë e jetës edhe shtetërore, por me obligime të caktuara që i kemi thënë vazhdimisht, të mos preket: sovraniteti, integriteti, rregullimi i brendshëm, të raportohet në këtë Kuvend çfarë po ndodhë dhe në fund ky Kuvend të vendosë për çdo marrëveshje eventuale. Këtë e kemi thënë vazhdimisht. Dhe kjo nuk është që ka lindur vetëm pas Rezolutës e po i themi kësisoj, të gjitha këto i kemi thënë vazhdimisht dhe qytetarët tanë i kanë parë dhe i kanë dëgjuar.

Prandaj, është e papranueshme, fyese dhe shumë e pasinqertë që me një folklorizëm të tentohet tash të denigrohet pjesa shumë konstruktive e rolit tonë që e kemi si Lidhje Demokratike e Kosovës.

E them me përgjegjësi të plotë se LDK-ja e ka thënë dhe do të mbajë qëndrimin dhe asgjë që është e dëmshme për vendin tonë, nuk e pranojmë. Po, ky është vendi, Kuvendi është ai i cili duhet të veprojë në mënyrë institucionale që të mbrohen interesat e vendit tonë dhe sigurisht pozitë dhe opozitë, që të gjithë e kemi obligim, edhe të krijojmë, edhe të ndërtojmë, edhe ta pranojmë shtetin e pavarur të Kosovës dhe demokratik. Është vendi këtu dhe ne jemi si Lidhje Demokratike e Kosovës të edukuar, të shkolluar, politikisht dhe kombëtarisht të veprojme kësisoj, të veprojme në institucione, brenda institucioneve dhe për interes të vendit tonë. Kjo është forma jonë e punës, e angazhimit dhe e asaj që ka sjellë dhe jemi të bindur do të sjellë rezultate.

Andaj, edhe një herë, zoti kryetar unë ju falënderoj për fjalën e dhënë dhe po e them me përgjegjësi të plotë se veprimi ynë është veprim institucional dhe shtetëror e kombëtar dhe insinuatat ose tentimi i marrjes së bajrakut, kushtimisht po e them, për të treguar kombëtarizmin ose atdhedashurinë më të madhe se sa të tjerët, i bën dëm edhe opozitës. Nuk thirret opozita kësisoj të veprojë bash kur tregohet që vetëm ne, një grup, sado i vogël apo i madh që jemi mund ta bëjmë këtë bashkë. Kjo është qasje shumë e gabueshme, jo frytdhënëse dhe nuk i ndihmon mbrojtjes së interesave të vendit tonë në këtë rast. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për këtë pikë të rendit të ditës nuk ka replika, sepse edhe unë s'pajtohem me atë që e tha Glauku, gratis. Unë nuk besoj që ka shërbime gratis.

Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Vjollca Krasniqi, pyetje për ministrin Agim Çeku. Ministri nuk është këtu. Deputete, a do ta bësh pyetjen? Nuk është as deputetja.

Atëherë, deputeti Visar Ymeri, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Kryeministri s'është këtu. A do ta bësh pyetjen, deputet? Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministri nuk qenka këtu për t'iu përgjigjur pyetjes. Unë e kam shtruar këtë pyetje edhe herën e kaluar dhe befasishëm ministri i Rendit e mori përgjegjësinë për t'iu përgjigjur në atë pyetje, pa iu shtruar pyetja. Shpresoj se këtë nuk do ta bëjë prapë.

Pyetja pra, ka pasur të bëjë me deklaratimet e Milan Ivanoviqit për takimet që kryeministri Thaçi, jo në cilësinë e kryeministrit, i ka bërë me përfaqësuesit e strukturave paralele në veri, ku ka qenë i pranishëm edhe Bajram Rexhepi.

Natyrishet se kjo është hera e s'di sata me radhë, sepse nuk i kam numëruar, që kryeministri po u ikën përgjigjeve të pyetjeve që shtrohen nga deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe unë mendoj që Kuvendi duhet ta zhvillojë një mekanizëm me të cilin i detyron të gjithë pjesëtarët e Qeverisë, pra përfshirë edhe kryeministrin, që të mos u ikin përgjegjësi që i kanë karshi këtij Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete, a e do fjalën?

ALMA LAMA: Faleminderit zoti kryetar!

Edhe unë e kam shtruar pyetjen në radhën tjetër, por kryeministri sërish nuk ka qenë. Si do që të jetë, do ta shtroj sërish pyetjen.

Pyetja ime lidhet me faktin, nëse kryeministri është pajtuar në Bruksel që EULEX-i të jetë një mision i dyzuar, si të them, në veri një mision tjetër, ndërsa në pjesën tjetër të Kosovës, një mision tjetër. Pra, me kompetenca të ndryshme.

Në rast se kjo është e vërtetë, siç kam unë informacione, kjo do ta cenonte karakterin unitar të shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Liburn Aliu, pyetje për kryeministrin Thaçi. Deputeti nuk është këtu.

Pyetje tjera s'kemi. Para se të vazhdojmë me pikën e miratimit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar, ju njoftoj se në sallë janë 63 deputetë. Edhe një njoftim. Propozimi i Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re për emërimin e deputetes Emilija Rexhepi anëtare e Komisionit për Punë të Jashtme, në vend të deputetit Amir Ahmeti.

Për këtë, kërkoj të kemi një deklaram formal të Kuvendit.

Kush është për? Faleminderit!

A ka kundër? Nuk ka.

Atëherë, konstatoj se u miratua propozimi.

I kemi 67 deputetë janë të pranishëm dhe kalojmë në pikën e tretë:

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Pyes deputetët, a keni vërejtje në procesverbalin e mbledhjes së fundit, të mbajtur më 1 dhe 5 nëntor 2012?

Meqenëse nuk ka vërejtje, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 1 dhe 5 nëntor 2012.

Atëherë kalojmë në pikën e radhës.

(Ndërhyrje: Kryetar, për rend dite!)

Për rend dite?! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Kërkoj falje, kryetar, se ndoshta s'u kuptuam. Unë, edhe në emër të Grupit Parlamentar kërkoj që Projektligji për organet qeveritare, për shoqëritë e informacionit, i cili është në lexim të dytë, në koordinim besoj edhe me kryetarin e Komisionit dhe vetë Komisionin apo Grupin punues, i cili ka punuar, që të shtyhet për një javë dhe t'i kompletojmë konsultimet për një çështje që ka ngrehur dilema dhe sigurisht edhe ju jeni i njoftuar si kryetar i Kuvendit dhe ministri i Drejtësisë, por edhe organet tjera që ka të bëjë që ky ligj të mos aplikohet për institucionet e Gjyqësorit dhe ato të prokurorive.

Ne edhe ashtu nuk kemi arritur që ta analizojmë këtë çështje në tërësi, se a mbulohet vetëm pjesa e menaxhimit të sistemit të informacionit, apo si në tërësi, si teknologji informative komplete nga niveli qeveritar dhe dyshojmë që kjo është përzierje e kompetencave në organet e pavarura, sidomos në pjesën e Gjyqësorit dhe të Prokurorisë.

Prandaj, si Grup Parlamentar kërkojmë që të shtyhet ky projektligj, i cili është në lexim të dytë dhe të shikohet mundësia që pjesa ku flitet për përkufizimin, që kjo pjesë të ndahet, gjithnjë duke marrë mendimin e komisionit dhe ekspertëve profesionalë. Faleminderit!

KRYETARI: Kush është për kërkesën e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, që të shtyhet shqyrtimi i këtij projektligji?

Shumica absolute janë për. A ka kundër? Nuk ka.

Pra, hiqet pika e shtatë e rendit të ditës nga shqyrtimi në këtë mbledhje.

A ka kush ndonjë kërkesë tjetër? Nuk ka. Atëherë vazhdojmë me pikën e katërt:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin për investimet e huaja dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj zëvendëskryeministrin Kuçi që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Ligji numër 02/L-33 për investimet e huaja është miratuar në Kuvendin e Kosovës, më 21 nëntor 2005 dhe ka hyrë në fuqi me 8 dhjetor 2006. Mirëpo, në ndërkohë është parë se ky

ligj ka nevojë të plotësohet e amendamentohet dhe ndryshimet e këtilla janë bërë tanimë domosdoshmëri.

Arsyeshmëria e ndryshimeve të propozuara është vendosja e një kornize ligjore e cila specifikon dhe ofron trajtim të barabartë për investitorët e vendeve të huaja dhe investimet e tyre në Kosovë.

Kosova, gjithashtu do t'u sigurojë investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre mbrojtjen adekuate dhe siguri të plotë dhe të vazhdueshme.

Në asnjë rast trajtimi i mbrojtjeve dhe siguria që kërkohet nuk do të jetë më pak e favorshme se sa që kërkohet me ligjet ndërkombëtare dhe me ndonjë dispozitë tjetër të këtij ligji.

Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj, përcaktojnë në mënyrë të plotë objektin e veprimtarisë së Agjencisë për Zhvillimin dhe Promovimin e Sektorit Privat. Këto ndryshime, gjithashtu, harmonizojnë procedurat dhe emërimin e zyrtarëve kryesorë të kësaj agjencie dhe zhvillimin e promovimin e sektorit privat në këtë agjenci dhe në tërësi në Kosovë.

Ndryshimet e bëra në këtë projektligj janë bërë pas konsultimeve të shumta dhe të vazhdueshme në periudhën dyvjeçare dhe u janë përshtatur kërkesave të tyre të vetme dhe të vazhdueshme që Kosova të jetë vend më atraktiv për investimet e huaja, duke mos tejkaluar kornizat ligjore që kërkohen nga Bashkimi Evropian, e po ashtu Kosova ka synuar dhe synon të radhitet më mirë në raportin e Bankës Botërore për të bërë biznes, ku këtë vit jemi përmirësuar përmbi 70 vende.

Ky projektligj ka për synim të krijojë kushte më të mira e lehtësira për investime, në mënyrë që të tërhiqen mundësi më të mëdha që investitorët e huaj në Kosovë, të investojnë dhe nëpërmjet tërheqjes së investimeve të huaja të rritet vlera e investimeve dhe numri i investitorëve të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e ekonomisë së vendit tonë.

Në këtë projektligj janë qartësuar apo trajtuar çështjet me rëndësi për investitorët e huaj për të ofruar siguri juridike për investimet e tyre, si:

- Mosdiskriminimi;
- Pajtueshmëria me detyrime;
- Stabiliteti i regjimit të investimeve;
- Nacionalizimi;
- Eksproprijimi dhe kompensimi;
- Konvertimi i valutës dhe transferimet e garantuara;
- Veprimet për mosveprime ligjore;
- Konflikti i armatosur dhe trazirat qytetare;
- Respektimi i të drejtave;
- Pajtueshmëria me ligjet dhe standardet;

- Personeli i huaj;
- Likuidimi i një investimi;
- Mekanizmat për zgjedhjen e kontesteve të investimit, dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me investimet e huaja në Kosovë.

Duke marrë parasysh se është tendencë për krijimin e ambientit më të mirë për investime të huaja në Kosovë, duke marrë po ashtu parasysh që do të ndihmojë në tërësi në zhvillimin ekonomik të vendit, ju ftoj që ta jepni mendimin tuaj, deputetë të nderuar, dhe pastaj, në leximin e dytë, kësaj radhe ta miratojmë leximin e dytë, me përmirësime adekuate të miratohet në Kuvend. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas renditjes, kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë e kolege deputetë,

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbledhjen e datës 23 e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për investimet e huaja dhe në përputhje me këtë shqyrtim, vlerësojmë se Projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe rrjedhimisht i propozojmë Kuvendit ta miratojë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesit e grupeve parlamentare e kanë radhën. Në emër të PDK-së , e ka fjalën zonja Berisha.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit nënkryetar!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për investimet e huaja. Fillimisht dua të cek se e mbështesim në parim, është një projektligj mjaft i domosdoshëm. Ne e kemi pasur një ligj në fuqi më herët dhe Qeveria e ka parë të arsyeshme që konform situatës së krijuar në Kosovë, të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i këtij ligji.

Ky ligj është plotësisht në përputhje me politikën e BE-së sa u përket investimeve të huaja. Më lejoni të cek se Komisioni Evropian thekson se politika e BE-së për investime është e përqendruar në sigurimin e investitorëve dhe investimeve të tyre me siguri ligjore, të qëndrueshme dhe të parashikueshme, me mjedis të rregulluar, në të cilin mund të ushtrojnë biznesin e tyre në përputhje me rregullat ekzistuese ndërkombëtare që janë më të rëndësishme në këtë fushë.

Prandaj, ky ligj është i hartuar konform këtyre politikave dhe sipas Komisionit Evropian, parimet kryesore të BE-së për investimet e huaja janë fokusi në investimet afatgjata të cilat investime edhe i duhen Kosovës dhe që gjenerojnë punësim të qëndrueshëm dhe zhvillim ekonomik, si dhe rregulla tjera.

Dua të cek se gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, në memorandumun shpjegues jepet opinioni i implikimeve buxhetore Departamenti i Buxhetit thekson se mund të ketë implikime buxhetore dhe shprehja “mund” është diskutabile - “mund e s’mund”, ndërsa gjatë hartimit-draftimit të këtij ligji Qeveria ka organizuar takime dhe ka marrë opinione nga të gjithë faktorëve relevantë dhe thuhet në memorandumun shpjegues se nuk ka marrë asnjë koment nga faktorët relevantë dhe është një konstatim që nuk do të ketë implikime buxhetore.

Ne, si Grup Parlamentar, e mbështesim, kontributin tonë do ta japim gjatë fazës së amendamentimit dhe do t’i shohim t’i analizojmë në detale të gjitha këto, këto dy qëndrime të ndryshme lidhur edhe me implikimet buxhetore. Ju ftoj që ta votoni, kolegë deputetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit kryesues!

Projektligjin për investimet e huaja e kemi analizuar, kemi pasur vërejtje edhe në Komision, dhe dilemat tona në këtë projektligj.

Është projektligj i cili veç ekziston prej vitit 2006 dhe dallimi në mes të ligjit ekzistues dhe ligjit i cili na është sjell në shqyrtim, kanë dallime të vogla, por janë dallime esenciale.

Nocioni i investimeve të huaja është me siguri një nocion i cili është përdorur dhe stërpërdorur më së shumti prej politikanëve, sidomos gjatë fushatave, por vetëm si ligj nuk e ka pasur atë fuqinë edhe mundësinë që të ngris zhvillim ekonomik apo t’i rritë investime të huaja, sepse mendojmë që zhvillimi ekonomik dhe investimet e huaja nuk mjaftojnë që të kemi vetëm ligj, por duhet të jetë complete edhe infrastruktura ligjore, sundimi i ligjit dhe shumë bazamente tjera, të cilat do ta ndihmojnë zhvillimin ekonomik edhe investimet e huaja.

Por, në anën tjetër, dëshiroj të cek gjithashtu që kjo fushë nuk rregullohet me legjislacionin e BE-së. Secili shtet e rregullon për veti dhe politikat e BE-së janë në investime dhe sigurimin e investimeve përmes sigurisë ligjore dhe krijimit të kushteve për ushtrime të biznesit sipas rregullave ndërkombëtare.

Por, në anën tjetër unë nuk isha ndalur shumë, por isha ndalur vetëm në këto dallime, të cilat ekzistojnë me ligjin paraprak, me ligjin ekzistues. Dallimi është te neni 21, ku flitet për Agjencinë për Zhvillimin dhe Promovimin e Sektorit Privat dhe në ndërkohë, ku ekziston Agjencia për Zhvillimin dhe Promovimin e Investimeve dhe mendoj që kalimi i

kompetencave prej njëres agjenci në agjencinë tjetër nuk ka pasur nevojë që të silltet me ligj.

Në anën tjetër, në nenin e parafundit, në nenin numër 23, thuhet që ky ligj i ri për investimet e huaja, do ta shfuqizojë ligjin e vjetër 02/L-033 për investimet e huaja, por njëkohësisht do të shfuqizojë edhe dy ligje tjera - ligjin 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, gjithashtu edhe plotësim-ndryshimin e Ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Në qoftë se e kemi parasysh se këto dy ligjet tjera, në fakt, e mbulojnë komplet një veprimtari tjetër, atëherë shtrohet pyetja se si do ta kompensojë, si do ta kompletojë ky ligj mungesën e cila do të krijohet me shfuqizimin e këtyre tri ligjeve. Prandaj, mendojmë që ligji i vjetër i plotëson nevojat e Kosovës për investime të huaja, në asnjë mënyrë nuk i pengon investimet e huaja, pengesat duhet të kërkohen tjetërkund dhe sidomos shfuqizimi i këtyre dy ligjeve tjera është diçka e cila nuk na lejon që ne të japim vizë për aprovimin e këtij ligji.

Prandaj, kërkojmë që ligji të kthehet dhe të mos votohet në këtë seancë. Ne nuk do ta votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, fjalën e ka kryetari i Grupit, zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Siç edhe u përmend, jemi duke e trajtuar një ligj i cili e mbulon një çështje që është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe e cila ka potencial njëkohësisht që të jetë shumë përfituese për vendin e Kosovës, siç janë investimet e huaja, por ka potencial të rrezikut të lartë që edhe ta shkatërrojë ekonominë e Kosovës, po që se nuk rregullohen si duhet dhe po që se synim primar i rregullimit të tyre nuk është interesi i Kosovës, por interesi i investitorëve të huaj.

Dhe, fatkeqësisht, më duhet të theksoj se duke e lexuar këtë ligj për investimet e huaja është vështirë të mos konstatohet që ky ligj në fakt flet vetëm për interesin, mbrojtjen dhe përfitimin e investimeve të huaja dhe në asnjë mënyrë nuk e trajton interesin e Kosovës, cili do të jetë ai dhe e kam drojë që kjo nuk trajtohet për shkak se në politikën e Qeverisë së Kosovës, në fakt ky nocion nuk ekziston fare dhe kjo pastaj e bën edhe ligjin të jetë i tillë çfarë është.

Këtu flitet për investimet e huaja, ndërkohë që është vështirë të kuptohet pse nuk kemi ligj të përgjithshëm për investimet, pra pse përjashtohen investimet vendore. Nëse këto privilegje do të gëzohen nga investitorët e huaj, atëherë a nuk nënkupton kjo automatikisht që edhe investitorët vendorë do ta kenë trajtimin e njëjtë.

Pastaj, këtu, te definimi i asaj se çka konsiderohet investim i huaj dhe çka konsiderohet person i huaj, shihet që ka potencial të përjashtohen një numër i madh i shqiptarëve që

jetojnë jashtë, prej mërgatës shqiptare, të cilët mund edhe ta kenë shtetësinë e Kosovës dhe këtu pyetja ime për Qeverinë është - një investim që mund të vijë nga shqiptar që jeton jashtë, dhe i cili e ka edhe shtetësinë e Kosovës, a do të konsiderohet investime i huaj, apo investim vendor, për shkak se kjo është një çështje që duhet të trajtohet dhe të dihet se çfarë pozicioni do të kenë këta persona apo këto raste.

Në nenin 3 pika 1 thuhet se Kosova do t'u ofrojë trajtim të drejtë e të barabartë investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre në Kosovë. Pra, këtu nënkuptohet që ky lloj trajtimi do të jetë i barabartë për të gjithë ata investitorë, pavarësisht se prej nga vijnë, por njëkohësisht mund të nënkuptohet që ka të bëjë edhe me trajtimin e barabartë që do ta kenë me investitorët e vendit, mirëpo në këtë rast nuk ka këtu pastaj asnjë referencë se çfarë trajtimi do të kenë investitorët e vendit. Pra, thuhet që privilegjet do t'i gëzojnë investitorët e huaj, në tërë tekstin e ligjit, ndërkohë që investitorët e vendit nuk mbulohen nga ky ligj.

Pastaj, te mosdiskriminimi, është një nen tjetër që është problematik. Është pika, ose paragrafi 2 i këtij neni, ku thuhet që pa paragjykim të marrëveshjeve reciproke ndërkombëtare, apo me të cilat Kosova obligohet, do të jetë e paligjshme për Kosovën t'i diskriminojë në çfarëdo mënyre investitorët e huaj në bazë të shtetësisë, origjinës, vendbanimit, vendit dhe themelimit të afarizmit ose kontrollit. Pra, kjo është problematike, duke i pasur parasysh rrethanat e veçanta në të cilat ekziston Kosova, dhe kjo sigurisht se do të duhej të ishte problematike edhe për secilin shtet tjetër, meqenëse dihet që në marrëdhëniet ndërkombëtare asnjë shtet nuk i ka marrëdhëniet njëjtë të mira apo njëjtë të këqija me të gjitha shtetet. Pra, asnjë shtet nuk i ka të gjithë miq dhe as nuk i ka të gjithë armiq.

Dhe në këtë drejtim, a nuk është e drejtë elementare që të diskriminojmë ata që na diskriminojnë, për shkak se ky ligj neve na e ndalon që të diskriminojmë ata të cilët na diskriminojnë ne si shtet, na diskriminojnë ne si popull, na diskriminojnë ne si ekonomi dhe na diskriminojnë ne si potencial prodhues. Mendoj se kjo, duke u nisur nga një parim i barazisë, në fakt e vendos Kosovën në një pozitë pabarazie me tjerët, duke pasur parasysh se Kosova po ia heq të drejtën vetes me këtë nen që t'i diskriminojë ata që ose sillen armiqësisht ndaj Kosovës, ose e diskriminojnë Kosovën për arsye të ndryshme.

Te investimet e huaja direkte, të cilat janë bërë një lloj montre e zhvillimeve ekonomike globale, deri në kohën e krizës financiare, pra deri në vitin 2008, kur ka filluar një lloj debati tjetër sa i përket zhvillimit ekonomik, veçanërisht të vendeve në zhvillim, edhe kritikët i kanë evidentuar katër probleme kryesore që mund të lindin nga këto po qe se nuk rregullohen, prapë po them.

Pra, problemi i parë është që e kanë identifikuar kritikët se këto ndërmarrje, këto korporata të them ashtu, të cilat investojnë nëpër vende tjera, zakonisht e transferojnë një teknologji të dalë nga përdorimi, ose të papërshtatshme për vendin dhe me këtë mënyrë edhe më shumë i sjellin kokëçarje ekonomisë së vendit se sa që përmirësojnë diçka dhe këtë transferim të teknologjisë ata zakonisht e bëjnë në çmime shumë të larta.

Problemi i dytë është se këto kompani pra ushtrojnë një monopol ose fuqi monopoli shumë të madhe ndaj secilit prodhim tjetër vendor, për shkak se dihet që kompanitë të cilat investojnë edhe nëpër vende tjera janë kompani të cilat fuqinë e kapitalit, por edhe të zhvillimit teknologjik e kanë shumë më të madhe se sa mund ta ketë vendi pranues i këtyre investimeve dhe në këtë drejtim këto kompani pastaj i përjashtojnë nga mundësia në investim në sektorë të caktuar dhe ata persona vendorë, të cilët janë të interesuar për një çështje të tillë.

E treta, është që këto kompani zakonisht përfshihen në praktikën e asaj që quhet çmimi i transferit përbrenda kompanive të tyre simotra, apo degëve të tyre në mes vendeve të ndryshme, gjë që ua mundëson atyre shmangien nga tatimet, për shkak se zakonisht për t'i rritur përfitimet e tyre dhe për ta përmirësuar balancin financiar, ato i deklarojnë veprimtari me humbje, nëpër ato vende ku tatimet janë më të larta dhe e deklarojnë veprimtarinë me profite të mëdha, në ato vende ku tatimet janë më të ulëta, për t'u ikur kështu tatimeve nëpër vende.

Kështu që këto lloj investime e kanë mundësinë që edhe në aspektin e tatimeve që mund t'i vjelë një vend nga to, rrezikon që mos të ketë mundësi për një çështje të tillë, duke pasur parasysh, domethënë, mënyrën dhe mekanizmat që i rregullojnë këto investime.

Dhe, e katërta, edhe një problem shtesë që është identifikuar është që këto kompani pastaj, veçanërisht në vende të vogla siç është Kosova, duke pasur parasysh fuqinë financiare që ato e kanë, mund të kenë ndikim shumë të madh në zhvillimet politike në vend dhe mund të kenë zhvillim shumë të madh madje edhe në destabilizimin e qeverive, të cilat nuk u shkojnë atyre përshtati.

Pra, këto janë probleme të cilat mund të rrjedhin nga investimet e huaja direkt, po qe se ato rregullohen ose nuk rregullohen, siç është rasti me Kosovën, siç është paraqitur me këtë ligj, pra ku thërritet për një mosrregullim të skajshëm të tyre dhe për një duarlarshmëri të tyre të skajshme.

Në ligjin, në të cilin po flasim, në nenin 9, pra te konvertimi i valutës dhe transferimet e garantuara, mundësohet pikërisht kjo të cilën e përmenda. Pra, në këtë nen shihet qartë që në fakt Qeveria e Kosovës po synon që t'ua lë në diskrecionin e plotë dhe në lirinë e plotë këtyre kompanive, që të bëjnë çfarëdo transferi, qoftë të profiteve, qoftë të mjeteve tjera financiare, të cilat i kanë gjeneruar ata në Kosovë, në çfarëdo forme dhe pa kurrfarë kontrolli. Dhe, kjo mendoj që paraqet një rrezik shumë të madh edhe për sistemin financiar të Kosovës, për shkak se këto kompani do ta kenë mundësinë, që në çfarëdo forme dhe në çfarëdo kohe, përmes vendimeve të veta dhe përmes transfereve të veta, që ta rirregullojnë apo ta ndryshojnë rrënjësisht nivelin, sasinë e parave të cilat janë të pranishme në tregun e Kosovës dhe kështu ta kenë një kontroll shumë të rrezikshëm mendoj unë, përmbi financat e Kosovës dhe përmbi natyrisht, stabilitetin ekonomik të Kosovës, duke pasur parasysh rëndësinë që financat kanë në këtë vend.

Pra, në njëfarë mënyre, me këtë ligj, këto kompani, përkatësisht investimet e huaja do ta kenë në kontroll edhe Bankën Qendrore të Kosovës, për shkak se do ta bëjnë Bankën

Qendrore të Kosovës si garantues i qëndrueshmërisë financiare të Kosovës, në njëfarë mënyre të panevojshme dhe impotente. Pastaj, në të njëjtin nen shihet që edhe te procedurat e konvertimit nga njëra valutë në tjetrën, të liritë të cilat po ashtu u garantohen këtyre investime të huaja, në fakt ia bart një pjesë të konsiderueshme të rrezikut të konvertimit apo ndryshimit në vlerën e konvertimit të këtyre valutave, ose mes këtyre valutave, rrezik ky që do ta bartë ekonomia e Kosovës, duke pasur parasysh kompanitë apo investimet e huaja direkte janë të lira plotësisht në kryerjen e këtyre shërbimeve.

Te neni 11 po ashtu, e kemi një nen, i cili në njëfarë mënyre ia vesh disa përgjegjësi Kosovës, të cilat madje edhe nuk do të duhej t'i bartte Kosova, te garantimi i investimeve dhe kompensimi që bëhet për to, në rastin e konfliktit të armatosur dhe trazirave qytetare dhe këtu thuhet, që edhe në rast lufte dhe në rast të çfarëdo trazire, pra investorët do të kompensohen, duke pasur parasysh që Kosova aktualisht është një vend që nuk ka ushtri për t'u mbrojtur, meqenëse nuk i është lejuar e drejta për të pasur ushtri dhe, njëkohësisht pastaj kërkohet nga Kosova që ta bartë përgjegjësinë, që lufta e mundshme ose sulmi nga jashtë i mundshëm dhe dëmtimi që ai mund t'i bëjë investimeve, ta bartë Kosova. Pra, kjo mendoj që është absolutisht e padrejtë, për shkak se në njërën anë, ne nuk po lejohe mi të mbrohemi, ndërsa në anën tjetër po kërkohet që paaftësia jonë për t'i mbrojtur këto investime të kompensohet nga ne.

Dhe, po ashtu thuhet në paragrafin 2. 1, përvetësimit të njërës, pra rastet kur kompensohen është edhe përvetësimi i një asemi nga një autoritet publik, zyrtar apo shërbyes civil i një autoriteti publik, ose ndonjë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: A deshe ta përmbyllësh diskutimin? Edhe një minutë.

VISAR YMERI: Faleminderit! Edhe një minutë, vetëm sa për të shtuar edhe fundin, domethënë, të kësaj. Përgjithësisht, duhet ta cek që natyrisht, që investimet e huaja mund të jenë edhe thashë në fillim, mund të jenë të dobishme dhe do të ishin të mirëseardhura në Kosovë, po një gjë duhet ta kemi të qartë.

Në njërën anë investimet e huaja nuk e gjenerojnë zhvillimin, ato zakonisht shkojnë në vendet të cilat tashmë kanë filluar zhvillimin dhe ky zhvillim paraqitet sikur në rritjen ekonomike, po ashtu edhe në rritjen e aseteve fizike të prekshme, siç janë infrastruktura dhe të tjerat dhe, në anën tjetër, jo secili investim i huaj apo vendor mund të jetë i dobishëm për mirëqenien shoqërore dhe ne duhet të kemi politika në Kosovë, të cilat bazohen në këto dyja. Pra, që e lë lirinë e domosdoshme në treg, mirëpo njëkohësisht përmes rregullimit dhe kontrollit nga institucionet publike ta garantojnë që rritja ekonomike dhe përfitimet ekonomike të përkthehen edhe në mirëqenie të qytetarëve.

Ky ligj nuk duket se garanton këtë. Rrjedhimisht, Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do ta votojë ligjin.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën zoti Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti nënkryetar,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Grupi i Aleancës e ka analizuar Projektligjin për investimet e huaja, një ligj i cili edhe është në fuqi për investime të huaja, po besoj që deri me tani shumë pak është zbatuar në praktikë dhe shumë ligje nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë janë duke ardhur vetëm sa për ndryshim të ligjit. Dhe është shumë interesant se edhe çdo ndryshim i ligjit, po edhe ligjet e mëparshme, thuhet se janë me politikat më të mira të BE-së. Tash s'po dimë, ligji që është në fuqi, apo ndryshimi i projektligjeve, që po vijnë, cili është me praktika të BE-së dhe cili s'është me praktika të BE-së.

Unë besoj se Ligji për investime të huaja nuk është ligj i keq që ka qenë, mirëpo shumë pak është zbatuar.

Dhe, me nenin 23 qëllimi kryesor i këtij ligji është shuarja e Ligjit për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, që në këtë Kuvend është miratuar, që në këtë vend ka ardhur me plotësim të ndryshimit prapë në vitin e kaluar dhe kemi formuar Agjencinë për Promovimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe tash me këtë ligj të investimeve të huaja, dëshirojmë që të shfuqizohet ai ligj, i cili është aktualisht dhe të hyjë në kuadër të këtij ligjit.

Unë nuk di se sa do të jetë i suksesshëm, për arsye se Ligji për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është një prej ligjeve mjaftë me rëndësi, që çojnë kah zhvillimi ekonomik dhe në shumë vende të Evropës, por edhe të botës, dihet se me ndërmarrje të vogla dhe të mesme zbutet edhe papunësia, rritet edhe zhvillimi ekonomik, ndërsa nëse hyjmë në kuadër të Ligjit të investimeve të huaja, unë besoj që do të jetë një dështim total.

Dua të cek edhe te neni 9, te transferi i mjeteve. Ne, para pak kohe, e kemi kaluar edhe sistemin e pagesave, një projektligj që është shqyrtuar në Kuvend. Dhe, në atë projektligj do të definohen disa gjëra, se si do të bëhet sistemi i pagesave, ndërsa, me këtë ligj dhe me këtë nen është në kundërshtim edhe me ligjin paraprak, i cili ka qenë në lexim të parë në këtë Kuvend.

Unë, besoj që ligjet duhet të harmonizohen njëri me tjetrin, mos ta kundërshtojnë njëri-tjetrin, por mund të ketë edhe implikime buxhetore, që me siguri Komisioni për Buxhet dhe Financa do t'i analizojë me kujdes dhe nëse ky ligj shohim që ky ka implikime buxhetore, atëherë vështirë është që të zbatohet. Nuk është mirë që të bihen në Kuvend veç ligje sa për të pasur në numër, por është mirë të kemi ligje që të zbatohen në praktikë dhe, sidomos ligjet në spektrin e ekonomisë, që duhet të gjejnë një zbatueshmëri të plotë, sepse Kosova ka nevojë për këto ligje, sepse Kosova ka nevojë për një zhvillim të shpejtë dhe të hovshëm ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin që është i pranishëm këtu dhe për të gjithë deputetët.

Siç u tha edhe nga kolegët tjerë, ne kemi pasur Ligjin për investime të huaja, mirëpo prapëseprapë Qeveria e solli dhe me disa plotësim-ndryshime Ligjin për investime të huaja. Ky është projektligj, në të cilin shihet mbrojtja dhe promovimi i investimeve të huaja në Kosovë, ku duhet të mbrohen edhe investimet vendore apo më mirë të themi investimet e njerëzve, të cilët janë kosovarë në Kosovë.

Në rast se e shohim ligjin, mund të themi se u cek edhe nga parafolësi, janë dy ndryshime. Mirëpo, në harmonizim me ligjet e tjera, besoj që ky ligj do të marrë formën e duhur për arsye se Kosovës i duhen investime. Në ato investime të përfitojnë qytetarët dhe në rast se ka mosharmonizim të këtij ligji me ligjet e tjera dhe Ligjin për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ku u potencua që duhet të hiqet, atëherë unë ju them se gjatë punës në Komisionin Parlamentar, do të ftohet Ministria dhe do të shohim çka mund të bëjmë më të mirën, që ky ligj të sjellë përfitime e jo të miratohet vetëm në letër dhe të ngelet brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah dhe shpresoj që do të japim maksimumin, që ligji të jetë ai ligj që do të përfitojë me të. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar SLS, zoti Stojanović.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poštovani članovi Vlade,

Poštovani kolege poslanici,

Poslanička grupa SLS-a podržaće u načelu nacrt zakona o stranim ulaganjima, jer mislimo da jo ovo veoma bitan zakon, koji će omogućiti da kosovsko društvo prebrodi neke teškoće u koje se nalazi. A glavna teškoća kosovskog društva, svakako je velika nezaposlenost. Svima nama strane investicije su neophodne, jer ljudima treba omogućiti da rade.

Ima određenih nedostataka u nacrtu zakona, međutim sve te nedostatke, koje su i kolege pomenule pre mene, pokušaćemo da otklonimo kroz rad u komisiji. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “6+”, fjalën e ka zonja Shiniq.

MYFERA SHINIK: Teşekkür ederim!

Sayın Meclis Başkanı vekili, Sayın Başbakan yardımcısı, Bakanlar ve Milletvekilleri

Kosova'nın ekonomi gelişmesi için yasal anlamda yabancı yatırımların yapılması konusu bu Yasa Tasarısında yetersiz görülmektedir. Yasanın en uygun bir şekile ulaşması için

“6+” Parlamentar Grubu olarak fonksiyonel komisyonlarda katkımızı sunacağız ve birinci okunuşunu kabul ediyoruz. Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të grupeve parlamentare nuk ka tjerë të paraqitur. Radha është e deputetëve. Zonja Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Unë e mora fjalën edhe një herë, tash në emrin tim personal dhe nuk është mirë që opinionin publik të dezinformohet rreth vlerësimeve, që ia bënë disa parafolës, projektligjit në fjalë.

Shfuqizimi i dy ligjeve tjera që parashihet me këtë ligj e ka arsyeshmërinë e vet, sepse në njëfarë forme Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, më mirë ka qenë të quhet Ministria e Agjencive dhe tani Agjencia për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme dhe Agjencia për Investime, fuzionohen dhe shndërrohen në kuadër të një institucioni, që nuk do të ketë nevojë edhe për regrutim të stafit shtesë.

Tjetër, nuk është mirë të krijohet një klimë në Kosovë, një klimë refuzuese ndaj investitorëve të huaj, sepse Kosova jashtëzakonisht ka nevojë për investime të huaja. Dhe që t’u fshihet qytetarëve tanë dilema, se ky ligj është kah bëhet një ligj i favorshëm për investitorë të huaj, të cilët mund të ndikojnë sipas paragjykimeve të disa edhe në politikat në Kosovë, më lejoni që ta lexoj edhe një herë nenin 4 të këtij draftligji që e kemi para nesh.

Neni 4, titulli - Mosdiskriminimi, paragrafi 1, Kosova do t’u japë investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre trajtim jo më pak të favorshëm se sa trajtimi që i jep ndonjë investitori vendor dhe investimeve vendore. Dhe, kjo është shumë e kuptueshme dhe e mjaftueshme dhe një përgjigje jashtëzakonisht e mirë, për paragjykimet që i patëm më parë.

Paragrafi 2 i këtij neni, pa paragjykim ndaj marrëveshjeve reciproke ndërkombëtare të Kosovës, apo me të cilat Kosova obligohet, do të jetë e paligjshme për Kosovën t’i diskriminojë në çfarëdo mënyre investitorët e huaj: në bazë të shtetësisë, origjinës, vendbanimit, vendit të themelimit të afarizmit ose kontrollit.

Paragrafi 3 i këtij neni, thotë: përveç të drejtave specifike, garancive dhe privilegjeve të dhëna nga ky ligj për investitorët e huaj dhe investimet e tyre, investitorët e huaj dhe investimet e tyre do të jenë në pajtim dhe do të kenë të drejtë dhe obligime, po e përsëris, të drejtë dhe obligime me ligjin e aplikueshëm në Kosovë, njëllë sikurse investitorët vendorë dhe investimet e tyre. Dhe, kjo është e mjaftueshme të hiqen të gjitha dilemat se ne po i krijojmë hapësirë, ambient ku ta di unë ndonjë investitori, që mund ta çrregullojë Kosovën ekonomikisht dhe politikisht.

Edhe një herë, ju ftoj që ta mbështesim këtë ligj dhe ne t’i japim vërejtjet e tona, në fazën e amendamentimit në Komision parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Unë plotësisht pajtohem me synimet që ka ligji, që ne të bëhemi një shtet që do të sigurojmë investimet, ndërsa, tek pjesa e dytë që nëpërmes këtij ligji ne po promovojmë, unë nuk pashë askund se cilat do të jenë mundësitë, që ne edhe më tutje të promovojmë.

Vërtet zhvillimi ekonomik dhe investimet janë një çështje shumë esenciale dhe shumë jetike për shoqërinë tonë, por, shtrohet pyetja, përveç që miratimin e një ligji dhe përafrimin e tij me rregullativën evropiane, nuk shoh ambicie dhe nuk shoh asnjë tentim që të shkohet më tutje. Posaçërisht, kur dihet se investimet varen nga një ambient biznesor, që e ka një vend për të tërhequr investimet. Me këtë ligj, sikur investitori të vijë në Kosovë, ne po e përshkruajmë se ai do të jetë i barabartë me investitorët ekzistues në vend dhe do të jetë i sigurt, por shtrohet pyetja, si do t'i tërheqim ne investitorët, që ligji as nuk ka provuar ta japë një përgjigje as një angazhim në këtë drejtim.

Shtrohet pyetja se një vend do të tërheqë investime, nëse ka sundim ligji, nëse atij i sigurohet gjithçka paraprakisht, jo vetëm përfundimisht pra, që i sigurohet prona, por i sigurohet edhe ambienti biznesor. Pastaj, në një shoqëri ku informaliteti është kaq i madh dhe nuk ka as tentime të mëdha që të pengohet informaliteti, pra një ekonomi, biznes i fshehtë, atëherë secili që do të vijë në Kosovë, do të shikojë se do të jetë në mëshirën e respektimit të ligjeve kur ai do të atakohet nëpërmjet informalitetit.

Pastaj, cilat janë kapacitetet tona institucionale që ne të ballafaqohemi me ardhjen e investitorëve, kur dihet se deri më tash, një investitor i cili vjen nuk do të thotë se ai i ka të gjitha njohuritë dhe ka ardhur me idenë se do të investojë aty, ku ai e ka krijuar idenë. Mund të ndodhë një investitor, vjen në Kosovë për të hulumtuar se ku do të investojë, cilat janë dokumentet tona madhore, siç është pra strategjia e tërheqjes së investitorëve, pastaj strategjitë zhvillimore që i kemi, të cilat janë aprovuar në letër dhe askund nuk janë të zbërthyera. Dhe shtrohet pastaj del një përgjigje shumë logjike, që një investitori do t'i duhet të jetojë në Kosovë 6 muaj, e ata njerëz të cilët vijnë për të investuar nuk janë njerëz që kanë kohë të humbin, pra të humbin 3 muaj e 6 muaj dhe krejt çka do ta kuptojë fillimisht Kosova është se ne jemi, kemi një popullatë të re dhe kemi të papunë mjaftë. Nëse ti do të vish për të investuar, punëtorë do të gjesh në Kosovë dhe kurrëgjë tjetër, pra shumë pak është kjo.

Pastaj, cilat do të jenë lehtësirat? Një vend, i cili akoma TVSH-në e merr në kufi dhe çdo prodhues nuk mund të blejë me thasë, ai do të provojë të blejë sa më lirë dhe ndoshta i furnizon 100 tonë që të mund t'i prodhojë 30 tonë dhe ata 30 tonë, atij TVSH-ja pastaj i refundohet dhe i rregullohet ndoshta mbas 6 muajsh, mbas një viti, kur e shet. Ku ke parë ti stimulim të investimeve dhe të prodhimit vendor, kur TVSH-ja paguhet që në kufi. Dhe, ky vend akoma po sillet sikur të ishte viti 1999 - 2000 ose 2001 në tranzicion.

Pastaj, duhet të shtrohet pyetja edhe te kjo. Shumë mjete ka shpenzuar Kosova në ngritje të kapaciteteve dhe unë do të kisha thënë më shumë turizëm se sa ngritje të kapaciteteve. Dhe, po shihet se cilat kapacitete i kemi ne sot për t'u ballafaquar me zhvillimin ekonomik dhe me investitorët. Shihni vetëm kreditimet, që i bëhen, domethënë kreditë më komerciale, vjen biznesi, ka nevojë për një kapital, posaçërisht flas për investitorët vendorë dhe në çka has. Has në 10% kamata vjetore dhe nëse ai kërkon mbështetje për 3 - 4 vjet, atij i merren 40%. Cili është ai prodhues që i fiton 40%? Dihet se cila është marzha ose fitimi te prodhimet.

Dhe, shtrohet edhe pyetja tjetër, derisa ne jemi duke i sakatuar investitorët vendorë po ua merr mendja se vijnë ata të huajt dhe investojnë këtu dhe posaçërisht kur dihen praktikatat e vendeve në tranzicion, sikur ne, gjithmonë më i madhi ka qenë kapitali i kombinuar. Kur vjen kapitali, investitori nga jashtë me para të freskët dhe gjen persona dhe kompani, firma, të cilat kanë krijuar një përvojë, kanë kapacitete dhe bëhet deri tek ky kapitali i kombinuar dhe kur vjen ai regjim, biznesin tonë të mbushur deri në fyt kamata, do të thotë, ne po besojmë se ai do të vijë këtu, prandaj unë do të kthehem brenda ligjit. Gjithsesi se qëllimi i ligjit që investimi të jetë i sigurt mua më pëlqen, mirëpo, vërtet te kjo pjesa promovimi dhe tërheqja e investimeve, ky ligj absolut edhe nuk ka qasje.

E tani shtrohet pyetja, nëse ne e votojmë këtë ligj për sigurimin e investimeve, a do të procedojmë shpejt me një ligj për promovimin dhe thithjen e investimeve? Tani pse po them ligj, sepse ekzistojnë mundësitë, që ato të bëhen edhe me vendime, të bëhen me strategji, mirëpo ajo nuk krijon përgjegjësi dhe detyrime tek zyrtarët tanë, të cilët duhet të krijojnë një ambient biznesor, dhe të cilët do të merren, do të ballafaqohen drejtpërdrejt, sa që ishte dashur ndoshta, nën një të bëhet një trup gjithëkombëtar, në cilado formë, ku edhe Parlamenti do të kishte pasur një rol shumë të fuqishëm, pikërisht për tërheqjen e investimeve, ngase ne pikërisht nga kjo do të varemi se a do të fillojmë që vërtet ta gjejmë rrugën tonë të mirëfilltë të zhvillimit ekonomik në këtë fazë, apo do të presim mbas nja pesë apo dhjetë vjetëve, kur shteren, ngase edhe sot e kësaj dite po të pyesim ne sot Qeverinë tonë, cilat janë resurset kryesore të zhvillimit të këtij vendi, ne e dimë se ekziston do të shëngjill, ne e dimë se ekziston një rrafsh i Kosovës, e dimë se kemi disa pasuri minerare, mirëpo cila është strategjia e shfrytëzimit dhe sa investitorë të jashtëm kanë informacione që ata të fillojnë të vijnë në Kosovë dhe ta krijojnë këtë?

Prandaj, unë them edhe një herë, mund të votohet ky ligj, si ligj i sigurimit të investimeve, por kurrsesi i promovimit dhe tërheqjes së investitorëve. Dhe, kjo edhe në herë tregon që ne vërtet nuk kemi vizion, s'kemi strategji, nuk kemi plane të veprimit, ndërsa mjaftohemi për t'i kënaqur kërkesat e Bashkimit Evropian, se ne po aprovojmë ligje. Ky vend nuk po vuan për ligje, por po vuan për dije, po vuan për vizion dhe po vuan për strategji të mirëfillta të ecjes përpara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!
Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Autorë të ndryshëm vënë në spikamë që 90% të investimeve të huaja në botë sot shkojnë në vende tashmë të zhvilluara dhe vetëm 10% në vende në zhvillim, siç quhen zakonisht vendet që në fakt janë të pazhvilluara.

Ulja e barrierave, ulja e gardit nuk të bën atraktiv për investime, po për sulme, sepse në këtë mënyrë del joserioz dhe vetë fakti, që disi përgjërohesh në mënyrë dëshpëruese për investime të huaja, të bën që të jesh atraktiv për korporata matrapaze, që s'merren me lëmin përkatëse, por nisin, pikërisht tek ne duke eksperimentuar këtu.

Tashmë jemi dëshmitarë që në Kosovë kemi investitorë të huaj, të cilët lëmin përkatëse të zhvillimit të aktivitetit biznesor e bëjnë për herë të parë pikërisht në Kosovë, për dallim prej asaj me çfarë merren tradicionalisht në vende të tjera e në të kaluarën e tyre.

Mendoj që ky zhvlerësim që ne ia bëjmë vetes me këtë ligj, na bën të dyshimtë për kompanitë serioze dhe sigurisht që do t'i joshim veçse kompanitë e dyshimta. Investimet e huaja duhet të jenë edhe çështje e politikës së jashtme. Ne nuk bën që t'i barazojmë të huajt, sepse ata neve nuk na trajtojnë njësoj. Në bazë të këtij projektligji që e kemi para vetes, investitorët nga Shqipëria dhe investitorët nga Serbia, janë të barabartë. Duke qenë se kjo është tërësisht e padrejtë dhe shumë e dëmshme, mendoj që nuk do të duhej as të vinte këtu para nesh, se lëre më ta votojmë e ta kalojmë.

Çdo investitor i huaj, kur ta lexojë këtë ligj, do ta humbë respektin për Kosovën. Duke thënë ejani investoni, sepse jemi shtet i dobët, nuk do të fitojmë investitorë serioz, por investitorë plaçkitës që fitojnë tek ne.

Më duket shumë problematik neni 7, i cili flet për nacionalizimin, por në fakt nuk e definon se çka quajmë nacionalizim, ndërkohë që tregon qysh nuk do të zbatohet ai.

Dhe, kemi nenin 11, i cili i barazon: luftën, konfliktet tjera të armatosura, revolucionin, kryengritjen, demonstratat, protestat, trazirat qytetare dhe aktet terroriste, duke thënë, apo ngjarje të tjera të ngjashme. Pra, i barazon që të gjitha këto në një mënyrë shumë absurde dhe, mua më duket po ashtu, e pakuptimtë që ky projektligj mundohet që ta rregullojë edhe një situatë pas revolucionare. Domethënë, dihet që pala që humb në revolucion është tragjike, le të mos e bëjmë edhe qesharake, sepse ajo nënkupton një transformim të thellë politik e socio-ekonomik, ku pikërisht ku pikërisht nuk vlen ajo paraprakja, kështu që mendoj se ky është një absurd tjetër i këtij projektligji.

Dhe, në fund desha të theksoj katër objektivat programore të alternativës qeverisëse të Vetëvendosjes lidhur me ndihmën e sektorit privat dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme, që mendojmë se janë substanciale.

E para, është qasja në financim. Duhet të kemi krijimin e mekanizmave, të cilat e bëjnë financimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme më lehtë dhe më të lirë. Disa prej këtyre mekanizmave janë:

- Skema garantuese për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme,
- Fondet investive për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme,

- Subvencionimi i kamatave për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që janë të integruara në zinxhirë të vlerës së sektorëve strategjik e të tjera,

Objektivi i dytë është politika tatimore, është vendosja e politikave tatimore, të cilat janë në favor të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme drejt prodhimit dhe punësimit, e për këtë gjë është një elaborim më i gjatë yni sa u përket politikave fiskale dhe monetare, që nuk na e lejon koha e mundësia që ta shpalosim tash këtu.

Objektivi i tretë është administrata. Kemi nevojë për reformimin e administratës shtetërore, që i shërben ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në mënyrë që të sigurohet që evazoni fiskal të mos bartet tek ndëshkimet tatimore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që lejet dhe taksat komunale dhe qendrore të jenë të unifikuara dhe, në fund fare, që shërbimet që jepen nga administrata, të jenë në funksion të zhvillimit.

Dhe, e katërta është prokurimi qeveritar. Lëvizja Vetëvendosje e ka të qartë që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të përjashtohen nga çdo proces i shitjes tek sektori publik, për arsye specifike. Rrjedhimisht, ndryshimi i ligjit të prokurimit, në mënyrë që së pari të promovohen shërbimet, produktet vendore e për më shumë, që ato që mund të prokurohen nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të mos prokurohen nga ndërmarrjet e mëdha vendore ose ndërkombëtare, duke krijuar potencialitet të rritjes për këto ndërmarrje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është e qartë dhe e kuptueshme nevojën që e ka Kosova për para, përkatësisht për investimet e huaja. Është krejtësisht e kuptueshme që përmes investimeve dhe investitorëve të huaj, t'i jepet një përkrahje zhvillimit ekonomik të Kosovës, të krijohet një lidhje me e fortë me vendet prej nga vijnë këta investitorë, si dhe të bëhet transferi i teknologjive dhe i të arriturave të tjera shkencore. Kjo vjen si domosdoshmëri edhe për shkak të rrethanave në të cilat gjendet vendi ynë, meqenëse në një, bartës i zhvillimit dhe investimeve në Kosovë, ende është buxheti i Kosovës, i cili ka kapacitete të kufizuara. Duke u orientuar vetëm në infrastrukturë ai ka marginalizuar të gjitha nevojat tjera që i ka vendi.

Investimet e huaja direkte në vend, për një kohë të gjatë janë në stagnim. Në vitin 2007 kemi pasur vetëm 440 milionë euro, ndërsa vjet kemi pasur 394 milionë euro investime. Domethënë, që në Kosovë investimet e jashtme nuk po rriten, por po ngelin në nivelin e atyre të vitit 2007, që kanë qenë investimet nga investitorët e huaj. Por, këtu duhet t'i përmendim që investimet më të mëdha kanë qenë nga diaspora jonë, jo nga firmat apo ndërmarrjet e jashtme apo personat me kombësi tjetër, nga shtetet e tjera.

Duke marrë parasysh këto shkaqe, por pa harruar edhe shkallën e ulët të zhvillimit dhe nivelin e lartë të varfërisë dhe të papunësisë, atëherë është krejt e kuptueshme se duhet të

kemi një ligj që nxit investimet e huaja. Këtë synim duhet ta ketë edhe Projektligji për investime të huaja. Mirëpo, a mund të arrihet ky synim vetëm përmes një ligji, i cili investitorin e huaj në Kosovë e bën të paprekshëm nga autoritetet vendore, kurse pronën e tij të pacenueshme. Kjo premton një efekt të kufizuar, meqenëse kjo mbrojtje ligjore nuk i garantohet investitorit vendor. Po ashtu, vetëm ky ligj nuk e ndërton ambientin stabil të qëndrueshmërisë dhe të sigurt për investime. Duhet edhe shumë ligje të tjera e në rend të parë efikasitet më i madh i institucioneve, funksionimi i shtetit ligjor dhe eliminimi i korrupsionit brenda institucioneve shtetërore.

Për shkak të qasjes diskriminuese që i bëhet biznesit dhe investimit vendor, kjo të bën inferior në raport me investimet e huaja, ose do ta detyrojë biznesin vendor me çdo kusht që të sigurojë së paku 25% investime të jashtme që ky biznes të quhet dhe të garantohet nga shteti jonë, si investime të jashtme. Kur e them këtë, kam parasysh dy fakte.

Në nenin 2, përkufizimet, pika 1.2 sqaron se investitor i huaj është secili person i huaj që bën një investim në Kosovë dhe pika 1.4, si investim nënkupton çdo aset në pronësi nga një person i huaj në Kosovë, me qëllim të kryerjes së aktivitetit të ligjshëm komercial. Në dukje, kjo është krejtësisht në rregull dhe nga aspekti teorik nuk ka se si të përkufizohet ndryshe. Por, a mjafton që dikush vetëm të jetë shtetas i huaj dhe të bëjë në Kosovë një investim çfarëdo qoftë ai dhe të jetë i mbrojtur nga çdo veprim i mundshëm, madje të jetë edhe më i fuqishëm se autoriteti shtetëror i Kosovës.

Unë jam për një ekonomi të lirë dhe për një treg konkurrues. Unë e dëshiroj secilin kushtëzim apo ndërhyrje të padrejtë të shtetit në ekonomi, në treg apo drejtpërdrejt në politikën e biznesit. Mirëpo, për ta siguruar privilegjin, çfarë ofron ky ligj, atëherë duhet të caktohen disa limite, qoftë duke saktësuar vëllimin e investimeve, apo duke i orientuar ato nëpër veprimtaritë ku vlerësohet se ka më shumë nevojë, apo të cilat garantojnë një qëndrueshmëri dhe stabilitet në procesin e zhvillimit ekonomik. Kjo nuk duhet të bëhet nëpërmjet diktateve, por duke e bërë një dallim nëpërmjet investitorit të fuqishëm dhe serioz, në raport me atë që nuk ka para, e as ndonjë referencë të besueshme në vendin prej nga vjen, apo në ndonjë treg tjetër. Ka edhe plot e përplot vërejtje të tjera në këtë projektligj, por në këtë rast po i veçoj vetëm ato që janë më kapitale.

Në nenin 3, pika 2, thuhet se çdo autoritet publik që shkel apo dështon t'i respektojë të drejtat dhe garancitë e siguruar për investitorët e huaj, do të jetë i detyruar të paguajë kompensim, do të thotë se e paguajnë menjëherë kompensimin pa pasur paraprakisht asnjë procedurë apo formë të verifikimit se me fajin e kujt ka ndodhur rasti. Së paku, ky ligj thotë ashtu. Domethënë, edhe një herë dua ta sqaroj se çdo kompensim, çdo dëm që i bëhet investitorit të huaj, në bazë të nenit 3, duhet që Kosova t'i mbulojë këto shpenzime, pa e verifikuar se nga është dëmi dhe kush e ka bërë atë. A është fajtor shteti i Kosovës, apo është fajtor vetëm investitori?

Në nenin 6, stabiliteti i regjimit të investimeve - sipas tij, Qeveria detyrohet ta kompensojë investitorin nëse bëhen ndryshime ligjore brenda pesë vjetëve, pas datës së bërjes së një investimi dhe në ndonjë mënyrë ai cenohet apo rrezikohet. Ky nen e sjell Qeverinë para situatës, në të cilën nuk guxon të bëjë asnjë ndërhyrje në ligj, pa e pasur

parasysh situatën e secilit investitor. Nëse duhet të jetë kështu, atëherë më mirë të thuhet se Qeveria nuk guxon të bëjë asnjë ndryshim në ligj për shkak se mund të jetë e gjobitur.

Si po shihet në këto dy nene, Qeveria e Kosovës duhet t'i kompensojë të gjithë investitorët e huaj, por ne duhet të dimë se investitorët e brendshëm, të cilët investojnë, nuk janë të mbrojtur në këtë mënyrë, me të cilën shteti i Kosovës i mbron investimet e jashtme.

Domethënë, pyes edhe deputetët kolegët e mi, a ka ndonjë ligj? Unë nuk kam hasur deri më sot që Kosova, shteti ynë, do ta mbulojë investitorin e brendshëm, nëse i ka bërë ndonjë dëm. Këtë deri më sot nuk e kam hasur!

Neni 11 parasheh kompensimin e dëmit, nëse ai ka ndodhur si rezultat i dhunës që lidhet me situatën e politikës. Pse Qeveria duhet ta marrë këtë përgjegjësi, e investitori nuk i detyron që ta sigurojnë pasurinë dhe investimet e tyre që i bëjnë në Kosovë?

Në nenin 11, përsëri është kompensimi i dëmit, nëse i ka ndodhur investitorit, e unë e mendoj që çdo investitor i huaj, i cili investon, dhe investitori i brendshëm duhet që kapitalin e vet dhe pronën e vet ta sigurojë, por jo nëpër kompanitë, të cilat sigurohen, sikur që janë në vendet e tjera dhe jo Qeveria gjithmonë duhet ta mbrojë dhe ta kompensojë.

Në nenin 29, autoritetet vendore anashkalohen krejtësisht. E pranoj fuqinë dhe autoritetin e konventave, të marrëveshjeve dhe instancave gjyqësore ndërkombëtare, por veprimi i tyre duhet të vijë pasi të shfrytëzohen të gjitha mjetet juridike që i ofron vendi. Në fund, neni 21 nuk e përkufizon qartë se çka është agjencia për zhvillimin dhe promovimin e sektorit privat, ndërkaq këtu sërish autoritet i pacenueshëm është MTI-ja.

Disa deputetë, parafolës të mi, kolegët të mi, e cekën edhe nenin 23, me të cilin shfuqizohen edhe tri ligje tjera. Domethënë, ligji i parë, i aprovuar nga ne për investimet e huaja, e unë mendoj që ai ligj i garanton të gjitha të drejtat e investitorëve të jashtëm, dhe dy ligjet e tjera, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe Ligji për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Unë mendoj se Kosova duhet ta ketë parasysh se ligjet në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë prioritet për investimet në Kosovë, se Kosova nuk mund të ketë investime aq të mëdha me kushtet dhe me ligjet e tjera, të cilat janë në fuqi, e edhe kolegu im Sadri Ferati e përmendi TVSH-në që vilet në kufi. Por, unë mendoj që ndoshta kolegu im e harroi për arsye se ekziston edhe Ligji i Doganave për 10% për lëndën e parë. Cili investitor serioz do të vijë në Kosovë të investojë, kur e di se në këtu ekziston 10% për lëndën e parë. Pse duhet të investojë në Kosovë, kur në Maqedoni, në Serbi, në Shqipëri, në Mal të Zi nuk ka doganë për lëndën e parë. Ne këtë e dimë edhe nga viti 1999, se gjithmonë kemi paguar edhe për makina, për makina për ndonjë prodhim e kemi paguar doganën 10%, dhe vjelja e TVSH-së është bërë në kufi. Kjo do të thotë se këtij ligji ne duhet t'i paraprijmë me disa ligje përparshme, të cilat duhet t'i përmirësojmë. Ta heqin totalisht doganën për lëndën e parë. Është ligji që tash do të vijë në fuqi për disa produkte

për të cilat do të hiqet dogana, por nuk është duke u hequr në përgjithësi për të gjitha prodhimet.

Duhet ta dimë se vjelja e doganës 10% për lëndën e parë nuk e ngarkon Buxhetin e Kosovës, për arsye se nuk kemi aq ndërmarrje që kanë kapacitete shumë të mëdha për prodhimet e tyre të gatshme. Dhe, unë propozoj që ky ligj t'i kthehet Qeverisë dhe të përmirësohet në shumë nene, për të cilat pajtohem edhe me Grupin Parlamentar të LDK-së, meqë edhe vetë jam aty, se ky ligj nuk duhet të aprovohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Kur njeriu e lexon këtë ligj, mund ta shtrojë një pyetje: A ka nevojë fare për këtë ligj?

Në fakt, po të zbatoheshin ligjet që i ka aprovuar ky Kuvend, e të shumtën janë ligjet e standardeve ndërkombëtare, të standardeve evropiane, po të sigurohej funksionimi i shtetit ligjor dhe konkurrenca e barabartë e të gjithë aktorëve në treg dhe ajo që promovon ky ligj, se investitorët e jashtëm dhe të brendshëm janë të barabartë para ligjit dhe në investime, atëherë ne nuk do të kishim nevojë për këtë ligj.

Natyrisht, ne mund të japim siguri, ndoshta është mirë të bëjmë ndonjë pauzë, zoti kryesues, se i kemi njerëzit në këmbë, po bisedojnë...

KRYESUESI: Nuk është hera e parë!

MUHAMET MUSTAFA: Domethënë, nëse kemi nevojë për ta shtuar sigurinë e investitorëve, e ky është problem real, sepse Kosova, sa i përket sigurisë së investitorëve, rangohet keq, është ranguar të jetë keq edhe tash. Rangohet të jetë keq, por nëse e shohim pse ata investitorë nuk kanë siguri, ata nuk kanë siguri për shkak të sistemit gjyqësor dhe të problemeve në realizimin e kontratave dhe marrëveshjeve të tyre.

Investitorët nuk ankohen që nuk kanë favore këtu. Ata ankohen që nuk zbatohet ligji. Ka probleme me kontrata, ka probleme me prokurimin, ka probleme me qasjen ekspeditive të institucioneve në zgjidhjen e problemeve të licencave. Këto janë tri çështje dhe nuk di pse e ngarkojmë Kuvendin me ligjet, të cilat janë konfuze sikur ky ligj. Teksti i këtij ligji është jashtëzakonisht konfuz, është shumë vështirë të kuptohet, është e qartë që është një përkthim i keq i një teksti të kompiluar prej shumë teksteve në anglisht edhe problemi me të vërtetë nuk do të zgjidhet me këtë ligj.

Prandaj, nëse Kosova do investime të jashtme, nën një - kontratat duhet të mbrohen në mënyrë efikase me gjyqe, nën dy - institucionet e pushtetit qendror dhe lokal duhet të jenë ekspeditive në dhënien e licencave, e jo të kushtëzohen dhe, nën tre - të rregullohet prokurimi, e mandej dalim te taksat e te çmimet e kredisë. Këto janë çështje, që në qoftë se duam investime këtu, duhet të bëjmë ndryshime. Jo të krijojmë administrim. Problemi është te neni 11. Edhe unë pajtohem që duhet të jemi të kujdesshëm çka po formulojmë

me atë nen. Te konflikti i armatosur dhe trazirat qytetare - këtu investitorët e jashtëm bëhen më të privilegjuar se sa investitorët vendorë.

Mirëpo, meqenëse Kosova është bërë anëtare e Bankës Botërore, aty ekziston një agjenci për garancinë multilaterale të investimeve në botën e jashtme, në vendet siç është Kosova. Prandaj, çdo investitor i jashtëm, kur të vijë në Kosovë, mund të marrë një garanci prej asaj agjencie për të ashtuquajturin “rrezik jokomercial” dhe ne duhet të jemi të kujdesshëm çka po fusim në ligj, në nenin 11.

Neni 21 dhe 23 janë shumë problematikë dhe më duket se këto dy nene e kanë krijuar nevojën që të krijohet një ligj dhe po e ndërrojmë Ligjin për investime për të ndërruar diçka tjetër. Këtu theksohet që të fuzionohen do agjenci, të bëhet një agjenci e ri, të shfuqizohet një ligj tjetër për NVM-të. Në qoftë se duhet ta përkrahim dikë, duhet t'i përkrahim ndërmarrësit e rinj që krijojnë vende të punës në ndërmarrje. Tash po e shfuqizojmë atë ligj! Nuk kemi kurrfarë arsytimi, as për fuzionimin e agjencive, as për shfuqizimin e ligjit. Domethënë, në krejt tekstin e ligjit ka shumë fjalë, por asnjë arsyetim pse e bëjmë këtë. Prandaj, ky është improvizim i rëndë, improvizim i rëndë i këtij teksti ligjor. Prandaj, u lutem deputetëve që të kenë kujdes! Edhe komisionet kur i shqyrtojnë këto ligje, edhe kur vijnë këtu, që të mos lejojnë ligje dhe improvizime të tilla.

Në qoftë se duhet krijuar një agjenci të përbashkët, në tekstin e ligji duhet të arsyetohet - pse? A do të zvogëlohet numri i të punësuarve? A do të bëhet më efektive kjo agjenci? Çka do të ndodhë me këtë? Apo vetëm do të bëjmë ndërrime të personelit atje, fushata të ndërrimeve që mund të ndodhin? E unë besoj që pas këtij ligji fshihen edhe ato.

Mandej, çështja e shfuqizimit. Pse duhet shfuqizuar Ligjin për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme? Asnjë arsyetim nuk e kemi. Unë mendoj se ky ligj duhet kthehet dhe të punohet në mënyrë më serioze. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Zëvendëskryeministër, të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Gati tetë vjet po i bëj në institucione, në Parlament dhe Qeveri, kurse është rasti i parë që ne e kemi një ligj, i cili pothuajse 90% është kopjuar prej ligjit të vjetër.

Unë nuk di që kemi pasur një rast tjetër, kur 90% e ligjit të vjetër bartet në ligjin e ri dhe silltet në Kuvend si ligj i ri. Nga ana procedurale, së pari unë besoj se nëse një ligj duhet ndryshuar së paku 40% për t'u bërë ligj i ri, e jo i kemi vetëm 2 apo 3 nene, që në realitet e rregullojnë një lëmi të re. Nëse e merrni ligjin në tërësi e ta shikoni, e shihni që janë krejt çështje e 2 apo 3 neneve, me të cilat bëhet fuzionimi i dy agjencive dhe shfuqizohet një ligj tjetër, që për mendimin tim, pajtohem plotësisht me profesorin Mustafa, që nuk ka kurrfarë arsytimi që ne sot ta shfuqizojmë Ligjin për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, dhe heqja e dy këshillave që tanimë kanë ekzistuar.

Nëse është çështja e fuzionimit të dy agjencive, në parim nuk kanë problem, ajo çështje është koncept i Qeverisë dhe mund të vazhdojë pa kurrfarë problemi, por është dashur të vijë Ligji për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të dispozitat që kanë të bëjnë me agjencinë. Ato dispozita të ndryshohen dhe të barten në departamente të caktuara të asaj agjencie, të barten në një agjenci tjetër, por jo të shfuqizohet një lëmi, e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme për ekonominë e Kosovës.

Në anën tjetër, i kemi dy këshilla aktuale, njëri është bord këshillëdhënës në kuadër të Ministrisë, është Agjencia për Promovimin e Investimeve, që prapë besoj se është i mirë, por është çështje e Qeverisë nëse e mban apo jo; kurse tjetri - Këshilli i Investitorëve të Huaj në Zyrën e Kryeministrit, besoj se është jashtëzakonisht i rëndësishëm, i cili duhet të vazhdojë edhe më tutje dhe nuk është dashur të ndryshohen dispozitat, të cilat kanë të bëjnë me atë këshill. Çdo investitor i jashtëm, posaçërisht investitorët e mëdhenj, besoj se duhet ta kenë një forum, ku mund t'i shprehin mendimet e tyre. Forumi më i mirë është ai që drejtpërdrejt i drejtohet kryeministrit për problemet e tyre. Ai është një këshill që mbledhet një herë në gjashtë muaj, apo një herë në vit, dhe i shpreh qëndrimet e veta para kryeministrit. Kështu që unë besoj që është gabim të hiqet ai këshill, i cili i mbledh investitorët dhe kryeministri dhe Qeveria njoftohen drejtpërdrejt me problemet që ekzistojnë në fushën e investimeve të huaja.

Sa i përket mbrojtjes së investitorëve, që u përmend, unë besoj se duhet bërë një sqarim se po kemi pak keqkuptime në mbrojtjen e investitorëve. Në studimin e Bankës Botërore, të bësh biznes nuk do të thotë mbrojtja e investitorëve në aspektin fizik. Aty kemi të bëjmë me mbrojtjen e investitorëve apo të aksionarëve të vegjël në kuadër të shoqërive aksionare, apo në kuadër të kompanive. Dispozitat ligjore në Ligjin për shoqëritë tregtare i kanë rregulluar të gjitha këto çështje dhe tash nuk e kemi atë problem. Kështu që kjo nuk ka të bëjë me mbrojtjen e investitorëve, apo me mbrojtje fizike të investitorëve, çfarë po pretendohet në ligjin aktual dhe në këtë ligjin e tashëm për ta rregulluar.

U përmend çështja e zvogëlimit të investimeve prej viteve në vit, prej vitit 2007, edhe në kohën kur unë e kam udhëhequr Ministrinë, dhe ka vazhduar i njëjti trend edhe në këto dy vjetët e fundit. Duhet të jemi shumë realistë, investimet e huaja nuk kanë të bëjnë me legjislacion. Legjislacioni aktual në fuqi është jashtëzakonisht i mirë. I kemi dy probleme, nëse i ndajmë ato; problemet ekonomike dhe problemet politike, që lidhen me sundimin e ligjit. Kështu që në aspektin ekonomik, aty i kemi dy: problemin e tregut të vogël, kemi problemet me energjinë dhe problemet tjera ekonomike, me infrastrukturë etj. Kurse, në aspektin politik, i dimë problemet politike që i kemi dhe natyrisht sundimi i ligjit, i cili ka të bëjë me një pjesë të territorit, por edhe me zbatimin e kontratave dhe të vendimeve të ndryshme, apo të marrëveshjeve që i bëjnë bizneset e tyre.

Kështu që, nuk po pretendoj që ligji aktual nuk ka pasur nevojë të ndryshohet. Është krejt normale që ka vende ku duhet të ndryshohet ligji, por me këtë projektligj këtu ne e kemi ligjin e vjetër parimisht në fuqi. Me ligjin e ri po e fuqizojmë ligjin e vjetër, e në realitet kurrë nuk po ndryshojmë në aspektin legjislativ. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Të pranishëm janë 67 deputetë. Shpresoj që gjatë amendamentimit do të kihet parasysh gjendja e rëndë e punësimit në Kosovë dhe të favorizohet më shumë punësimi i njerëzve nga ndërmarrjet që punësojnë njerëz nëpërmjet ligjit.

Zoti ministër, nuk e do fjalën? Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

A ka pa kartelë? A je kundër, apo për ti? Kundër! Ti? Për! Jo, situata është diskutabile, duhet parë kush është pa kartelë dhe duhet marrë parasysh. Ju lus, në Grupin Parlamentar të LDK-së kush është pa kartelë? Dy, jeni për apo kundër? Kundër! Za ili protiv? Za! Çka? A ke kartelë ti? E përsëritim votimin!

Atëherë, është votimi është i barabartë dhe unë nuk dua ta përdor votën e dyfishtë, as nuk kam nevojë të bëj ashtu. Por, votojmë edhe një herë. Çka të bëjmë tash, Sabri? Ka kaluar, se me Rregullore unë i kam dy vota. Ok-ej! Votojmë edhe një herë. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Atëherë, a ka pa kartelë? Një! Atëherë, konstatoj që nuk kalon. 38 vota janë kundër, 4 abstenime, për janë 37. Ligji nuk kalon. Faleminderit!

Unë mendoj se në qoftë se mund ta rregullojmë me një praktikë më të rregullt, nuk kemi nevojë as të protestojmë, as ta ngremë zërin. Po përpiqem të jem i saktë dhe korrekt me të gjithë.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokaturën Shtetërore

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin për Avokaturën Shtetërore dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin. Zoti zëvendëskryeministër, e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që para jush ta paraqes për miratim Projektligjin për Avokaturën Shtetërore.

Ky projektligj është i përcaktuar me programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për këtë vit dhe paraqet njërin prej prioritetëve dhe angazhimeve të Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim të krijimit të një sistemi të qëndrueshëm, funksional, të pavarur për

përfaqësimin e autoriteteve publike në Republikën e Kosovës në procedurat gjyqësore të arbitrazhit dhe të administratës.

Ministria e Drejtësisë, në bazë të legjislacionit në fuqi, ka përgjegjësi të plotë për përfaqësimin e Qeverisë dhe institucioneve tjera në procedurat gjyqësore dhe vetëm në periudhën janar-shkurt 2012 ka proceduar 1 610 raste në procedurën kontestimore, jokontestimore, përmbaruese dhe atë administrative. Natyrisht, Ministria e Drejtësisë i ka marrë parasysh të gjitha sfidat dhe problemet që janë paraqitur gjatë kësaj kohe dhe në përfaqësimin gjyqësor, dhe me qëllim të rritjes së efikasitetit ka ardhur në përfundim që ka nevojë që të krijohet një institucion i ri, sikur që është Avokatura Shtetërore, e cila do ta rregullonte shumë më mirë përfaqësimin e institucioneve gjyqësore të vendit tonë.

Me këtë projektligj rregullohet: themelimi, organizimi dhe kompetencat e Avokaturës Shtetërore të Republikës së Kosovës, kushtet dhe procedurat e avokatit të shtetit, autorizimit të tij, puna, personeli dhe në veçanti do të rregullohet edhe çështja e bartjes së kompetencave dhe bashkëpunimit me divizionin për përfaqësim gjyqësor, afatet ligjore dhe mënyra e shfuqizimit të legjislacionit të aplikueshëm të Avokaturës Shtetërore, si dhe hyrja në fuqi të këtij projektligji.

Andaj, të nderuar deputetë, ju ftoj që pas shqyrtimit në parim ta miratoni dhe ta krijojmë një institucion të ri, do të thosha në Republikën e Kosovës, pas vitit '99, i cili do ta mundësonte një përfaqësim më profesional, të pavarur, më të shpejtë dhe efikas. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani e ka radhën nënkryetari i Komisionit FunkSIONAL, zoti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion, siç e thatë edhe ju, e ka shqyrtuar Projektligjin dhe konsideron se i përmbush kërkesat, edhe kushtetuese, edhe të teknikës legjislative, prandaj i sugjerojmë Kuvendit që ta aprovojë në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupet parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Krasniqi. Nuk është! E do dikush fjalën në vend të Krasniqit? Jo. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë dhe deputete të Kuvendit të Kosovës,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për Avokaturën Shtetërore, për të cilin para se t'i paraqesë vërejtjet dhe komentet konkrete duhet theksuar se është më se i mirëpritur, sepse e rregullon një marrëdhënie shoqërore tejet të rëndësishme në vendin tonë, e cila deri më tani nuk ka qenë e rregulluar me ligj të

veçantë, gjë që ka ndikuar në kualitetin e përfaqësimit të autoriteteve publike kosovare para gjykatave dhe organeve të tjera kompetente.

Ndërsa, lidhur me dispozitat konkrete të këtij draftligji, do t'i veçoja këto çështje: 1. vërejtja e parë ka të bëjë me nenin 9 të këtij drafti, me të cilin përcaktohen kompetencat e Avokaturës Shtetërore. Kështu, në paragrafin e parë të këtij neni janë përshkruar në mënyrë tejet të përgjithësuar kompetencat e Avokaturës Shtetërore. Kurse, në paragrafin e dytë të nenit 9 haset një formulim edhe më i papërcaktuar, në të cilin thuhet: "Avokatura Shtetërore kryen edhe punë të tjera, të përcaktuara me ligj".

Pra, formulimi i tillë nuk specifikon se për çfarë punësh, e as për çfarë ligji bëhet fjalë. Prandaj, është mirë që në këtë nen, apo eventualisht të shtohet edhe një nen tjetër, në të cilët do të duhej të përcaktoheshin në mënyrë të specifikuar, sikur kompetencat e Avokaturës Shtetërore, ashtu dhe institucionet dhe organet të cilat do të përfaqësohen nga ajo.

Në këto nene, pa mëdyshje duhet rregulluar që Avokatura Shtetërore, jo vetëm të përfaqësojë, por edhe të mbrojë institucionet e Republikës së Kosovës. Po ashtu, këtu duhet bërë konkretizimin e institucioneve, të cilat i përfaqëson Avokatura Shtetërore. Pra, duhet sqaruar nëse përfaqësohen vetëm institucionet qendrore dhe ato lokale, apo edhe agjencitë dhe personat e tjerë juridikë, financimi i të cilëve sigurohet nga Buxheti dhe mjetet e tjera të Republikës së Kosovës.

Grupi Parlamentar i LDK-së po ashtu mendon se edhe kompetencat e Avokaturës Shtetërore duhet të përpunohen dhe të specifikohen në disa aspekte. Pra, me këtë draft duhet theksuar se Avokatura Shtetërore, jo vetëm që përfaqëson, por edhe e mbron Republikën e Kosovës, por edhe duhet shtuar se për këtë mbrojtje juridike avokatura i shfrytëzon mjetet juridike para gjykatave dhe organeve të tjera kompetente, me qëllim të realizimit të të drejtave dhe interesave pasurore të Republikës së Kosovës dhe të institucioneve të saj.

Më tutje, në këto nene duhet specifikuar llojet e procedurave, natyrën e lëndëve gjyqësore dhe pozitën e institucioneve në çështjet në të cilat avokatura i përfaqëson dhe i mbron ato. Po ashtu, kur bëhet fjalë për kompetencat e Avokaturës Shtetërore, vlerësojnë se duhet shqyrtuar edhe mundësia e zgjerimit të këtyre kompetencave me kompetenca shtesë, përveç atyre që kanë të bëjnë me përfaqësim dhe me mbrojtje. Në këtë rrafsh, duhet trajtuar që Avokatura Shtetërore, me kërkesën e institucioneve që i përfaqëson, t'u ofrojë edhe shërbime të tjera në formë të këshillave ligjore, mendimeve, përgatitjes së kontratave dhe dokumenteve, pastaj në formë të sugjerimeve, të ndihmës juridike, si dhe në formë të ndërmjetësimit për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet institucioneve, të cilat përfaqësohen dhe mbrohen prej saj.

Vërejtja tjetër ndërlidhet me nenin 10, i cili e rregullon funksionin e avokaturës e, sipas mendimit tonë, është mirë që në këtë nen të parashihet që avokati i përgjithshëm ta ketë edhe së paku një zëvendës, i cili, përveç që do ta ndihmonte në kryerjen e punëve në

rrethanat e caktuara, edhe do ta zëvendësonte atë, duke i përmbushur obligimet dhe përgjegjësitë e avokatit të përgjithshëm.

Vërejtja e radhës ka të bëjë me nenin 17, paragrafi 1, dhe me nenin 22, paragrafi 2. Kështu: sipas nenit 17, avokati i përgjithshëm emërohet nga Qeveria e Kosovës, kurse sipas nenit 20, paragrafi 2, po qe se për shkaqe të paarsyeshme avokati i përgjithshëm nuk e merr detyrën në afat prej 15 ditësh nga dita e emërimit, atëherë ministri i Drejtësisë e anulon vendimin për emërim. Mendoj se në parim, nuk është në rregull që ministrit me ligj t'i njihet e drejta për t'i anuluar vendimet e Qeverisë.

Më tutje, edhe te neni 17, paragrafi 3, me të cilin rregullohet struktura e Komisionit Profesional Vlerësues, mendojmë se duhet bërë një ndryshim konkretisht, sepse, sipas këtij paragrafi, anëtari i këtij komisioni, përveç tjerëve, duhet të jetë edhe një profesor i Fakultetit të Drejtësisë, dhe atë i drejtimit Civilo-Juridik.

Duke i pasur parasysh kompetencat dhe fushëveprimin e avokatit të përgjithshëm, jam i mendimit se nuk ka nevojë të specifikohet drejtimi i profesorit, por më duket se është e mjaftueshme që ai të jetë profesor i Fakultetit të Drejtësisë. Po ashtu, duhet ndryshuar edhe paragrafin 1, pika 6 të nenit 21, dhe paragrafin 1, pika 5 të nenit 22, me të cilët përcaktohet që pushimi i funksionit të avokatit të përgjithshëm, respektivisht atij shtetëror, të pasojë po qe se bartësi i tij është dënuar me vepër penale me dashje, me dënim me burgim pa kusht, në kohë zgjatjeje jo më pak se 6 muaj.

Mendoj se këta paragrafë duhet të riformuluar, duke u thjeshtësuar dhe përcaktuar që funksioni i avokatit pushon me vetë faktin e dënimit të tij për vepër penale me dashje, pa specifikuar se është dënim me kusht apo pa kusht. Pra, për një masë të tillë mjafton që avokati të jetë i dënuar për vepër penale.

Gjithashtu, edhe çështja e suspendimit të avokatit të përgjithshëm dhe atij shtetëror nuk është e rregulluar në mënyrë të kënaqshme me këtë draft. Është vlerësimi yni se paragrafi 1 dhe paragrafi 2 i nenit 19, me të cilin trajtohet suspendimi, janë në kolizion ndërmjet veti, sepse derisa në paragrafin e parë decidivisht thuhet: "Suspendimi zgjat derisa personi gjendet në paraburgim", në paragrafin e dytë për t'u suspenduar përkohësisht avokati, përveç se duhet të jetë në paraburgim, kërkohet që të plotësohet edhe njëri nga kushtet e radhitura prej pikës 2, 1 deri në ikën 2,5 të këtij neni, ku si kushte që duhen plotësuar për suspendim theksohen fillimi i hetimeve, ngritja e aktakuzës, fillimi i procedurës së shkarkimit të tij, e të tjera. Prandaj, gjatë shqyrtimit të mëtejme të këtij draftligji duhet pasur kujdes që paragrafi 2 i nenit 19 të analizohet dhe riformulohet në atë mënyrë që mos të jetë në kolizion me paragrafin e parë të po këtij neni.

Lëshimi tjetër i këtij draftligji qëndron në faktin se me dispozitat e neneve 21 dhe 23 rregullohet pushimi dhe suspendimi i avokatit, kurse çështja e shkarkimit të tij theksohet vetëm në paragrafin 3 të nenit 27. Ky ligj patjetër duhet t'i ketë dispozitat e posaçme mbi shkarkimin e avokatit me të cilat si kusht për shkarkim duhet të jetë mosndërmarrja e masave adekuata për çështje gjyqësore, ku shteti është palë apo person i interesuar, kurse kusht tjetër duhet të jetë edhe të provuarit se me veprimin apo mosveprimin e tij ja krijuar

favore për personat e tjerë në dëm të shtetit, apo ka kryer eventualisht vepër penale. Kërkoj që veprimet e tilla të sanksionohen me shkarkim, sepse situatat e tilla jo rrallë paraqiten në veprimtarinë e përfaqësuesve të interesave të shtetit.

Leximi i kujdesshëm i këtij draftligji vë në pah se të njëjtit i mungojnë edhe dispozitat me të cilat rregullohet realizimi dhe përmbushja e të drejtave dhe detyrave të avokatit shtetëror, të cilat theksohen në fushëveprimin e këtij ligji. Gjithsesi, në radhën e të drejtave të avokatit, që duhet paraparë, është edhe e drejta për të kërkuar nga institucionet që i përfaqëson sigurimin e të gjitha sqarimeve, informacioneve dhe dokumenteve të nevojshme që kanë lidhshmëri me procesin gjyqësor. Kuptohet, këtij draftligji duhet shtuar edhe dispozitat ndëshkuese që do të zbatoheshin ndaj personave përgjegjës për mospërmbushjen e kërkesës së këtillë të avokatit shtetëror.

Krejtësisht në fund do të theksoja se Grupi Parlamentar i LDK-së, me gjithë vërejtjet dhe dobësitë e theksuara më lart, në parim e përkrah aprovimin e këtij draftligji dhe njëherësh tregon gatishmërinë që anëtarët e Grupit tonë Parlamentar ta japin kontributin e tyre në komisionet përkatëse, me qëllim të evitimit të këtyre dhe lëshimeve të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, zonja Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryesues!

Lëvizja “Vetëvendosje” do ta votojë Ligjin për Avokaturën Shtetërore. Gjatë analizës së këtij ligji kemi hasur në disa vërejtje, të cilat u përmendën, e të cilat do t’i adresojmë gjatë diskutimit në komision. Mirëpo, në këtë rast dua ta përmend kreun 3 të nenit 17, tek emërimi i avokatit të përgjithshëm shtetëror dhe avokatët shtetërorë, ku në paragrafin 1 thuhet: “Avokati i përgjithshëm shtetëror, propozohet nga ministri i Drejtësisë dhe emërohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës”, më pastaj menjëherë në paragrafin 2 të po këtij neni thuhet që avokati i përgjithshëm shtetëror dhe avokatët tjerë zgjidhen me konkurs të hapur publik, ose sipas Ligjit për shërbyesit civilë. Pra, ky është një nen që duhet rregulluar në atë mënyrë që të mos lërë hapësirë për interpretim dhe për keqpërdorim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës do ta votojë në parim këtë Projektligj. Shumë prej vërejtjeve, të cilat u thanë deri me tani qëndrojnë. Mendojmë se do të kemi mundësi, në bashkëpunim edhe me Qeverinë, që t’i bëjmë përmirësimet e mundshme në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni për Kosovë të Re, zonja Novobërdaliu e ka fjalën

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, zotëri nënkryetar! Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah në parim Projektligjin për Avokaturën Shtetërore, e natyrisht që kontributin tonë do ta japim në Komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, zonja Shinik.

MYFERA SHINIK: Teşekkür ederim!

Devlet Avukatlığı Yasasının işlenmesi, Kosovën'nin yeni bir enstitüye sahip olması demektir. Anayasal ve Yasal anlamda şartların doldurulduğunu gözönünde bulundurarak, böyle bir yasanın hazırlanmasının çok önemli olduğu görülmektedir. Yasa Tasarısında bazı maddelerin değişmesini önereceğiz. Öyle ki bununla birlikte 6+ Parlamenter Grubu olarak Bu Yasa Tasarısının birinci okunuşunu kabul etmekteyiz ve katkımızı fonksional komisyonlarda sunacağız. Teşekkürler!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bajrami e ka fjalën!

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Pa dyshim që ky Ligj është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse e themelon një institucion shumë të nevojshëm për mbrojtjen e interesit publik, në të vërtetë e transformon divizionin e përfaqësimit që aktualisht vepron te Ministria e Drejtësisë në një institucion të ri shtetëror.

Unë mendoj se themelimi i këtij institucioni do t'i ketë tri aspekte pozitive. E para do ta rrisë performansën e mbrojtjes së interesit publik me faktin se do ta kemi një agjenci shtetërore, apo do ta kemi Avokaturën Shtetërore kompetente për ta mbrojtur interesin publik në të gjitha nivelet e administratës publike, në të gjitha institucionet që financohen nga buxheti i shtetit të Kosovës. E dyta, do të rrisë pak profesionalizmin e mbrojtjes së interesit publik, sepse jo rrallë ka pasur kritere të ndryshme të mbrojtjes të interesit publik dhe unë mendoj se Avokatura Shtetërore dhe avokatët shtetëror do të kenë tani përgjegjësi të shtuara, jo vetëm përgjegjësi, por edhe llogaridhënie për mbrojtjen e interesit publik dhe, momenti i tretë, në një mënyrë do ta centralizojë këtë funksion shtetëror te Avokatura Shtetërore, që është shumë e rëndësishme. Dhe unë mendoj se Avokatura Shtetërore duhet ta mbulojë mbrojtjen e interesit publik, edhe në nivel lokal, edhe në nivel shtetëror, dhe të gjitha institucionet duhet të bashkëpunojnë me këtë institucion, në mënyrë që ajo ta marrë përsipër, jo vetëm përfaqësimin e kontesteve gjyqësore administrative dhe kontestet civile, por edhe të gjitha kontestet e tjera.

Unë uroj që ky institucion të themelohet sa më shpejt, menjëherë posa të hyjë në fuqi ligji pas leximit të dytë, dhe uroj që përzgjedhja të jetë jashtëzakonisht mbi baza dhe kritere profesionale. Ajo çfarë duhet të kemi kujdes në implementimin e Ligjit, është që ky institucion të mos e ngarkojë shumë administratën shtetërore, edhe ashtu të stërngarkuar. Është e vërtetë që ky institucion me themelim do të nënkuptojë punësime të reja në administratë publike. Ne e dimë që kemi vërejtje të jashtëzakonshme të Bashkimit Evropian dhe të Studimi i Fizibilitetit sa i përket madhësisë së administratës publike që ka Kosova, por duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij institucioni, unë mendoj që nuk do të jetë një institucion që do të përfshijë shumë njerëz dhe nuk do ta ngarkojë buxhetin. Në anën tjetër, dobia dhe përfitimet nga një institucion i tillë do të jenë të shumanshme, sepse do të kemi mbrojtje adekuate të interesit publik në nivelin qendror, por edhe në nivelin lokal. Faleminderit!

KRYESUESI: Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e dëshiron fjalën. Atëherë, në sallë janë 65 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Me 57 vota për, 1 kundër, asnjë abstenim, konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Avokaturën Shtetërore.

Kërkohej nga Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Edhe një herë dua të ju kërkoj falje për keqkuptimin, që ndoshta ndodhi më parë gjatë votimit të mëhershëm. Është e vërtetë që sipas Rregullores, kur numri është i barabartë, nuk miratohet. Nuk miratohet dhe vota e kryetarit nuk është e dyfishtë në Kuvend. Është e tillë në mbledhjen e Kryesisë, që mendoj se edhe ajo nuk do të duhej të ishte ashtu.

Megjithatë, kishte shumë pa kartelë dhe u bë një pështjellim dhe më mirë që e përsëritëm. Faleminderit!

Atëherë, bëjmë pauzë të drekës deri në orën 14:00.

*Vazhdimi i mbledhjes plenare pasdite
(Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Po vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Regjistrimit Civil

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Rexhepi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin. Zori Rexhepi, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuari kryesues i Kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni ta prezantoj para jush Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil, të sponsoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për Agjencinë e Regjistrimit Civil është hartuar duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2012 dhe në pajtim të plotë me Rregulloren e punës së Qeverisë, nr. 09/2011. Ky ligj e rregullon themelimin, organizimin, strukturimin, detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Agjencisë së Regjistrimit Civil. Arsyeja për hartimin e këtij projektligji qëndron në faktin se aktualisht

në Republikën e Kosovës ekziston një udhëzim administrativ për Agjencinë e Regjistrimit Civil, i cili nuk e ka rregulluar në tërësi fushëveprimin e agjencisë.

Projektligji për Agjencinë e Regjistrimit Civil është i harmonizuar me Kushtetutën dhe instrumentet ligjore, të cilat janë pjesë direkte e zbatimit në Republikën e Kosovës dhe si i tillë u është përshtatur rrethanave të reja të krijuara në Republikën e Kosovës. Ky Projektligj përmban 4 kapituj dhe gjithsej 15 nene, duke filluar nga dispozitat e përgjithshme, dispozitat shpjeguese, si dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Hartimi i Projektligjit është bërë në pajtim me procedurat e parapara dhe për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat respektive nga Ministria e Financave dhe Ministria e Integrimit Evropian, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria me aqu communautaire.

Të nderuar,

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij Projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë të Republikës së Kosovës, kërkoj nga nju miratimin në parim të këtij projektligji. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit, e do fjalën? Mirë, fjalën e ka deputeti Anton Quni, anëtar i Komisionit.

ANTON QUNI: Po, në emër të Komisionit.

Faleminderit, zoti kryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë, në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2012, e shqyrtoi në parim projektligjin në fjalë dhe Kuvendit ia paraqet rekomandimin që të miratohet në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të projektligjit për Agjencinë e Regjistrimit Civil, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit për t'u proceduar për shqyrtim të parë dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Nëse më lejoni, edhe në emrin e Grupit Parlamentar të LDK-së i bashkëngjitem rekomandimit. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të PKD-së.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje,

Përshëndetje për ministrin dhe deputetët e nderuar,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe konsideron se është veprim i qëlluar i Ministrisë të Punëve të

Brendshme që e ka sponsorizuar në kohë dhe në këtë afat këtë ligj, ligj ky i cili do t'i rregullojë relacionin, strukturën organizative dhe kompetencat e Agjencisë për Regjistrimin Civil.

Ky ligj është në harmoni me standardet evropiane dhe është në harmoni edhe me Kushtetutën e Kosovës dhe nuk bie ndesh me legjislacionet në fuqi. Andaj, duke u bazuar në konceptet e tij dhe në standardet e këtij ligji me legjislacionin e Kosovës, propozojmë që të miratohet në lexim të parë dhe të shqyrtohet më tutje në lexim të dytë. Besoj që kontributin tonë do ta japim edhe në grupin për shqyrtimin e ligjit në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” do ta përkrahë këtë Projektligj në parim dhe kontributin tonë dhe vërejtjet eventuale do t'i japim nëpërmjet komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës? Nuk ka. Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re? Nuk ka. Në emër të SLS-së? Nuk ka. Në emër të Grupit “6+”? Nuk ka. Për votim nuk kemi kuorum.

Votimi shtyhet për më vonë. Pika e shtatë është hequr nga rendi i ditës. Pika e tetë:

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Auditimit për vitin 2011

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Auditimit për vitin 2011 nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime

Kryesia e Kuvendit, me rekomandimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka vendosur ta ftojë Auditorin e Përgjithshëm për ta paraqitur dhe arsyetuar para deputetëve të Kuvendit Raportin vjetor të Auditimit për vitin 2011.

E ftoj Auditorin e Përgjithshëm, zotëri Lage Olofson që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Raportin vjetor të Auditimit për vitin 2011.

LAGE OLOFSON: Dear Presidency, dear members of Parliament,

It is an honour for me to stand here in front of you today and to present my annual audit report regarding the budget year or the financial year 2011. My summarized comprehensive audit opinion on this report there I conclude that the annual financial statements of the budget of Republic of Kosova present in all material aspects a true and fair view of finances and financial situation for the fiscal year 2011.

This opinion is given in line with international recognized public sector audit in standards, and that means that the Kosovo budget report has been written in compliance with applicable standards, Laws and regulation. And this is for me very good. It is good

for Kosovo, it is good for you as legislation, it is good for the Government, for the citizens, for donors, and for potential investors in Kosovo, in all material aspect they can have trust in the way that our budget is accounted for. But at the same time we shall remember that this is based on the reporting requirements that we currently have in Kosovo, and that is not the same reporting requirements that we will need when we go further on a path towards the European Union. But anyway this is good, this is not happening everywhere.

When we say that this in all material aspects gives a true and fair view then it does not mean that we do not find some problems when it comes to the quality of the information, and we have found that the consolidation between the Kosovo Budget and the individual budgets of budget organizations are not fully as it should be. We have found cases where financial statements of budget spenders have been changed after you have received the report on the KB, and this has not been corrected afterwards. Transactions between budget spenders within the totality of the Kosovo Budget is always carried out and a high amounts of funds that Kosovo receive from donors goes directly to budget organizations and these are not reflected neither in the individual annual financial statements nor in this government report on Kosovo Budget.

So that are our areas where we can raise a quality of the information, but it is also some other areas where I think we need to raise the quality of information. I have already recommended the Government in order to get a better picture of what we in fact own to get a better base for decision-making and priorities that the Government must take further steps when comes to writing off bad debts, because the picture we have of the debts to the state is in fact overestimating our assets. And it is the same when it comes to tax that from socially owned enterprises, it is a big question mark for me when I see the figures presented that we are ever going to get these as tax revenues, and these must be handled as either doubtful or as bad, we will not get them back.

The same is with the debt that the KEK has to the state, the question is if can we estimate that we will have that everything to the state or not, this should be sold and of course this is a part of a possible privatization of the organization. And of course we must get into a situation where the internal business between different budget organizations is not blowing up, the totally turnover of our budget. So there are some things that I think that the Government should work further with when it comes to the quality of this information and I foresee that some of these things will be changed till we get the budget report of 2012. And I really recommend the Assembly to follow this tightly. This is then about the quality of the information, but we also have tried, based on the hundred of reports that we have carried out, to get a picture about the financial management within Kosovo public administration. It is a kind of generalization from the individual audits carried out.

I think it is important to firstly stress the fact that the Government has made progress in improving the public financial management system. We have a legal framework in place, its clarifications are made, updates have been made, but the factual implementation of this still need to be improved. And especially I think that it is needed to improve the operational planning, internal management reporting, external reporting, internal

financial control, procurement in general, and planning and managing of capital investments. In all these areas, it is important for us to take further steps in all these areas and the challenges we see, we share them these challenges with the conclusions made in the feasibility study, and they are a need to solve these questions on a path towards European Union. The effectiveness must become better when it comes to carry out the budget of Kosovo in general.

The biggest recommendations and the most important recommendations that we aim have done here, that is that related to the need for Kosova to strengthen their ownership over the public financial management reform. It is our view that this reform is scattered out in many different organizations, responsibilities are shared between different ministries and there is a number of projects working directly with different notes of the public sector without any real harmonization between them. And it is my opinion that the Government need to take a firm grip over this financial management reform if we want to see specific results. This is not about what individual budget spenders are doing, this is systematic problem in the systems that we have put in place in Kosova where we are trying to solve the issue about managing the budget wealth.

Few of our recommendations I have given to the Government here related to the PIFC system, relating to the E-assets system, relating to how the new procurement legal framework are implemented, related to how the civil service reform and the new Law on salaries of civil servants in fact are handled. All these recommendations they are here, I do not want to repeat them here, but I think that it would be good for the Assembly to consider if one should not put a requirement on the Government to report bad on what they have taken for kind of actions and what kind of results the Government has achieved, strengthening this till the Government presents the next KB report in the end of March 2013. If one linked this to this report you can then have a thorough discussion and analysis of what progress we have made at the same time as you can analyze the outcome of the budget for 2012. In this report we have also worked through different sectors in the public administration trying to see what is behind the shortcomings and challenges that we see.

Firstly then we have looked at central authorities and seen what are behind the problems we can see besides the general financial management problems. I do not intent to go through all of them but I am just going to stress a couple of issues that I think it is especially needed for the Assembly to be aware on. The first thing is that we recognize problems when it comes to the accountability line between ministries and executive agencies under them. When you discussed our reports, and we for example are talking about problems within the Ministry of Internal Affairs, we have an example where in fact problems very much are linked to the executive agency under the ministry. We also have a need if we are going to implement the budget good at the central level that every budget organization, every ministry is trying to specify the general Laws, the general administrative instructions on how one exactly in the individual ministry shall deal with the specific areas of public financial management, then needs to have internal guidelines applied for the different ministries and agencies. It can never be the same carrying out the

budget for an organization covering seven thousand five hundred people as the ministry of health or the Ombudsman for example.

Another area that we are trying to summarize as in the question about the independent institutions, you have set them up here, to have them as really independent institutions, when we are looking at the challenges they have, we get the conclusion here that the independent institutions in fact have problems in their independence due to the fact that they are too linked to the government. And being too linked to the government in practice when it comes to financial and operational independence is a problem where one have to see the reason for it in the way that the Assembly in fact is carrying out the budget dialogue with these institutions. I think there is a need for developing the approaches in this.

A third area we have looked on the municipalities and challenges they have when it comes to executing the budget especially important for the Parliament is that we now for the second year in a row are proposing that you should consider to reinstall executive managers in the municipalities, and make a clear border line between the ones responsible for giving service to the citizens and the political elected mayors. Municipalities service are important for all citizens, have to be planned with the time perspective but it is longer than time perspective of a mandate for an individual manager and an individual mayor in this case. In all these sectors, we see the need of getting more transparent information about what in fact is produced, what we get for the budget money to develop indicators on, what kind of service we are given to citizens, what things costs , etc.

These kinds of information do not exist in the annual financial reports, today in Kosovo, in a path to the European Union, this is a need. The fourth area that we are addressing is publicly and socially owned enterprises. We have carried out several studies of these, and we have recognized a number of problems in these when it comes to carrying out very important basic services for citizens, may it be waste, may it be water, may it be electricity, or whatever. We think that you in the Assembly has paved the way for a better situation by amending the Law on publicly owned enterprises but basically we still have the same problems. The ownership either is the state or municipalities, the board and the executive managers that are no clear accountabilities lines between all these and we are fiddling around instead of setting up a system that can ensure good service.

The last area we have mentioned in this report is the privatization area, privatization of publicly- private partnership, etc. and in general our biggest problem here that we want to focus here that is that the reporting we get on the annual results of the privatization is very complicated to understand. I think that the citizens of Kosovo, I think you and everyone interested need to have a much much easier information being able to say what are the results, what have we achieved. The voluminous report we get today says very much but it is hard to find what the reality are. I would like to stop with this, this is what we have covered, and my recommendation for the Assembly that is to consider, firstly to require changes in the Kosovo Budget report of 2012 as already mentioned but also that the recommendations given by me here and the decisions taken by the parliament here

today that you require that the Government is given you an answer till the 31.03.2013, what is done, what have we achieved. This is the way to get a better budget dialogue and to get a better service to citizens in Kosova. Thank you very much!

KRYETARI: Faleminderit! Radha e diskutimit është për kryetarin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputeti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: I nderuari kryetar,

Të nderuar ministra,

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, në bazë të nenit 62 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, ka mbajtur takim më 2.10.2012 dhe e ka shqyrtuar Raportin e Auditimit për vitin 2011.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin e Auditorit për vitin 2011, opinion i cili është i pakualifikuar, që do të thotë se pasqyrat janë prezantua një pamje të drejtë, të vërtetë të financave, si dhe gjendja financiare për vitin fiskal 2011.

Pra, pasqyrat janë prezantuar mirë dhe kjo na e jep mundësinë ta shohim më mirë çështjen dhe ta bëjmë një analizë më të thuktë. Kjo nuk nënkupton se edhe ka pasur menaxhim të mirë. Por, mënyra e prezantimit është e mirë, dhe ne e përshëndetim.

Ka progres në raportin e rregullsisë, ka avancime në prezantimin e pasqyrave financiare sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe sipas standardeve të Auditorit.

Sipas Raportit vjetor të Auditimit, Qeveria ka treguar progres në përmirësimin e menaxhimit të financave publike. Është azhurnuar korniza ligjore, edhe pse zbatimi lë hapësirë për t'u përmirësuar.

Megjithatë, menaxhimi i financave publike në Kosovë mbetet sfidë edhe e mëtutjeshme për institucionet e Kosovës.

Institucionet në nivelin qendror kanë treguar progres në fushën e raportimit, mirëpo fushat që kanë nevojë për zhvillimin e mëtejshëm janë planifikimi operativ dhe planifikim karshi nevojave dhe pretendimeve në kornizën afatore, përkatësisht në kornizën vjetore të prezantuar.

Raporti i brendshëm menaxherial, raporti i jashtëm për performansë, kontrolli i brendshëm financiar, prokurimi dhe menaxhimi i investimeve kapitale janë fusha që Qeveria edhe më tutje duhet të avancojë.

Çështja e borxheve të bartura nga viti në vit, gjë që nuk ka qenë të kaluarën, por që i kemi në tre vjetët e fundit, është një shqetësim për Komisionin dhe mendoj se Qeveria urgjentisht duhet ta shqyrtojë dhe të ndërmarrë masa pse është një gjendje e tillë.

Derisa në vitin 2009 ka pasur 4 milionë borxhe obligim që barten në vitin tjetër, do të thotë për vitin 2010; në vitin 2010, jo që nuk zhduket ai borxh, por rritet në 28 milionë,

për të shkuar për vitin 2011 në 40 milionë. Këtë vit edhe nuk e dimë, por gjasat janë që përsëri të kemi bartje të obligimeve. Kjo Qeveri na sjell në terrene të rrëshqitshme, të pastudiuara dhe sfidon, ashtu siç po sfidohen disa organizata, të cilat veç po përballen me këto çështje.

Institucionet e pavarura kanë arritur ta fusin në përdorim sistemin adekuat të menaxhimit financiar, edhe pse këto sisteme nuk funksionojnë plotësisht në praktikë.

Cilësia e informatave në pasqyrat vjetore financiare është përmirësuar dukshëm. Adresimi i rekomandimeve, krahasuar me vitin paraprak, është i kënaqshëm, e kjo ka ndikuar në përmirësimin e performansës së tyre institucionale.

Sfida mbetet ende. Nuk kanë arritur të krijojnë sistem adekuat për regjistrimin, mirëmbajtjen dhe raportimin e tyre vetjak. Këtu do ta shtoja edhe trajtimin e pasurisë.

Në një organizatë, ta zëmë, që para pak kohe ne e shqyrtuam, vërejtëm se në librat e kontabilitetit të asaj organizate buxhetore, po e themi publikisht, është Ministria e Punëve të Brendshme, kap shumën prej 29 milionë, ndërsa trajtimi apo vlerësimet sipas swift-kodit, të udhëhequr në Thesar, arrin shumën 40 milionë. Kjo na flet më së mirë që pasuria nuk trajtohet si duhet, nuk regjistrohet dhe nuk përcillet eventualisht mbikëqyrja dhe furnizimi ose përmirësimi i librave me furnizime të reja.

Ndërmarrjet publike, sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit nuk janë zhvilluar sa duhet.

Qeveria si aksionare nuk ka rast që ka marrë pjesë në takimet vjetore, takime këto në të cilat trajtohet gjithë problematika që e mundon atë kompani publike dhe Qeveria drejtpërdrejt do të njoftohej, do ta kishte një tablo, një pasqyrë të të gjitha të arriturave, përkatësisht për dobësitë e paraqitura në atë vit kalendarik. Po e theksoj edhe një herë se nuk ka asnjë rast që e kanë mbajtur.

Nuk ka arritur ta mbikëqyrë performansën në ndërmarrjet publike, pra dobësitë. Sipas auditimit del se ka vonesa për zgjedhjen e anëtarëve të bordeve dhe të komisioneve të auditimit.

Mosmbajtja e mbledhjeve vjetore të aksionarëve për zgjedhjen e anëtarëve të bordit, jo në përputhje me ligjin, ku disa nga anëtarët e bordeve nuk kanë përgatitje adekuate profesionale, kanë shoqëruar mungesë të madhe në ndërmarrjet publike. Prandaj, edhe lëshimet e keqmenaxhimet janë edhe më tutje sfidë, jo veç e kompanive publike, por edhe e Qeverisë. Dhe, unë mendoj, dhe atë që e tha zoti Lage, mendoj se Kuvendi duhet ta miratojë dhe të kërkojë nga Qeveria që ta hartojë një plan veprimi me rekomandimet e prezantuar, nëpërmjet së cilës do të shohim se Qeveria i ka adresuar problemet dhe sfidat të cilat e presin, i ka ndërmarrë masat dhe mekanizmat për tejkalimin e problemeve të shpalosura.

Menaxhimi i inkasimit të të hyrave në KEK, në KOST, në Kompaninë e ujërave, është i dobët, ndërkaq faturimi në formë paushalli paraqet problem në vete. Ka humbje të mëdha komerciale dhe teknike, për të cilat nuk ka as raport, e as vlera e tyre.

Institucionet e nivelit komunal, Komisioni për Mbikëqyren e Financave Publike, në pamundësi t'i trajtojë pasqyrat e auditimit financiar për secilën komunë, sepse janë 37, veç e veç e ka organizuar një dëgjim publik me të gjitha komunat, me qëllim të adresimit të të gjitha rekomandimeve me të dalat nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, së bashku me Ministrinë për Qeverisje Lokale, si dhe me Ministrinë e Financave.

Konkluzioni i Komisionit është se çdo komunë do të hartojë plan të veprimit për adresimet dhe rekomandimet e dërguara.

Pra, Komisioni mendon se nëpërmjet Kuvendit duhet t'i obligojmë kuvendet komunale që raportet e njëjta të Auditorit t'i trajtojnë në seancat e tyre, të ndërmarrin masa në hartimin e një plani të veprimit në tejkalimin e lëshimeve, të cilat Auditori i ka konstatuar.

Krahasuar me një vit më parë, nivelin komunal ka progres. Megjithatë, nga viti në vit, në formën e prezantimit të tabelave kemi progres. Derisa në vitin 2009, opinion të pakualifikuar ka pasur zero, do të thotë s'ka pasur asnjë, në vitin 2010 ka qenë po ashtu zero, në vitin 2011 i kemi 2 komuna që kanë opinion të pakualifikuar, do të thotë në prezantim të tabelave në mënyrë të drejtë. Por, gjithsesi është pak, se janë 37 gjithsej.

Numri i raporteve me opinion të kualifikuar, me theksim të pakualifikuar, me theks të çështjes, në vitin 2009 ishin 2, në vitin 2010 ishin 12, ndërsa në vitin 2011 gjithsej 14. Do të thotë vërehet një progres, por megjithatë jemi larg asaj që ne dëshirojmë, sepse nëse janë paraqitur 14, nga 37, shihet numri se sa kanë mbetur.

Numri i raporteve me opinion të kualifikuar në vitin 2009 ishte 2, në vitin 2010 janë 16, ndërsa në vitin 2011 janë 18. Sigurisht, ata që nuk i kanë pasur shifrat përpara e kanë pak problem ta kuptojnë, por rezultatet që do t'i them më vonë te mohimi i opinionit, atje ku s'ka pasur hiç pasqyra financiare, ta zëmë në vitin 2009 i kemi pasur 29 komuna që s'kanë prezantuar fare raport, domethënë s'ka pas hiç, as drejt, as shtrembër. Në vitin 2010 janë 9, ndërsa në vitin 2011 janë 3. Do të thotë, në vitin 2011 i kemi vetëm 3 komuna, edhe ato i përkasin pjesës veriore, që nuk i kanë prezantuar tabelat e tyre nëpërmjet të cilave Auditori, dhe Komisioni në këtë rast, do të mund të bëjnë një analizë të të gjeturave dhe rekomandimeve eventuale që do të dalin nga ajo. Nga kjo shihet se ka një progres në përgjithësi, por përkundër këtij progresi në disa komuna...

(Ndërprerje nga regjia)

KRETARI: Regjia, edhe 2 minuta!

ALI SADRIU: Faleminderit!

...ka stagnim, madje ka komuna që kanë kthim prapa. Prandaj, arsyeja që Auditori kërkon dhe Komision e mbështet atë kërkesë të një rekomandimi që raportet e Auditorit të trajtohen në kuvendet komunale, pra do të thotë asamblastët e komunës të njihen me rezultatet e të gjeturave.

Sfidë për komunat mbetet zbatimi i rekomandimeve të GZAP-it. Si rezultat i kësaj, dobësitë janë përsëritur nga viti në vit, duke rezultuar në një progres shumë të ngadalësuar.

Konkluzionet e përgjithshme: Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka konstatuar se dobësitë më të mëdha në fushën e menaxhimit të financave publike janë:

1. Institucionet buxhetore ende nuk kanë arritur menaxhimin e borxheve të cilat prej viti në vit po rriten. Është një shqetësim që Qeveria gjithsesi urgjentisht duhet ta trajtojë. E përmenda më herët se mund të vijë në situatë kolapsi si rezultat i obligimeve ose ekzekutimeve gjyqësore, çfarë i kemi në disa organizata buxhetore.
2. Ka mangësi në regjistrimin e aseteve materiale dhe financiare.
3. Ka mangësi të theksuara në fushën e prokurimit, përkatësisht në zbatimin e Ligjit të prokurimit.
4. Shpenzimi i buxhetit në 3 muajt e fundit të vitit, veçanërisht në investime kapitale; kemi rast kur brenda 2 muajve të fundit janë shpenzuar 58% e buxhetit kapital. Këtu shihet hapur që është shkelur Ligji mbi menaxhimin e financave publike, që i thërret edhe në përgjegjësi. Prandaj, është vënë si pozicion, si rekomandim që Qeveria gjithsesi ta hartojë një plan veprimi në tejkalimin e këtyre...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: A ke shumë? Mirë, edhe një minutë!

ALI SADRIU: Moskompletimi i njësive të auditimit dhe komiteteve të auditimit të organizatave buxhetore.

Mund ta them një konkluzion të përgjithshëm dhe të fuqishëm, që duhet të merret parasysh. Aty ku ka funksionuar Auditori i Brendshëm dhe janë përfillur rekomandimet e tij, problemet kanë qenë shumë më të vogla. Aty ku nuk e kanë përfillur, e në 7 raste nuk e kanë fare të formuar, problemet janë dhe Auditori i gjen. Kështu është edhe me Buxhetin e Kosovës, përgjithësisht. Nëse ne i trajtojmë këtu çështjet tona, në Raportin e Progresit sigurisht nga Këshilli i Evropës e kemi më mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Auditorit për vitin 2011.

Fillimisht dua ta përgëzoj Auditorin e Përgjithshëm, zotin Lage, për përgatitjen me kohë dhe me saktësi të raportit vjetor për vitin 2011.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka lexuar me kujdes dhe e ka analizuar Raportin vjetor të Auditimit dhe mendon se raporti në mënyrë të detajuar ka nxjerrë në pah të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet me qëllimin më të mirë për ngritjen e cilësisë së menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Ajo që ne do ta vlerësojmë shumë është se raporti i tregon se pasqyrat financiare si tërësi e kanë një opinion të pakualifikuar dhe janë në harmoni të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit.

Në këtë drejtim, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm e ka bërë një punë të mirë duke ndihmuar etnitetet e audituara në eliminimin e shumë gabimeve në pasqyra financiare dhe në përmirësimin e cilësisë së informacionit të raportuar.

Auditori i Përgjithshëm në këtë raport përfshin opinionet e dhëna të auditimit dhe mangësitë më domethënëse menaxheriale në secilin organ të audituar.

Roli i Auditorit të Përgjithshëm është që ta ofrojë një bazë për mbylljen e zinxhirit llogaridhënies ndërmjet Kuvendit dhe organizatave buxhetore. Por, raporti fokusohet edhe në disa të gjetura.

Këto çështje ne duhet t'i trajtojmë me kujdesin më të madh për një menaxhim më të mirë të financave publike dhe të kontrollit, menaxhimin e pasurisë, prokurimit publik, pasasë së imët, raportet financiare dhe operative profesionale dhe për një shpalosje të drejtë të tyre.

Ky besoj se duhet të jetë edhe synimi primar i Qeverisë së Kosovës. Nga Raporti vjetor i Auditimit të Përgjithshëm shohim se gjatë vitit 2011 janë kryer 88 auditime të rregullsisë, dhe janë dhënë opinione të ndryshme mbi pasqyrat financiare. Prej tyre 34 janë me opinion të pakualifikuar dhe 32 me opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, që do të thotë se 66, nga 88, ose shprehur në përqindje 75% e organizatave buxhetore kanë opinion të mirë, që nëse e krahasojmë me vitin e kaluar e kemi një përmirësim të dukshëm, për 32% më të mirë.

Auditori i Përgjithshëm e luan një rol kyç në promovimin e parimeve të llogaridhënies menaxheriale te komunat. Kjo arrihet duke kryer auditimet e detyrueshme të rregullsisë së ekzekutimit të BK-së dhe të disa institucioneve jashtë Buxhetit të Kosovës.

Nëpërmjet auditimit të rregullsisë, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka bërë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të të dhënave tjera, duke e ofruar një opinion.

Sa i përket progresit në komuna, në aspektin e cilësisë së raportimit financiar, mund të vërehet vetëm atëherë kur u referohemi opinionëve të auditimit gjatë tre vjetëve të fundit.

Dihet se buxheti vjetor i komunës miratohet sipas Ligjit të ndarjeve buxhetore.

Burimet financiare të komunës, përveç granteve nga niveli qendror, përbëhen nga të hyrat, nga tatimet, grandet operative, grandet për kompetencat e zgjeruara, grandet e jashtëzakonshme, përfitimet dhe huadhëniet komunale e të tjera.

Çështja e trajtimit të pamjaftueshëm të rekomandimeve nga komunat ka qenë mjaft shqetësuese. Edhe në këtë drejtim, Auditori i Përgjithshëm ka kërkuar përfshirjen e Kuvendit, në mënyrë që të propozohen masat përmirësuese, siç e ceku edhe zoti Lage për kryeshefin ekzekutiv.

Është pak shqetësues fakti se shumë prej komunave nuk kanë bërë akoma plane të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2011.

Është shqetësues po ashtu fakti që disa nga komunat nuk i kanë plotësuar kërkesat ligjore mbi raportimin financiar. Për shembull, vetëm 16 komuna i kanë përgatitur pasqyrat vjetore financiare në pajtim me rregullat financiare numër 07/2011 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore. Tri komuna nuk kanë dorëzuar raporte financiare 3-mujore te ministri i Financave, kurse vetëm 8 komuna i kanë përgatitur pasqyrat vjetore financiare në dy gjuhët zyrtare.

Në raport ka edhe të gjetura shqetësuese si pasojë e menaxhimit jo të mirë të zbatimit të pamjaftueshëm të ligjeve, prokurime jo të mira, menaxhim jo i mirë i aseteve, mosimplementim të rekomandimeve e të tjera.

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kërkon një angazhim shtesë të të gjithë aktorëve për sanimin e shkaqeve në vendosjen më të mirë të kontrolleve, menaxhimin më të mirë të rreziqeve, që do të rezultojë në ngritjen e efikasitetit dhe të vlerës së organizatës.

Një pjesë e çështjeve të përmendura në raport janë adresuar në ndërkohë nga Qeveria, përkatësisht nga Ministria e Financave, si pjesë e përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve dhe proceseve.

Për të gjitha rekomandimet që janë dhënë nga Auditori i Përgjithshëm duhet që Qeveria t'i ndërmarrë masat e nevojshme për adresimin e tyre.

Gjithashtu unë shpresoj se Auditori i Përgjithshëm do ta shfrytëzojë eksperiencën e vet dhe do ta ndihmojë stafin e tij në ngritjen e performansës dhe në kualitetin e raportimit të auditimit.

Në fund, do të kërkoj përkrahjen e gjithë deputetëve që të diskutojnë për të gjitha çështjet që do të ndihmojnë në një menaxhim më të mirë për shtyrjen përpara të implementimit të të gjitha rekomandimeve që dalin nga ky raport.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të vetëdijshëm për rolin dhe rëndësinë e auditimit, komentet, sugjerimet dhe rekomandimet tuaja do të jenë një kontribut i vlefshëm në ngritjen e performansës së auditimit, në përgjithësi, sepse një auditim i mirë do ta përmirësonte sistemin e kontrollit të financave publike, si rezultat i së cilës do të ishte një qeverisje më e mirë dhe transparente në shfrytëzimin e parasë publike.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës rekomandon që të miratohet Raporti vjetor i Auditimit, i prodhuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011 dhe i fton deputetët ta votojnë raportin me rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! LDK-ja e ka kryer. Mirë. “Vetëvendosja”, deputeti Afrim Hoti e ka fjalën.

AFRIM HOTI: Faleminderit kryetar!

Raporti vjetor i Auditimit për vitin 2011, i hartuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, konsiston në vrojtimin e zbatimit të buxhetit, konkretisht mënyrën e ndarjes, menaxhimit dhe shpenzimit të mjeteve buxhetore nga Qeveria dhe organizatat buxhetore.

Përveç kësaj, Zyra e Auditorit i ka verifikuar dhe ndërhyrjet politike në institucionet e pavarura nëpërmjet ndarjeve të mjeteve buxhetore dhe regrutimit të stafit të partive në pushtet nëpër këto institucione, me çka është dëmtuar rëndë profesionalizmi në këto institucione dhe si pasojë e kësaj ka pasur ngecje në kryerjen e punëve të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj. Mirëpo, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, përveç verifikimit të këtyre parregullsive, ka paraqitur edhe rekomandime, të cilat, nëse do të zbatohen në përpikëri nga ata që u dedikohen, atëherë rruga do të jetë më e lehtë drejt integritetit në Bashkimin Evropian.

Si rrjedhojë e kësaj, ne do t'i paraqesim disa çështje të përcaktuara në raport dhe që kanë rëndësi të veçantë.

Së pari, kjo Qeveri, me buxhetin e vitit 2011 u ka kushtuar rëndësi të veçantë pagave dhe mëditjeve, duke u renditur në vendin e parë, me 4 milionë e 782 mijë euro; pastaj në vendin e dytë alokohen mjetet për mallra dhe shërbime, me 4 milionë e 523 mijë euro, dhe pastaj për gjëra të tjera, e që kuptohet janë ndarë mjete në sasi më të vogël. Nga kjo shihet qartë se edhe ky buxhet ishte buxhet i luksit, e jo i zhvillimit ekonomik.

Së dyti, te menaxhimi i buxhetit, raporti ka evidentuar raste kur shpenzimet janë rritur në mënyrë të theksuar në tremujorin e fundvitit. Krejt kjo si pasojë e planifikimit të dobët që bëjnë organizatat buxhetore dhe një shenjë që tregon se ato luftojnë në fund të vitit që t'i shmangen suficitit. Edhe kjo e tregon qartë mungesën e ideve që do të kishin për qëllim përshejtimin e zhvillimit ekonomik të vendit.

Së treti, Auditori i ka identifikuar dobësitë e funksionimit të prokurimit publik. Këto mangësi kanë të bëjnë me lidhjen e kontratave të pasiguruara, fondet e nevojshme, gjë që rrit rrezikun që organizatat buxhetore të mos arrijnë t'i kryejnë me kohë obligimet e parapara me kontratë dhe t'u nënshtrohen ndëshkimeve të mundshme. Ka pasur mospërgatitje të duhur të dosjeve të tenderit që kanë dërguar drejtpërdrejt në favorizimin e ndonjë oferte nga organizata buxhetore.

Gjithashtu nuk ka pasur kontroll të mjaftueshëm në vlerësimin e tenderëve, gjë që ka shpënë në dhënien e kontratave, në mungesë të ofertave të përgjithshme e tjerë.

Së katërti, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka identifikuar te sistemi i shërbyesve civilë moskrijimin e akteve nënligjore nga Ministria e Administratës Publike, që është kusht për zbatimin e detajuar efektiv dhe efikas të Ligjit për shërbime civile dhe të Ligjit për pagat e shërbyesve civilë.

Përveç kësaj, Auditori i Përgjithshëm ka evidentuar mosrespektim të procedurave të regrutimit, të shpallura me konkurs. Për shembull, nuk është respektuar përvoja e punës, kanë munguar referencat për fushat përkatëse, nuk është formuar paneli intervistues, ka munguar shpallja e konkursit në shtyp e të tjerë.

Për më tepër, ka pasur edhe të punësuar pa konkurs. E gjithë kjo i ka dëmtuar liritë dhe të drejtat e njeriut.

Është ngarkuar buxheti i organizatës dhe ka ngecje në efektivitet dhe efikasitet të punëve që duhet të kryhen.

Dhe së pesti, raporti evidenton shumë ndërhyrje politike, si në aspektin e ndarjes së mjeteve, ashtu edhe në atë të punësimit.

Sipas raportit, kufizimet buxhetore nga Ministria e Financave dhe përcaktimi i kufijve buxhetorë, pa marrë parasysh kërkesat buxhetore të institucioneve të pavarura, paraqesin cenim të pavarësisë institucionale dhe financiare, gjë që është në kundërshtim me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike.

Përsëri sipas raportit, pas vendimit të Qeverisë, Ministria e Financave, ose ka reduktuar, ose e ka tërhequr nga 5 institucionet e pavarura.

Për më tepër, institucionet e pavarura nuk kanë mekanizma institucionalë, nëpërmjet të cilëve mund ta mbrojnë veten nga ndërhyrjet qeveritare në buxhetet e tyre.

Përveç ndërhyrjeve në aspektin financiar, ndikimi në institucionet e pavarura vazhdon edhe me punësim të personave të afërt me pushtetin. Kjo shihet në emërimet e tyre në bordet e këtyre institucioneve dhe në përzgjedhjet e drejtorëve ekzekutivë.

Në fund, paraqitja e këtyre çështjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit për vitin 2011, tregon qartë orientimin e ushtrimit të pushtetit ekzekutiv.

Mirëpo, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë këtë raport me të gjitha rekomandimet e cekura më lart. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, fjalën e ka deputeti Bali Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Auditimit për vitin 2011 dhe kemi vërejtur se me gjithë të arriturat, ende ka mangësi të shumta në funksionimin e financave publike të Kosovës.

Me gjithë faktin se ka avancime në raportet e rregullsisë, ka avancime në prezantimin e pasqyrave financiare sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, si dhe sipas standardeve të auditimit, megjithatë menaxhimi i financave publike në Kosovë është larg sfidave që kërkohen.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm gjatë vitit ka realizuar 88 auditime, edhe atë për institucionet e nivelit qendror, institucionet e pavarura, komunat, si dhe për ndërmarrjet publike.

Me gjithë faktin se Zyra e Auditorit ka edhe rekomandime të shumta, ato në shumicën e rasteve nuk adresohen dhe si të tilla nuk po gjejnë zbatim, e kjo është e lidhur direkt me mosinteresimin e menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve dhe me mosadresimin e tyre me kohë.

Shumica e rekomandimeve të dala kanë të bëjnë me raportin e brendshëm menaxherial, raportimin e jashtëm për performansën, kontrollimin e brendshëm financiar, prokurimin, menaxhimin e investimeve kapitale, çështjen e borxheve të papaguara nga institucionet dhe, si të tilla, ato po barten nga viti në vit.

Po ashtu, situatë e ngjashme mbretëron edhe në institucionet e pavarura. Me gjithë progresin e arritur, ato prapëseprapë po ballafaqohen me probleme të shumta në përdorimin e sistemeve adekuate për menaxhimin e financave. Ato ende nuk po arrijnë të krijojnë sistem adekuat për regjistrimin e të hyrave.

Institucionet e nivelit komunal e kanë një progres në fushën e menaxhimit të financave publike, e kjo vërehet më së miri nëse krahasohen opinionet e dhëna nga viti në vit nga raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të këtyre institucioneve. Përgjithësisht nga kjo bëjnë komunat në pjesën veriore të Kosovës, të cilat nuk i kanë dorëzuar pasqyrat

vjetore financiare dhe kjo e pamundëson Auditorin dhe dhënien e opinioneve për pasqyrat financiare.

Sfidë po ashtu për nivelin komunal mbetet zbatimi i rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe si rezultat i kësaj dobësitë janë përsëritura nga viti në vit, duke rezultuar me një progres shumë të ngadalshëm.

Ne si Komision për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në dy takimet individuale me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe në një dëgjim publik, ku ishin të ftuar të gjithë kryetarët e komunave, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Agjencia Anti-Korrupsion, si dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës, jemi përpjekur për trajtimin e këtyre çështjeve dhe në sensibilizimin e opinionit se kjo është një çështje që kërkon zgjidhje dhe se rekomandimet e Auditorit janë në të mirë të menaxhmentit, e jo në kundërt të tij.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka konstatuar se dobësitë më të mëdha në fushën e menaxhimit të financave publike janë: ka mangësi të theksuara në fushën e prokurimit, përkatësisht në zbatimin e Ligjit të prokurimit; ka mangësi në zbatimin e Ligjit të buxhetit, shpenzimin e buxhetit në 3-mujorët e fundit të vitit, veçanërisht në investime kapitale; ka mangësi në regjistrimin e pasurive nga shumë institucione buxhetore dhe regjistrimet nuk janë reale.

Institucionet buxhetore akoma nuk kanë arritur menaxhimin e borxheve, të cilat rriten prej vitit në vit.

Mirëpo, shpresoj se një bashkëpunim i institucioneve të nivelit qendror dhe lokal me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, si dhe me njësinë e qëndruar të auditimit të brendshëm të Ministrisë së Financave, në të ardhmen e afërt, këto çështje do të avancohen drejt një zgjidhjeje të qëndrueshme.

Grupi Parlamentar i Aleancës do ta përkrahë në parim këtë raport.

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, nuk ka të lajmëruar. Në emër të SLS-së, gjithashtu nuk ka. Në emër të Grupit “6+”, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e shqyrtoi Raportin vjetor të Auditimit për vitin 2011 dhe konstatoi se është një raport i detajuar, sipas të cilit shihet se menaxhimi financiar, rekomandimet e adresuara, borxhet e bartura dhe evidentimi i pasurisë ende mbeten sfidë.

Mirëpo, duke pasur parasysh se ky raport, në krahasim me të kaluarin, ka progres të theksuar, Grupi Parlamentar “6+” do ta votojë, me rekomandimet e dala. Faleminderit!

KRYETARI: Dua t'i them edhe unë 2-3 fjalë, jo mbi bazën e raportit, por mbi bazën e raportimit që e bëri shefi i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. I kam identifikuar nja 3-4 çështje, pak më të vogla, kurse 2-3 pak më të mëdha.

Në një, Auditori i Përgjithshëm tha se borxhet e këqija janë një anë e dobët e gjendjes në institucione, në përgjithësi.

Borxhet që KEK-u ia ka shtetit, që nuk e di nëse i dimë sa janë.

Pastaj, planifikimi operativ duhet të përmirësohet. Jemi disa vite duke i përsëritur të njëjtat çështje.

Dhe, efikasiteti duhet të përmirësohet.

Sigurisht Auditorit i ka rënë të flasë me një gjuhë më të butë, por këto për institucionet tona, edhe për ne duhet të jenë shqetësim. Si çështje më të mëdha, mendoj që u tha gjithashtu nga raportimi i Auditorit të Përgjithshëm janë: s'ka vija të qarta të llogaridhënies, e nëse nuk ka vija të qarta të llogaridhënies, kjo do të thotë se gjendja është mjaft e keqe dhe ligji nuk respektohet.

Gjithashtu, një çështje tjetër nga ajo që e tha Auditori, e që është shqetësuese, është çështja e privatizimit. Ai tha: "Privatizimi është shumë i komplikuar dhe nuk e kuptojmë". Nëse Auditori i Përgjithshëm nuk e kupton, si ta kuptojnë të tjerët këtë komplikim të procesit të privatizimit?! Bile ai u shpreh se edhe nuk dihet realiteti dhe nëse është një agjenci që vërtet e privatizon pasurinë e Kosovës dhe Auditori i Përgjithshëm nuk e di realitetin, atëherë kush duhet ta dijë se cili është realiteti, dhe nëse nuk dihet në këtë institucion të pavarur cili është realiteti, atëherë këtë realitet duhet ta hulumtojë Prokuroria e Kosovës. Dhe, natyrisht, Auditori na vesh ne për obligim - Kuvendin e Kosovës, që ta kërkojmë ndryshimin e raportit në vitin 2012, por nuk di cila do të jetë mundësia e Kuvendit për të kërkuar ndryshimin e raportit të Qeverisë për vitin 2012.

Dhe, realisht, po të ecim nëpër këto pika që i tha Auditori i Përgjithshëm, kjo e tregon gjendjen në një sferë tjetër se sundimi i ligjit në këto institucione që i ka audituar Auditori i Përgjithshëm nuk është në gjendje të mirë, dhe konsideroj se kjo duhet të na shqetësojë të gjithëve në Kosovë, por në mënyrë të veçantë duhet ta shqetësojë Kuvendin si institucion, dhe deputetët si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës në institucionin më të lartë përfaqësues.

Unë po e mbyll këtë këtu me këto shqetësime të mia. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari e falënderoj edhe Auditorin e Përgjithshëm, drejtorin e këtij institucioni të pavarur, zotin Lage, për prezantimin e këtij raportit.

Me këtë raport vjetor të auditimit për vitin 2011 është dhënë opinion i pakualifikuar, si dhe është paraqitur progres dhe përmirësim në sistemin e menaxhimit të financave publike. Mirëpo, kërkohet akoma më tepër përmirësim në fushat, si: përmirësimi i raportimit të brendshëm menaxherial, kontrolli i brendshëm financiar, fusha e prokurimit, si dhe menaxhimi i investimeve kapitale. Sipas raportit, sfida më e madhe në zbatimin e buxhetit ka të bëjë me mungesën e kontrollit menaxherial. Ekziston një domosdoshmëri shumë më e madhe që të hartohen udhëzimet e brendshme, të hartohen rregulloret e brendshme sa i përket llogaridhënies ndërmjet ministrive dhe agjencive ekzekutive, do të doja të shtoja edhe të institucioneve varëse të disa ministrive përkatëse.

Në këtë raport, si sfida janë paraqitur edhe menaxhimi dhe mbikëqyrja e dobët e projekteve, avancat e paguara përpara përfundimit të punëve dhe niveli i ulët i ekzekutimit të buxhetit. Do të doja të shtoja se sipas planifikimit që bëjnë organizatat buxhetore, ato janë të obliguara që buxhetin ta shpenzojnë në fazat tremujore, e jo në tre muajt e fundit të vitit kalendarik, sepse nëse buxheti nuk shpenzohet sipas fazave tremujore, atëherë është në kundërshtim me Ligjin mbi menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë. Dhe, me të drejtë, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka paraqitur si vërejtje për organizatat buxhetore që buxheti po shpenzohet dhe pagesat e shumta po bëhen në tremujorin e fundit të vitit. Pastaj, si sfida tjera janë paraqitur edhe trajtimi i dobët i të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme, menaxhimi në fushat e raportimit të jashtëm dhe të brendshëm, regjistrimi i pasurive dhe pagesat ndaj palëve të treta.

Një sfidë tjetër në këtë raport është adresuar për komunat e Republikës së Kosovës, e dobësitë e njëjta janë përsëritur nga viti në vit, duke rezultuar me progres shumë të ngadalshëm në zhvillimin e menaxhimit të financave publike dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Gjatë vitit 2010, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka bërë gjithsej 34 auditime të komunave dhe ka dhënë diku 227 rekomandime. Gjatë vitit 2012, vetëm 38 janë adresuar plotësisht, prej tyre rekomandime, që do të thotë 15%, 83 rekomandime pjesërisht, ndërsa 106, apo 47% të rekomandimeve nuk janë adresuar fare dhe kryesisht këto rekomandime që nuk janë adresuar fare nga komunat kanë të bëjnë me menaxhimin e pronave dhe pajisjeve, pastaj të hyrat dhe shpenzimet.

Një çështje tjetër, apo një sfidë tjetër, e cila është paraqitur në raportin e Auditorit të Përgjithshëm është edhe mungesa e hapësirave. Hapësirat, do të thotë në të shumtën e rasteve nga shumë institucione, nuk janë të mjaftueshme për rekrutimin e stafit dhe, sipas Zyrës së Auditorit, nga 25 institucione të audituara, 15 prej tyre janë të vendosura në objekte private, e të njëjtin fat e ka po ashtu edhe Zyra e Auditorit, e cila e ushtron veprimtarinë dhe punën e vet në objekt privat. Ndërsa, është thënë nga Qeveria se të gjitha institucionet do të hiqen prej objekteve private. Duke marrë për bazë se këto janë të kushtueshme, duhet të vendosen në objekte publike, por kjo nuk ka ndodhur. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Debat i që po e zhvillojmë sot në lidhje me raportin e Auditorin e Përgjithshëm është shumë i rëndësishëm, pasi kemi të bëjmë me mënyrën se si menaxhohet paraja publike dhe këtë na e paraqet një institucion shumë kredibil, të cilit do të duhej t'i besojmë dhe vërejtjet e tij do të duhej t'i merrnim parasysh.

Kemi të bëjmë me paratë e taksapaguesve dhe do të duhej të ishim të përgjegjshëm. E shoh, jo vetëm për keqardhje, por si papërgjegjshmëri të plotë faktin që në këtë debat gjatë kësaj seance nuk marrin pjesë anëtarët e Qeverisë, me përjashtim të dyve që po i shoh, edhe pse do të duhej të ishte një debat, ku ata do të duhej t'i dëgjonin me shumë vëmendje vërejtjet e Auditorit të Përgjithshëm. Mirëpo, kjo flet për papërgjegjshmërinë e tyre totale, si dhe për injorimin e punës së Kuvendit.

Natyrisht, ne e dëgjuam Auditorin e Përgjithshëm në lidhje me shumë institucione në Kosovë dhe vërejtje themelore mbetet fakti që këto institucione, edhe pse vit pas viti përsëriten vërejtjet për to, vërejtjet e njëjta, vërejtjet e Auditorit të Përgjithshëm nuk i marrin parasysh. Janë përjashtime shumë të rralla të institucioneve që i marrin parasysh disa vërejtje dhe edhe ato janë gati sipërfaqësore për mënyrën se si raportohet, por kur vjen puna të mënyra se si punohet, është shumë vështirë për të gjetur fjalë të mira.

Natyrisht, kur punohet keq është vështirë të raportohet mirë dhe veçanërisht një institucioni të ekspertizës është e vështirë t'i hidhet. E dëgjuam Auditorin e Përgjithshëm që foli për mënyrën se si i raporton Agjencia e Privatizimit. I bën raportet tepër të komplikuar, gati-gati të padeshifrueshme edhe për ekspertët, e lëre më raportet të cilat duhet t'i vijmë Kuvendit të Kosovës dhe do të duhej të kuptoheshin nga deputetët, e të gjykohej mbi mënyrën se si po punon kjo agjenci. Kjo nuk bëhet rastësisht, por për ta fshehur punën që bëhet nga ky institucion, e cila është punë e dallaveve, e kjo është vërtetuar qindra herë. Pse nuk merren parasysh rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për secilin institucion? Sepse, nuk ka vullnet politik. Fatkeqësisht edhe agjencitë e pavarura, të cilat do të duhej të ishin të pavarura, u tha fare qartë, e nuk janë të tilla, por nën ndikimin e Qeverisë.

Nuk ka vullnet politik dhe rastet janë të panumërta për t'i marrë parasysh rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm. Unë do ta përmendja vetëm faktin në lidhje me debatin, i cili sapo është zhvilluar këtu në Kuvendin e Kosovës në lidhje me shpenzimin e parash publike, ku u tha hapur se është vërtetuar nga shkrime, nga investigime, se Qeveria shpërblen me tenderë kompanitë që ia kanë financuar fushatën elektorale. Dhe çfarë ndodhi në rekomandimet e këtij debati: pozita votoi kundër, duke e vërtetuar edhe një herë se jo vetëm që s'ka vullnet politik për transparencën, por as për demokracinë dhe çdo fjalë që thuhet nga ta në lidhje me çështjen e demokratizimit të vendit dhe të institucioneve është vetëm retorikë boshe.

Do t'i lexoj këto rekomandime për të kuptuar se çfarë vullneti kanë dëshmuar këtu ata që votuan kundër. Të kërkohet nga Auditori i Përgjithshëm t'i auditojë tenderët në mënyrë të detajuar; të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit raport në lidhje me rastet ku Auditori ka konstatuar shkelje në tenderët e mëposhtëm; pra që përmendeshin në debat; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të iniciojë procedura ndëshkimore për subjektet që nuk raportojnë me rregull, dhe brenda gjashtë muajve Kuvendi ta krijojë bazën ligjore, e cila e rregullon kontrollin financiar të partive politike. Pra, auditimi të jetë i pavarur, i besueshëm dhe transparent. Ligji përkatës duhet ta përcaktojë edhe trupin apo institucionin që duhet të jetë bartës i këtij procesi. Çfarë ka këtu për të mos u marrë parasysh? Fakti që këto rekomandime hidhen poshtë, do të thotë që ata që votojnë kundër nuk kanë vullnet politik për ta ndërtuar një shtet të transparencës, një shtet ku sundon ligji, por vetëm një shtet klientelist. Në këtë mënyrë e shoh edhe përpjekjen e të gjithë atyre deputetëve, të cilët votojnë kundër, sepse kanë interesa personale dhe nuk kanë interes ta ndërtojnë shtetin.

Le ta thotë dikush të kundërtën, mirëpo faktet flasin me gjuhën e tyre dhe fjalët i merr era. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit! I nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar të pranishëm nga Zyra e Auditorit Gjeneral

Ju përshëndes,

Në Raportin vjetor të Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Buxhetit të Republikës së Kosovës janë përmbledhur të gjitha auditimet e kryera nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal.

Ky raport, ashtu si edhe ai i vitit të kaluar, janë për t'u përshëndetur, pasi opinionin e dhënë nga Auditori është i pakualifikuar, që për njohuri të qytetarëve do të thotë se pasqyrat vjetore financiare të Buxhetit të Republikës së Kosovës e prezantojnë në të gjitha aspektet materiale në pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për vitin 2011. Sipas raportit, institucionet e vendit, në përgjithësi, kanë treguar progres në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të financave publike. Ky është një tregues i mirë që taksat e qytetarëve përdoren në mënyrë të kujdesshme dhe ekonomike.

Në këtë raport paraqitet edhe auditimi i një numri të madh të institucioneve të pavarura dhe nëse e bëjmë krahasimin me dy vjetët e mëhershme, vërejmë se ka pasur përmirësim të dukshëm në cilësinë e informatave të pasqyrave financiare vjetore. Një shembull pozitiv është Komisioni i Pavarur për Media, siç është për t'u vlerësuar edhe Këshilli Gjyqësor dhe Autoriteti i Aviacionit Civil. Institucionet e pavarura përballen me një numër sfidash që kanë të bëjnë me pavarësinë e tyre funksionale, e financiare dhe operative, dhe nuk e kanë një sistem të unifikuar të financimit, kur shumica prej tyre financohen nga Buxheti i Kosovës, e disa prej tyre kanë mandat që t'i inkasojnë të hyrat nga taksat dhe licencat.

Krahasuar me vitin e kaluar, adresimi i rekomandimeve ishte në nivelin e kënaqshëm sa u përket këtyre institucioneve të pavarura. Po ashtu, Zyra e Auditorit Gjeneral ka audituar 37 komuna, prej të cilave 18 sosh i kanë audituar dy kompani private të auditimit, të kontraktuara nga kjo zyrë. Është e vërtetë se ka komuna, të cilat kanë hyrë në obligime, por sipas mendimit tim shumë shqetësues është fakti që ka komunë që ka lënë të pashpenzuara afro 17 milionë euro, kur kërkesat e qytetarëve për investime në këtë komunë janë shumë të mëdha. Marrë në përgjithësi, në përmirësimin e gjendjes në shpenzimin e parasë publike, pa dyshim që një rol shumë të rëndësishëm apo thënë më shkurt një meritë të madhe e ka Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, e cila i ka ndihmuar entitetet e audituara në eliminimin e gabimeve në pasqyrat financiare dhe në përmirësimin e informacionit të raportuar.

Raporti është i përgatitur në mënyrë shumë profesionale, është shumë i detajuar dhe paraqet një gjendje reale të menaxhimit të parasë publike, prandaj si të tillë unë do ta votoj. Më lejoni në fund ta falënderoj stafin e Zyrës së Auditorit Gjeneral për punën shumë profesionale që është duke e bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmeti e ka fjalën.

IMRI AHMETI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra, kolegë deputetë,

Nëse i referohemi raportit të Zyrës së Auditorit për auditimin vjetor të vitit 2011, konsideroj se ka mjaft shumë informata dhe rekomandime për veprimet që duhet të ndërmerren për përmirësim në menaxhimin financiar nga autoritetet publike.

Ajo që për mua është e debatuar, mbetet fakti se nga leximi i raporteve individuale, apo veç e veç të organizatave buxhetore të audituara, përveç paraqitjes së vlerësimit për pasqyrat financiare, nuk vërehen ekzaminime dhe auditime të thella dhe analitike në fusha të caktuara të menaxhimit financiar, sidomos në investimet kapitale, ku edhe shpenzohet pjesa më e madhe e parasë publike, apo edhe problemet e tjera sistimore që e përcjellin sot menaxhimin financiar në Kosovë.

Si rezultat i kësaj, në Raportin e Auditimit vjetor të Zyrës së Auditorit nuk janë adresuar disa nga problemet mjaft serioze të kësaj fushe dhe nuk janë analizuar në mënyrën më të plotë dobësitë e caktuara, si dhe ka disa konkluzione, të cilat nuk vlerësoj që janë të sakta dhe janë kontradiktore njëra me tjetrën. Disa nga këto çështje që Zyra e Auditorit i ka anashkaluar, apo nuk i ka trajtuar mjaftueshëm, mendoj se janë këto:

1. Mos-analizimi i mjaftueshëm i dobësive që ndikojnë në planifikimin e buxhetit dhe ndarjet joadekuate buxhetore. Kjo po rezulton zakonisht me suficit buxhetor, me ndryshime të shpeshta të prioritetëve buxhetore, po reflekton me mundësinë e shkurtimeve buxhetore, me përfshirje të projekteve të njëjta, që përsëriten nga viti në vit dhe të cilat nuk realizohen etj.;

2. Shkurtimeve buxhetore që i bën Qeveria, duke i tejkaluar limitet e përcaktuara ligjore dhe pasojat që krijohen nga mospërbushja e strategjive zhvillimore të autoriteteve

publike. Kjo zakonisht rezulton me planifikime buxhetore pa mbulesë, që pastaj Qeveria, për t'i mbuluar deficitet e ndryshme, bën shkurtime dhe kërkon nga organizatat buxhetore t'i deklarojnë kursimet e tyre;

3. Detyrimet e papaguara nga organizatat buxhetore. Sipas konstatimit të vetë Auditorit të Përgjithshëm në këtë raport, ka subjekte të tilla që kanë detyrime deri në 52% të shumës së përgjithshme të buxhetit final. Këtu, në fakt, vihet në pyetje se çfarë ka bërë ajo organizatë gjatë gjithë vitit. Fakti tjetër kontradiktor i Auditorit është kur shkaktar kryesor e paraqet mungesën e fondeve, kurse në anën tjetër buxheti mbetet i pashpenzuar për të njëjtën organizatë buxhetore. Në raport, Auditori jep opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare, por ndërkaq, në anën tjetër, konstaton se organizatat buxhetore nuk i kanë shpalosur të gjitha detyrimet e papaguara. Besoj se kjo nuk ka vend shumë për të komentuar, përveç se të thuhet se Auditori nuk është marrë mjaftueshëm me këto analiza dhe disa nga opinionet e pakualifikuara mund të merren me dyshim lidhur me saktësinë e pasqyrave financiare;

4. Dallimet substanciale ndërmjet auditimeve të kryera nga Zyra e Auditorit dhe auditimeve të kryera nga kompanitë e kontraktuara. Kjo çështje është duke u përsëritur nga viti në vit, pra auditimet që janë kryer nga Zyra e Auditorit thuhet se janë krejt në rregull, janë me opinione të pakualifikuara, ndërsa auditimet e kontraktuara me kompani private, të kontraktuara nga vetë Zyra e Auditorit tregojnë krejt diçka tjetër. Kjo tregon se këtu diçka nuk është në rregull. Nëse e bëjmë një krahasim me auditimet e mëparshme të kryera nga kontraktues vërejmë se ato komuna për vite kanë pasur opinion të kualifikuar, kurse të gjitha ato që pas një viti më vonë janë audituar nga Zyra e Auditorit menjëherë kanë marrë një opinion të pakualifikuar. Sigurisht është mjaft interesant ky fakt, sepse Auditori i Përgjithshëm nuk e jep asnjë shpjegim se si po ndodh dhe pse po ndodh kjo;

5. Çështja e pestë që unë dua ta theksoj është çështja e listës së pagesës së pagave, ku jepen vetëm të dhënat në shifra dhe konstatohet se pagesat që janë bërë jashtë listës së pagave nuk janë transparente. Por, nuk është dhënë asnjë vlerësim dhe asnjë analizë për rregullsinë e pagesave edhe nëpërmjet listës së pagave. Madje, kjo nuk është trajtuar fare as në raportin e auditimit të Ministrisë të Administratës Publike. Kjo bën të kuptohet se edhe më tutje Zyra e Auditorit ka fuqi të vogël të kapaciteteve, me gjithë mbështetjen që i është dhënë nga ky Kuvend dhe nga Qeveria për rritjen e kapaciteteve profesionale, apo mund të jetë edhe mungesa e gatishmërisë për t'u përballur me problemet serioze të kësaj fushe nga Zyra e Auditorit.

Pa pasur qëllim për ta mohuar punën relativisht të mirë të kësaj zyre, konsideroj se kjo nuk është e mjaftueshme dhe se pasqyrohet në këtë raport, ku shumë informata më shumë i ngjasojnë raportit financiar të Qeverisë së Raportit të Zyrës së Auditorit. Prandaj, Kuvendi duhet të kërkojë një angazhim më të madh nga Zyra e Auditorit për shqyrtimin më gjithëpërfshirës të raporteve të auditimit, duhet të identifikohen dobësitë në punën e Zyrës së Auditorit, me qëllim të angazhimit më të madh dhe punës më profesionale të tyre, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, të nxirren rekomandime konkrete, të cilat do të ishin detyruese të zbatohen nga Qeveria. Në të kundërtën, kjo rutinë, sa për të thënë se po e lexojmë këtë raport, dhe kalimin nëpër këto rekomandime të Auditorit, të përfshira nga

viti në vit, si Kuvend nuk mund ta përmbushin detyrën tonë kushtetuese dhe mbikëqyrjen e punës së Qeverisë në fushën e menaxhimit financiar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

I nderuari përfaqësues i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm,

Në fjalën time nuk do të lëshohem shumë në detajet rreth raportit, sepse i thanë në mënyrë të detajuar dhe shumë profesionale kolegët e mi nga Partia Demokratike e Kosovës, për çka unë pajtohem.

Por, megjithatë, e mora fjalën për arsye se dua ta demantoj parafolësin nga Lëvizja “Vetëvendosje”, i cili thotë se në këtë raport ka të gjetura, ku janë bërë punësime në baza politike, që nuk është e vërtetë dhe nuk qëndron. Është shumë e vërtetë që thuhet se ka pasur parregullsi dhe se ka pasur defekte të punësimit i njerëzve, por asnjëherë nuk thuhet se është evidentuar se ka pasur punësime mbi baza politike. Prandaj, arsyeja pse unë e mora fjalën është vetëm që ta demantoj këtë fakt, i cili nuk ekziston. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra të pranishëm,

Kolegë deputetë,

Raporti vjetor i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të vitit 2011, i prezantuar nga Auditori i Përgjithshëm, i pasqyron më së miri dobësitë e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, shpenzimin e parasë publike, si dhe gjendjen në të cilën gjendet Administrata Publike e Republikës së Kosovës.

Duke e analizuar këtë raport, me gjithë faktin se opinioni i auditimit është i pakualifikuar, në brendësi të këtij raporti dhe raporteve që janë shqyrtuar për shumë organizata buxhetore, vërehen shumë dobësi, nga të cilat unë do t’i theksoj 3-4 si më të veçanta.

E para, procesi i mbledhjes së të hyrave në Doganë është përcjellë me mangësi, si: aplikimi dhe llogaritja e tarifave jo në përputhje me kodin doganor, moskorrigjimi i dokumentit unik doganor në rastet kur bëhen gabime dhe mungesa e arsyeshmërisë për rivlerësime kur rritet vlera e importit. Kjo nënkupton që ne rrëshqasim në një degradim të rritjes së të hyrave nga Dogana.

E dyta, Administrata Tatimore ka vërejtur nivel të lartë të borxheve më të vjetra se 6 vjet. Gjendja e këtyre borxheve është 73 787 000 euro. Ajo përfshin periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2005. 30% e tyre vlerësohen se ndërliken me ndërmarrjet publike. Gjendja e këtyre borxheve kritike, të cilat e tejkalojnë limitin prej 6 vjetëve nga krijimi si obligim tatimor dhe ligjërish bëhen të pambledhura, është 6 061 000. Mangësitë e përshkruara e tregojnë mungesën e një analize efektive të rrezikut për ta përcaktuar totalin e taksave, në

të cilat duhet të mblidhen. Kjo ka ndikuar që niveli i mbledhjes së të hyrave, si dhe parandalimi dhe luftimi i evazionit fiskal është shumë i mangët.

Dhe, çështja më kryesore dhe që mbetet vrimë e zezë e institucioneve tona është se janë vërejtur mangësitë e mëdha në sistemin e prokurimit publik. Dobësitë e evidentuara në këtë raport janë që nga fillimi i procesit të prokurimit e deri te pagesat finale të projekteve. Mangësitë e theksuara janë të shumta, dhe ato kanë të bëjnë me: planet e prokurimit, të cilat janë dorëzuar me vonesë në kundërshtim me afatin ligjor të paraparë, mosrespektimi i kriterëve të caktuar nga komisionet e vlerësimit, nënshkrimi i kontratave në mungesë të numrit të ofertave të përgjegjshme, tejkalimi i afateve për zbatimin e kontratave, gjobat e shqiptuara sipas kontratës, monitorimi i pamjaftueshëm i zbatimit të kontratave dhe pagesat e bëra për pranim të mallrave, si dhe shumë dobësi të tjera, të cilat Auditori i Përgjithshëm i ka evidentuar në këtë raport.

Kolegë të nderuar deputetë,

Është e palogjikshme për mua si deputet, sigurisht edhe për ju, që në Kosovë 999 euro kushton një metër kub betoni. Sigurisht vetëm nëse ka grimca të arit në të.

Është e papranueshme që në Kosovë, nëpërmjet tenderëve publikë të blihen dritare nga 5 euro me dy kapakë. Është e papranueshme për ne që komunat tona bartin borxhe nga 3-4 milionë nga viti në vit. Dhe, e fundit, edhe pse Auditori e përmendi apo e fuqizoi rekomandimin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, unë mendoj se edhe gjatë vitit 2011, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka arritur t'i sigurojë procedurat transparente gjatë privatizimit, nuk ka siguruar monitorim dhe menaxhim të plotë të ndërmarrjeve nën administrimin e saj. Ka pasur dobësi në shpërndarjen e 20-përqindëshit të punëtorëve, si dhe shmangien nga kërkesat e politikave të saj. Pothuajse në të gjitha raportet e Auditorit, procesi i regrutimit duket që nuk i përfill procedurat, pranimi i kandidatëve, edhe pse nuk i kanë plotësuar kushtet e kërkuara me konkurs, lë të kuptojë që ne kemi punësime politike dhe në baza partiake.

Dhe, e fundit, qytetarët ballafaqohen me problemin kryesor që kanë nga lista esenciale e barnave. Ne kemi akoma rritje të sasisë së barnave me afat të skaduar, nuk kontrollohet apo nuk menaxhohet lista esenciale e barnave. Akoma kemi pranim të barnave pa banderola dhe të gjitha këto nënkuptojnë atë që e thashë në fillim, se gjendja e kontrollit të brendshëm në institucionet tona publike, si dhe në të gjitha shtetërore, si dhe në nivelin lokal, nuk është në mënyrën e kënaqshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë, zoti Hoti.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryesues!

E desha një replikë të shkurtër, meqë zoti Zemaj i përmendi faktet për keqmenaxhimin që po bëhet nga Qeveria. Faktet ekzistojnë, edhe pse janë të njohura për publikun, por fatkeqësisht Auditori nuk ka mundur t'i përfshijë të gjitha në raportin e tij. Ato dihen publikisht sa janë dhe si janë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Në mbledhje janë të pranishëm 69 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! Konstatohet se me 57 vota për, 1 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Auditimit për vitin 2011 nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Meqenëse nuk ka pasur kuorum për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Projektligji për Agjencinë e Regjistrimit Civil

Votojmë tani për atë. Në mbledhje janë 68 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 64 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Pika e shtatë e rendit të ditës është tërhequr, vazhdojmë me pikën e nëntë:

9. Ratifikimi i vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universitetit në Prizren dhe të Universitetit në Pejë

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka proceduar në Kuvend për ratifikim vendimin për themelimin e Universitetit Publik në Prizren, si dhe vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për themelimin e Universitetit Publik në Pejë. Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media i ka shqyrtuar vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universitetit të Prizrenit si institucion publik i arsimit të lartë, si dhe vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për themelimin e Universitetit Publik në Pejë dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Për këtë radhën e ka Qeveria, që të na japë sqarime shtesë, pastaj vijnë kryetari i Komisioni, por propozuesi është i pari.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues!

Të nderuar kolegë nga Qeveria,

Zëvendëskryeministër dhe ministër Mujota,

Të nderuar deputetë,

Në rastet e tilla kur ka nevojë të ratifikohet një vendim apo vendime të caktuara të Qeverisë, zakonisht flasin, ose flet përgjegjësi i Komisionit, por megjithatë unë po e ndiej të nevojshme t'ju them disa fjalë, ose informacione për këto dy institucione publike që përgatisin kuadro për institucionet tona të gjitha niveleve dhe po ju them diçka që duhet të jetë e sqaruar në rekomandim, se me 4 korrik 2012-ës, është marrë vendim në Qeveri

që është lëshuar, është kaluar çështja e emrit të Universitetit të Prizrenit, që është emërtuar me emrin “Ukshin Hoti”, andaj kur përplotësohet emri, që të mos kthehemi dy herë për këtë çështje, por po ju them që këto dy institucione kanë përmbushur të gjitha kriteret që vijnë në këtë stad sot ku jemi, për t’u themeluar, për t’u legjitimuar edhe ashtu nga Kuvendi themelimi i tyre, për t’u ratifikuar këto dy vendime të Qeverisë dhe të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Kështu që po ju them disa informacione, që janë mbase elementare dhe të domosdoshme për Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, që ka aktualisht 5452 studentë. Sivjet ka regjistruar 1800 sish, 2012-2013, ka 5 fakultete dhe 16 departamente dhe ka profesorë të këtyre kategorive: profesorë të rregullt ka 22, profesorë të asociuar ka 10, profesorë asistentë 17, ligjërues të rregullt ka 2 dhe 97 bashkëpunëtorë të jashtëm.

Ndërsa, Universiteti “Haxhi Zeka” i Pejës ka 6 000 studentë, afër 6 000 studentë, sepse nuk është përmbyllur kjo e masterit ende, por afër 6 000 studentë, afërsisht 300 duhet t’i ketë studentë në master, ka 5 fakultete dhe 14 departamente, ka 51 personel të brendshëm, profesorë të niveleve të ndryshme dhe 87 personel i angazhuar i jashtëm.

Unë besoj që nëse ka nevojë do të sqarohem edhe më shumë dhe do të bisedojmë, por unë ju lus që të votohet dhe të ratifikohen këto dy vendime, sepse na bëjnë nderë të gjithëve, për të avancuar këto dy institucione, të cilat kanë arritur pjekurinë e domosdoshme, por akoma lë për të dëshiruar çështja e cilësisë dhe besojmë edhe këtë do ta arrijmë që të arrijmë synimin ku e kemi si institucione të përbashkëta. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL, deputeti Idriz Vehapi, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 62, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2012, shqyrtoi Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me themelimin e Universitetit të Prizrenit dhe propozim-vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për themelimin e Universitetit të Pejës dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këto rekomandime.

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për themelimin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, si institucion publik i arsimit të lartë, dhe

2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë propozim-vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për themelimin e Universitetit Publik “Haxhi Zeka” në Pejë.

Arsyetim:

Bazuar në nenin 9, pika 1, të Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2012, shqyrtoi propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për themelimin e Universitetit të Prizrenit dhe propozim-vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për themelimin e Universitetit të Pejës.

Komisioni njëzëri përkrahu propozim-vendimet për themelimin e Universitetit të Prizrenit dhe Universitetit të Pejës dhe vlerësoi se vendimet e tilla kontribuojnë në përfshirjen më të madhe të studentëve në arsimin e lartë dhe u rekomandojmë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, që të bëjnë miratimin e këtyre dy propozim-vendimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, askush. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit zoti kryesues!

Më lejoni, ju lutem, të përshëndes zëvendëskryeministrin e pranishëm, zotin Kuçin, edhe dy ministrat, natyrisht, edhe zonjat dhe zotërinjtë deputetë.

Të them të drejtën, unë e ndiej veten shumë komod sot kur po merret ky vendim, sepse vlerësoj dhe kujtoj, madje do të thosha jam shumë i bindur se nuk është ky vendim që ka të bëjë në lidhje me një establishment, madje edhe brenda një dhjetëvjetori. Ky do të prodhojë efekte shumë pozitive të mbara, jo me decenie, por ndoshta me shekuj. Së këndejmi, natyrisht, edhe pse vogëlsia ime ka pasur njëfarëlloj përpjekje të dëshpëruar para dhjetë vjet e gjysmë që të hapet ky universitet, e nuk u realizua, nuk do të më mbetet hatri sikur e kam thënë edhe publikisht që t'ia njoh meritën zotit Thaçi. Po flas në emër tim, nuk po flas në emër të LDK-së tash, për çështjen se e hapi Universitetin, do të thotë e kapi atë ide që praktikisht unë e pata distribuuar dhjetë vjet e gjysmë më parë, jo nga kërkesa lokaliste, por thjesht nga kërkesa të përfshirjes së të rinjve në mundësinë për të pasur një shkollim për të qenë.

Edhe e vetmja gjë, do të thotë, përpos kënaqësisë time, e vetmja gjë ndoshta është se pak është vonuar, do të thotë ajo është vërejtja ime pak është vonuar. Thjesht, ankthi im në këtë vonesë kishte të bënte me një kujtim timin, pothuaj fëmijëror ose djaloshar, më mirë të them. E kemi pasur ne një kryetar, zotin Sali Morina, që nuk është këtu më, të Malishevës, në kohën e shokut Tito, natyrisht, edhe e kam zotin Halit Krasniqin, ndoshta edhe atij po i thonë: “kryetar bre, shoku Tito po lyp do të rinj me i çue në shkollë”. Natyrisht, shoku Tito e kish problemin t'i fusë në atë farë djepin e patriotizmit jugosllav, ai e ka pasur llogarinë e vet. Dhe, kryetari tha: “Jo, a po janë budalla ata, po ata kur të vijnë me shkollë ma zënë vendin pastaj”.

Do të thotë, në fakt, unë e kisha këtë ankth dhe të them të drejtën në çfarë kohe po jetojmë, kur njerëzit dhe personalitete të mëdha po lexojnë me rrokje, ndonjëherë po them se ndoshta edhe ende reminishencat e asaj psikologjie janë këtu.

Në këtë aspekt, Grupi ynë me kënaqësi e përkrah, por e përkrah, natyrisht edhe do ta votojë, por unë do ta lutja, edhe në emër të Grupit, por edhe në emër tim personal, ministrin e Arsimit, që të shkojmë me guxim, të mos kursejmë para për të bërë universitete për të qenë.

Do të thotë, t'i standardizojmë universitetet. Nuk mund një kut tjetër për Universitetin e Pejës, një për të Prizrenit, e një kut tjetër për të Prishtinës. Ky do të ishte ai diskriminim, që në fakt nuk do të duhej ne ta kishim atë qëndrim. Natyrisht, unë i njoh relativisht mirë vështirësitë, mirëpo nuk është dita sot të flas për to, të paktën unë që po flas në emër të Grupit dhe madje në këtë rast do ta falënderoja edhe Grupin që ma ka besuar një punë kaq të madhe, që unë të flas për këtë ngjarje. Për mua, është shumë e rëndësishme, edhe pse po të isha krejtësisht tamam qysh duhet ballkanas, do të më vinte pak inat që nuk e realizova unë, po e realizoi dikush tjetër, por kjo me të vërtetë ka shumë pak rëndësi. Kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, e ka fjalën zoti Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit! I nderuar kryesues dhe të nderuar deputetë!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universitetit të Prizrenit si institucion publik i arsimit të lartë dhe vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për themelimin e Universitetit Publik të Pejës dhe si e tillë, ajo do të përkrahë ratifikimin e këtyre institucioneve të arsimit të lartë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mirëpo, kjo lëvizje mban një qëndrim kritik ndaj mënyrës se si janë themeluar këto universitete, strukturës së tyre administrative dhe qeverisëse, kualiteteve që ato posedojnë si dhe kapaciteteve që këto institucione aktualisht ofrojnë për zhvillimin e jetës shkollore, akademike dhe kulturore. Duke u bazuar në programin tonë qeverisës që përfshin sferën e arsimit, ne konsiderojmë se përfshirja e numrit sa më të madh të rinjve në procesin e arsimit të lartë, mbetet një detyrë qenësore e institucioneve qeverisëse në Republikën e Kosovës, sidomos, kur dihet se sot Kosova, jo vetëm në Evropë, por edhe në rajon, vazhdon ta ketë numrin më të vogël të studentëve për kokë banori. Dhe, nuk ka dyshim se për zbatimin e kësaj strategjie si shoqëri kemi nevojë për institucione tjera arsimore që e mbulojnë këtë sferë të jetës sonë shoqërore. Madje, gjykuar numerikisht, ky relacion në mënyrë më ideale do të arrihej, nëse për çdo vit akademik, në nivelin bachelor dhe master, ky raport do të ishte 1 000 studentë në raport me 100 mijë banorë.

Kurse, që ky raport të mos mbetet thjesht vetëm një pasqyrim kuantitativ shoqëror, por të shndërrohet në një moment transformimi kualitativ akademik, si lëvizje inkurajojmë dhe mbështesim edhe hapjen e programeve dhe drejtimeve, kryesisht me orientim profesional. Por, shtrohet pyetja, këto dy universitete që sot po i ratifikojmë, a i plotësojnë këto kushte të domosdoshme për jetën tonë akademike dhe zhvillimin tonë shoqëror ekonomik?

Nuk ka dyshim se si të tilla ato ndodhen larg këtyre synimeve. Për më tepër, mënyra se si themelohen dhe përmbajtja e tyre, qëndron në antinomi të plotë me nevojat tona qenësore, sepse pikërisht kjo politikë me qasjen e saj që deri më tani ka degraduar dhe degjeneruar sferën e arsimit në Kosovë, në të gjitha nivelet, në përgjithësi, kurse atë të arsimit të lartë, në veçanti, po i themelon këto institucione, pikërisht mbi këto premisa strukturore, politike.

Dhe, kjo qasje është ajo që ndoshta më shumë se asgjë tjetër, është treguar si një nga strategjitë më varmihëse për idenë e Universitetit, duke e bastarduar dhe nëpërkëmbur atë, pikërisht në kuadër të atyre institucioneve, që në të vërtetë është dashur të jenë vend i mishërimit të kësaj ideje.

E si shembull eklatant i kësaj gjendjeje të pashpresë se ku është katandisur sot misioni i Universitetit, mund të merret vetë Universiteti i Prishtinës. Ky institucion akademik ka kohë që është shndërruar në poligon për realizimin e ambicieve të partisë në pushtet, me synim akomodimin e militantëve të saj brenda tij. Kjo logjikë partitokratike hegjemonike ka bërë që kriteret akademike të humbin kuptimin, duke ndikuar kështu në degradimin e plotë të cilësisë së studimeve.

Gjykuar mbi këto premisa dhe hapja e dy universiteteve të reja publike, në Prizren dhe në Pejë, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të fizibilitetit, si dhe premtimet propagandistike për hapje të universiteteve të reja publike në qytete tjera, pikërisht në kohë fushatash elektorale, janë format më të ulëta të keqpërdorimit të arsimit të lartë për qëllime politike.

Kjo, për faktin, se as Universiteti i Prishtinës nuk arrin të krijojë kushte për studime cilësore, ndërkohë që zgjerohen kapacitete, të cilat nuk mund të mbështeten as me fonde publike të mjaftueshme, as me kuadro akademike të kualifikuar. Institucionet publike të arsimit të lartë aplikojnë pagesa për semestër të cilat janë krejtësisht të paarsyeshme, ndërkohë që mungon angazhimi i tyre në projekte kërkimore, që mund t'i sjellin të ardhura shtesë institucionit. Sidoqoftë, kjo ide puro-politike e me deficite epistemike e ka shoqëruar Universitetin e Prizrenit që nga zanafilla e tij, madje, vendimi për themelimin e këtij universiteti ish marrë edhe një herë tjetër, nga një ish koalicion qeveritar ndërmjet LDK-së e AAK-së, atëbotë. Ju mbetet autoriteteve kompetente që ta shqyrtojnë validitetin e këtij vendimi, se si është e mundur që dy herë të merret i njëjti vendim për themelimin e të njëjtën institucion. Kështu, ish ministri i Arsimit të asaj qeverie, Agim Veliu, gjatë fushatës së LDK-së në Prizren në një gjendje dalldie elektorale e mbindjesie kolektive, situatë kjo tipike spektakulare, pat marr vendim për themelimin e këtij institucioni. Të njëjtën logjikë aspak akademike e pat vazhduar Partia Demokratike e Kosovës, kur ditën e themelimit të këtij universiteti ish ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj, në qeverinë e kaluar, pa asnjë argument diskursiv për këtë akt, por me ditrambe politike e elozhe partiake, shumë përlulësisht për shefin e tij, e pat justifikuar vendimin për hapjen e këtij institucioni.

Fatkeqësisht, kjo qasje e molisje do t'i qëndrojë si mallkim këtij institucioni gjatë gjithë viteve të funksionimit të tij. Gradualisht, ai do të shndërrohet një vend për t'i stabilizuar konjunkturën e partisë në pushtet, kurse rekrutimi i stafit akademik do të bëhet mbi bazat e

përkatësisë politike e jo të meritokracisë teorike. Substancialisht janë këto veprime të cilat bëjnë që ne sot të legalizojmë një godinë universitare, por jo universitet në kuptimin fundamental të fjalës.

Kështu, funksionimi i këtyre institucioneve mbi këtë bazë, edhe përkundër faktit se ato e mbajnë në ballinë të tyre këtë emër, jo vetëm që nuk është kundër argument i ekzistimit të tyre, por për më tepër është kusht i bjerres së Universitetit në vet idenë e tij. Tradicionalisht është e ditur se Universiteti është përkufizuar si një vend i prodhimit të dijes, me vokacion universal, prandaj edhe përmbajtja e tij është e lidhur me universalen dhe të përgjithshmen, kurse braktisja e kësaj trashëgimie e partikularizon atë dhe e distancon nga misioni i tij. Prandaj, ky veprim shënon edhe “tradhtinë” më të rëndë intelektuale dhe mëkatit më të madh moral, që mund t’i bëhet atij.

Në këtë kuptim, ky tjetërsim është duke u ndodhur universiteteve tona, si atij të Prishtinës, ashtu edhe të këtyre që po i themelojmë sot. Dhe, kështu si të tilla nga vendbanim për idetë e zhvillimit të përgjithshëm, ato janë partizuar dhe mpleksur me struktura partiake, për mbajtjen e pushtetit dhe kështu, për herë të parë, paradoksalisht, kemi instalimin e një modeli bizar, ku pushteti prodhon profesorë. Ironikisht, kjo shpërputhje vërehet veçanërisht në Universitetin e Prizrenit. Ky institucion sot mban emrin e intelektualit dhe filozofit të spikatur të çështjes shqiptare, Ukshin Hoti, mirëpo, emërimi i këtij universiteti me këtë emër nuk duhet shfrytëzuar si paravan për të mbuluar mungesën përmbajtjesore të tij. Ndërkaq, sikur të ish e mundur të ringjallej Ukshin Hoti, do të tmerrohej nga mënyra se si funksionon ky universitet, kriteret që përdoren në të dhe në fund të fundit se cilat janë strukturat reale vendimmarrëse brenda tij, sepse një universitet nuk bëhet vetëm duke e emëruar me një emër të madh, por duke i qëndruar konsekuent idesë së tij.

Vetëm në këtë mënyrë mund ta bëjmë një institucion universitet përmbajtësor akademik, e jo vetëm ta themelojmë atë formalisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra, zëvendëskryeministër,

Themelimi i universiteteve në komunën e Prizrenit dhe të Pejës, me të vërtetë është për t’u përshëndetur, duke pasur parasysh se shkollimi i të rinjve dhe të rejave në qytetet më të afërta, duke i kujtuar se buxheti i familjeve kosovare është shumë i varfër, është me të vërtetë shumë e rëndësishme në këtë kohë, por, a mjafton kjo, unë them, jo.

Edhe pse janë bërë dy vjet që nga themelimi i Universitetit të Prizrenit dhe tash së fundi edhe pas themelimit të Universitetit të Pejës, mund të thuhet lirisht se gjendja nuk është aspak e kënaqshme. Në fakt, pritet në radhë të parë, të qytetarëve por edhe të aktorëve tjerë, përfshirë këtu prindërit dhe studentët, nuk janë plotësuar as për së afërmi. E gjithë kjo për faktin se nuk janë bërë përgatitjet e duhura për themelimin e tyre.

Pra, paraprakisht është dashur të bëhen shumë e shumë në kualitet, në aspektin e arsimit me planprograme, duke rritur cilësinë akademike të profesorëve. Mendoj se procesi i parapërgatjeve për themelimin e tyre, nuk është bërë konform synimeve të qarta që duhet t'i ketë një universitet. Prandaj, në këtë kuptim, nuk mund të ketë rritje të cilësisë, rritje që natyrisht e kemi dëshiruar të gjithë ne.

Është punuar në infrastrukturë, por jo në ngritje të cilësisë akademike. Dhe, me këtë rast unë pyes: Cilat janë mekanizmat, me anë të cilëve synoni të ngritni nivelin e cilësisë arsimore, atje, cilat janë planprogramet dhe stafi akademik, aktualisht që posedoni?

Një gjë është tepër e qartë, pa vizion, pa qasje dhe pa një politikë të duhur zhvillimore, nuk ka as strategji që çon në ngritjen e cilësisë në këto vatra të ngritjes arsimore dhe intelektuale. Po të ekzistonin programe të mirëfillta, do të bëhej joshja e studentëve për studime në këto universitete e jo edhe bartja, përkatësisht detyrimi i tyre të vijjnë edhe nga Peja e Prizreni në Prishtinë.

Pastaj, mostransparenca në vazhdimësi e ka përcjell punën në këto institucione të larta mësimore, sidomos në Universitetin e Prizrenit. Pastaj, shkeljet që janë gjetur gjatë auditimit në këtë universitet. Madje, për defektet që e kanë karakterizuar vazhdimisht këtë universitet, në vazhdimësi ka qenë e informuar edhe vetë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Literatura online është e domosdoshme në ditët e sotme, ndërsa, bazuar në informatat që kam, gjendja në Universitetin e Prizrenit nuk është aspak e mirë, çka do të thotë, se në vend që të shënoheshin rritje, kemi ulje të cilësisë arsimore. Planprogramet mësimore ndryshohen sipas tekeve dhe qejfit. Një individ i vetëm mund të ndryshojë programin për të gjithë dhe, në fakt, për fat të keq, ato ndryshme pastaj edhe miratohen shumë lehtë.

Ne kemi nevojë për një politikë, që është në interes së rritjes së cilësisë, ndërsa nuk kemi nevojë për lukse, të cilat nuk administrohen. Pra, mendoj që ndoshta nuk është e tepërt të themi, se Universiteti i Prizrenit nuk është në drejtimin e duhur. Në anën tjetër, Universitetit të Pejës, i mungon edhe infrastruktura minimale dhe një staf akademik cilësor.

Dhe, në fund, ndërkaq në mënyrë më të pakuptimtë është anashkaluar, mendoj, komuna e Gjakovës, ndonëse Kuvendi komunal me kohë ka ndarë një parcelë prej 13 hektarësh tokë dhe vazhdimisht kërkesat kanë ardhur nga intelektualët dhe nga komuna, që kjo komunë të ketë një universitet, sepse disponon me një kuadër shumë profesional, që nuk e kanë komnatat e tjera, prandaj kjo e drejtë legjitime nuk duhet t'ju mohohet gjakovarëve. Dhe, unë kërkoj që të jetë prioritet shumë i shpejtë i Qeverisë që komuna e Gjakovës ta meritojë një universitet.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Koalicioni Kosova e Re, fjalën e ka zoti Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!
I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra, kolegë deputetë,

Koalicioni për Kosovë të re ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë për themelimin e këtyre dy universiteteve dhe ne, duke pasur parasysh kërkesat e të rinjve për përfshirje sa më të madhe në shkollimin e lartë, me qëllim të përparimit të tyre në fushën e njohurive akademike, për zhvillim arsimor, shkencor, kulturor, shoqëror dhe ekonomik, Koalicioni për Kosovë të Re, pra përkrah themelimin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren dhe Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “6+”, e ka fjalën zoti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë për themelimin e Universitetit “Ukshin Hoti” dhe atë të Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” dhe e përkrah këtë propozim-vendim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministër, ministra,

Deputetë,

Unë e përkrah fuqishëm hapjen e universiteteve, të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës është angazhuar, që në qytetet ku ka analizuar nevojën për t’u hapur universitetet, mirëpo mendoj që është obligim dhe i Ministrisë së Arsimit, që të ngritë jashtëzakonisht lart kapacitetet monitoruese për mësimdhënie dhe mësim nxënie dhe një fakt tjetër, i cili duhet të planifikohet e që është edhe vërejtje, ndoshta edhe publike, po është edhe një angazhim, i cili është shpresëdhënës nga Universiteti i Prishtinës, që të fillohet të analizohet nevoja e bazuar mbi tregun në edukim. Do të thotë, ne duhet të planifikojmë për të çfarë degësh kemi nevojë. Ne kemi nevojë edhe në Gjakovë të hapim universitet dhe është premtuar, por duhet të planifikohet në cilën pjesë të drejtimeve, të cilat i plotësojnë për atë pjesë, njëherë fillimisht të qytetit dhe mandej të mundësisë së gravitimit nga qytetet tjera në qytetin e Gjakovës, po ashtu edhe në qytetin e Gjilanit.

Dhe, Ministria e Arsimit mendoj që nuk e ka arritur ende atë shkallë të monitorimit të mjaftueshëm të kualitetit të mësimdhënies dhe mësim nxënies. Edukimi është një shtyllë jashtëzakonisht e rëndësishme për nevojat e popullatës dhe zhvillimit të popullatës së Kosovës, duke ditur edhe të kaluarën historike të re dhe të vonshme të Republikës së Kosovës dhe popullit të Kosovës, prandaj ne për ta zënë këtë hap, vetë forma se si po licencohen universitetet private, neve na tregon që jemi prapa me universitetet publike.

Prandaj, Ministria e Arsimit duhet të jetë më e angazhuar, të gjejë edhe fonde shtesë, në universitetet tjera, dhe të jetë një monitorues edhe i kualitetit dhe i kuantitetit të mësimdhënies në tërë segmentet universitar, po ashtu edhe në segmentet para universitare ku përgatiten studentët për të qenë në pjesën akademike dhe sistematizimin e tyre, jo vetëm sipas dëshirave familjare, por sipas vlerësimeve profesionale që nevojiten në drejtimet që i kërkon nevoja e tregut të brendshëm dhe nevoja e tregut të jashtëm.

Kjo është një luftë botërore për të përgatitur kuadrot e vet, qoftë për nevojat e veta apo për projektet e përbashkëta me shtetet tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti nënkryetar, kryesues i seancës,
Zëvendëskryeministër,
Ministra,

Të nderuar deputetë,

Fjalja e parë që do të thuhej, ose e fundit, në këtë diskutim timin është ajo që u tha edhe para meje, Kuvendi duhet t'i ratifikojë këto dy vendime. Por, kjo nuk e përjashton nevojën, për më tepër e bën edhe shumë më të madhe që të bisedohet për këtë problem në Kuvend, që të bisedohet para ministrit, para deputetëve, besa edhe para opinionit.

Unë e kam një mori të dhënash rreth këtyre dy universiteteve në formim, po i quaj ende, sepse legalisht ende nuk janë të formuara, të cilat diku-diku pajtohen me shënimet që i tha ministri Buja, e diku jo. Ndoshta ai ka planifikime rreth regjistrimit për shkak se në dokumentet zyrtare të të dyja këtyre universiteteve ende ekziston numri i saktë i regjistrimit për vitin e kaluar akademik, po jo për këtë. Ju e dhatë një shifër, mund të jetë me numra të rinj që në dokumentet zyrtare nuk ekzistojnë. Po i marr si informata të mirëqena që kanë arritur te ju.

Për ta ndërtuar një universitet duhet një punë shumë e madhe, sepse paraardhja duhet të jetë e sistemuar, pastaj krijohet institucioni, sepse vetë emri është tepër i madh, "universitas - universitet" do të thotë dije e përgjithshme. Nuk është institut, ku dija është e fokusuar, po universitet. Dhe, menjëherë po ju informoj edhe ju, edhe të tjerët, që universitet privat deri sot në Kosovë nuk ka. Ata e quajnë veten, ky është vullnet i tyre absolutisht me organizimin dhe kualitetet që i kanë brenda, dhe nuk është akredituar asnjë, pos si kolegje. E, kolegji është më i ngushtë, sikur instituti.

Pra, tash për tash, në Kosovë ekziston veç një universitet, ai i Prishtinës. Këto të dyja, i Prizrenit, që po propozohet të quhet "Ukshin Hoti", dhe insistoj të shkruhet në letra, se në rekomandimet me letra këtu nuk ekziston ai emër, dhe ta bëjmë institucion edhe me letra. Të mos na ndodhë të rikthehet sikur ky i Prishtinës, që duhet për t'ia shtuar emrin e Hasan Prishtinës. Pra, kemi të bëjmë me universitetin që do të quhet, nëse bëhen letrat mirë, me rregull, "Ukshin Hoti", dhe këtë të Pejës, që quhet "Haxhi Zeka".

Këto dy universitete, unë po i quaj nisje, zoti ministër, ju na i keni sjellë me dy letra, me dy vendime, i pari i Prizrenit, i para tre vjetëve, dhe i dyti i Pejës, i para një viti.

Për mua është pak sinjifikative dhe, në fund, pasi ta kryej, kërkoj prej jush, që të ma shpjegoni, pse i pari është bërë me vendim të Qeverisë, e i dyti me vendim të Ministrisë?

Dhe, pyetja e dytë, prapë ju më përgjigjeni në fund, pse duhen tre vjet që të vijë ky vendim dhe të kalojë në Kuvend? Dhe, unë po ju them, sa kanë ndodhur gjëra të këqija për këto tre vjet. Po të kishte ardhur me kohë, do të kalonte në Kuvend dhe do të

strukturohej më mirë. Kështu, kanë kaluar tre vjet, prej kur Agjencia e Akreditimit gjithmonë ua ka dhënë një vit akreditim me kusht për të mos i lënë rrugëve studentët që ata i kanë regjistruar. Dhe, tash, aktualisht të dyja këto universitete kanë akreditim veç për një vit shkollor dhe programet e tyre, njëri i ka pesë programe, e tjetri gjashtë, i pari i ka të gjithë bachelor, i dyti i ka katër bachelor dhe dy master. Të gjitha programet janë me kusht për një vit. Pse?

Sepse, legalisht, këto universitete nuk ekzistojnë. Pa kaluar nëpër Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe pa kaluar statusi i tyre i kodifikuar në statut nëpër Kuvend këto nuk janë legale. Po, janë në provë, por nuk janë të legalizuara.

Prandaj, unë e përsëris prapë fjalën e vendimit: unë e ngre dorën sot që të bëhen legale, në mënyrë që të mund të konstituohen, përndryshe as s'ka kualitet, as s'ka planifikim, se po bëhet me voluntarizëm. Voluntarizëm i bie secili bën sa ka mundësi, sa nuk ka - rri.

E dyta, problemi është i personelit akademik. Këto tre vjetët me Prizrenin janë pak të çuditshme. Kur është marrë vendimi të formohet Universiteti i Prizrenit, ministri i resorit, i dihet emri - Enver Hoxhaj, ai e ka pas sjellë një rektor të patentuar të huaj, për të cilin thoshte se ky do ta bëjë një universitet evropian. E ka thënë në këtë foltore, por edhe nëpër gazeta. Pas një viti, kur çdo gjë dështoi, tha zotni eks-ministri, "jo ai kishte qenë njëfarë tregtari". E pra, kush e solli?

Kështu që, më vonë është shpallur konkurs dhe sa di unë tash e kanë një njeri që e kanë zgjedhur vetë, i cili ka përvojë vendore dhe përpiqet ta ndreqë. Çfarë po dua të them? Dua të them se kjo nuk duhet të përsëritet hiç. Duhet të ndërtohen strukturat udhëheqëse akademike, sepse këtu nuk bën me teknikitet. Në universitete ai që e udhëheq duhet të jetë akademik, jo tregtar, as pazarxhi i mirë, por njeri i zanatit. Dhe personeli akademik, unë e kam analizën këtu, zoti ministër, në situatën aktuale, ata që quhen ligjërues, që nuk është punë titulli, por punë funksioni, te Prizreni ju i keni 52 të rregullt dhe 97 të angazhuar, që d.m.th. 1 me 2. Gabim! Gabim! Nëse duhen kaq profesorë duhet të hapen konkurse dhe të zgjidhen, se në këtë pjesën "të angazhuar", te asnjëri nuk dihet çfarë titulli akademik ka. E unë po ju them, ka edhe bachellor, e me titull bachellor në ligjet tona në fuqi nuk guxon as në shkollë fillore të japë mësim.

Te Peja, ky rezultat është 52:60. Prapë "pjesa e angazhuar" është e vogël. Tjetër? Ju, në vendimin tuaj thoni që do të ndërtohet universitet, e kam fjalën për të Pejës, ku do të jepen diploma prej bachellor ose fillimore themelore deri në doktoraturë. Jo, nuk mund të japë doktoraturë. Shanse nuk ka! Më vonë mund, sepse krejt ai universitet në listën e vet të profesorëve, që nuk dihet me çfarë statusi, a kanë status të rregullt aty, apo status të dytë ndihmës, e keni vetëm një profesor të rregullt. Nuk ka shanse! Se për të bërë shkollë doktorale, për një degë nevojiten 3 profesorë të rregullt. Nuk mund!

Pra, po të flisja me gjuhën iluministe si të Eqrem Kryeziut, që iu mbushën sytë lot prej gëzimit që po bëhet universiteti, unë e kuptoj, është arsimitar i moçëm, do të flitja ashtu. Por, realisht duhet të ndërtohet, sepse unë i them Eqrem Kryeziut që i teren sytë menjëherë prej lotëve, nëse ai e flet të vërtetën, që është njëri studiuesve më të mirëve të

romantizmit shqiptar, e në atë universitet nuk e pranojnë, ose e pranojnë dhe i thonë “ti je ligjërues”, kurse me titujt që i ka duhet të jetë së paku profesor i asociuar. Kjo është - Eqrem Kryeziu, kështu flitet nëse ti po përmallohesh dhe unë pajtohem, është shumë mirë që hapet, por nëse nuk krijohen kritere, atëherë jep mësim një njeri me bachelor, por jo një doktor i shkencave që i shkruan dy monografi për autorë të mëdhenj.

Dhe, ajo që unë po kërkoj sot është kjo, që të ndërtojmë kualitet. Po universitete publike. Po. Por - kualitet, sepse nuk mund të jenë kualitet as Prizreni, as Peja, as kolegjet universitare nëse i mbushin vendet profesorët e Universitetit të Prishtinës. E kjo ndodh 90% me atë kohën kur lodhen shumë, unë nuk po e quaj kohë të lirë, por ai që i mban 6 orë në universitet le ta harrojë që bën mësim produktiv dhe kërkim në të shtatën e tetën, se është e pamundur dhe ne i kemi situata të tilla. Ata që mbajnë tituj të mëdhenj të gjithë janë të Universitetit të Prishtinës dhe e kanë këtë kohën, unë nuk po e quaj të lirë, por të lodhjes së madhe, që shkojnë dhe japin mësim atje.

Duhet të krijohen kuadrot e vendit, në mënyrë që të krijohet kualiteti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne sot i kemi përpara vendimet për ratifikimin e themelimit të universiteteve të Prizrenit dhe të Pejës, dhe normalisht se përkrahja shkon në të gjitha grupet politike për arsye se kemi nevojë për ngritjen dhe nxjerrjen e kuadrove nga universitetet, të cilat duhet të jenë në nivelin më të lartë të zhvillimit të vet, por konsideroj se me një mentalitet provincialist, siç është vepruar deri tani, nuk ka mundësi që të dalin edhe kuadro, të cilat vërtet do t'i shërbenin vendit ashtu si duhet, ose do të nxirrnin kuadro, të cilat do të mund të jenë cilësi për Kosovën.

Këtë e them për arsye se po të ishin nisur nga parimi i përgjithshëm që në Kosovë të ketë universitet të vërtetë, që i nevojitet shoqërisë sonë, ai do të duhej të themelohej në Gjilan, së pari, për arsye se është pjesë e Kosovës, e cila është e ngarkuar jashtëzakonisht shumë, me vetë faktin e pranisë së të rinjve nga Presheva, Medvegja e Bujanoci, të cilët janë të detyruar të vijnë në Kosovë e të studiojnë, e dihet çfarë kostoje është për ta ardhja në Prishtinë. Po ashtu, ngarkesa që edhe më e madhe është ajo e studentëve ose të rinjve që vijnë nga Kumanova, pjesa e Maqedonisë, e të cilët në të gjitha ato treva i nënshtrohen një asimilimi, ose një degradimi, edhe njerëzor. Kjo mënyrë e veprimit të Qeverisë së Kosovës për ngritje të institucioneve universitare është treguesi më i mirë se me veprimet e tilla edhe në këto universitete të krijuara mbetet për të dëshiruar, që mund të dalin kuadro vërtet që i nevojiten vendit, sepse në vend që të shkojnë në këto vende akademike, njerëz të kualifikuar, ne kemi kuadro të cilat shkojnë për t'i plotësuar apetitet politike të partive, të cilat i drejtojnë në këto universitete.

Prandaj, është mirë që të heshtet më në fund në momente fushatash kur Gjilanit i është premtuar për çdo vit universiteti dhe përsëri po mbetet në fund, sepse dikush do që mentalitetin e vet të kufizuar ta ngushtojë edhe në provincialitet të universitetit, prandaj konsideroj që kjo politikë duhet të ndërpritet dhe të vazhdohet me një politikë që e

avancon Kosovën, e avancon shtetin, i avancon kuadrot dhe, në përgjithësi, interesohet për shtetasit e vet, por po ashtu edhe bashkatdhetarët tanë që janë në viset tjera shqiptare, për të cilët kjo Qeveri nuk ka treguar interesim as me investime të tjera, të cilat është dashur të bëhen në atë drejtim, e kjo po e dëmton interesin tonë të përbashkët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi!

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Unë për veten time do ta shpreh një ngazëllim, sepse me dy qytetet, Pejën dhe Prizrenin, jam i lidhur emocionalisht dhe natyrisht se vetë kjo temë nuk më lë indiferent, përkundrazi, madje edhe nuk mund të mos e shpreh ngazëllimin tim. Me Pejën më lidh një e kaluar e rëndë dhe e hidhur, por që tani me këtë aureolë që atij i krijohet dhe i mundëson Qeveria jonë, natyrisht se përveç arsimimit, përveç arsimimit, natyrisht se do ta zbusë edhe gjendjen dhe vështirësitë e qytetarëve, të studentëve të rinj, të cilët do ta kenë mundësinë që të arsimohen pranë shtëpive të tyre.

Gjithashtu, me Prizrenin nuk është i lidhur veç zoti Eqrem Kryeziu, për të cilin kam shumë respekt, por është një numër i madh deputetësh këtu nga zona e Prizrenit, që jo pse janë të lidhur si lokalitet, por për shkak të aureolës së qytetit të Prizrenit dhe madhështisë me të cilën lidhet historia jonë. Kështu që unë, për veten time, do ta kursej kohën dhe me kaq do ta jap mbështetjen time me votën që kërkohet.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotni nënkryetar!

Realisht u tha shumëçka, por e kam një arsye, edhe pse ndoshta përsëris diçka. Është e padiskutueshme ajo që u tha më herët, që ne si LDK e përkrahim hapjen e këtyre dy universiteteve, por pse jo edhe të të tjerëve, nëse është e nevojshme, e sigurisht do të jetë e nevojshme, me plotësimin paraprak të kushteve, që është një rregull. Për ne, asnjë dilemë për këtë nuk ekziston.

Megjithatë, konsiderojmë se mënyra si janë hapur këto dy universitete nuk ka qenë, ose më mirë të them ka qenë e mbrapsht, sepse e drejta e Qeverisë për marrjen e vendimit për themelimin të Universitetit është e pakontestueshme, por hapja e Universitetit, pa u legjitimuar nga ky institucion, nga organi më i lartë i vendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, nuk ka ekzistuar. Dhe, asnjë arsye për mendimin tonë nuk ka pasur që kjo të mos ndodhte më herët, të vijë ky propozim më herët dhe njerëzit të mos jenë realisht në një mënyrë pa identitet në kuptimin e asaj se s'e kanë bazën ligjore, legjitimitetin që e tha profesor Hamiti, sepse i vetmi organ kompetent për themelimin dhe hapje të Universitetit është Kuvendi i Republikës së Kosovës. Dhe, deshëm apo s'deshëm ta pranojmë, është e vërtetë se kjo i ka përngjarë marketingut politik.

U përmend edhe më herët një propozim-vendim që ka qenë nga zoti Veliu, është e vërtetë se ka qenë nga zoti Veliu, si ministër. Ka qenë vendim, por asnjëherë s'është hapur universiteti për shkak se s'ka pasur procedurë, s'ka kaluar në Kuvend, ndërkaq çka

ndodhi më vonë, janë hapur universitetet përsëri, pa u respektuar organi më i lartë dhe vendimi shumë i drejtë i zotit Veliu në atë kohë, por është dashur të pritët këtu të kalohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo nuk ka ndodhur dhe realisht i bie në logjikën e asaj që hapet Universiteti është sikur të dënohet njeriu, gjegjësisht të shkojë në vuajtje të dënimit, pa ia mbajtur gjykimin fare, e larg të jetë kësaj, edhe ajo që të pushkatohet njeriu, e pastaj të shpallet fajtor ose t'i mbahet gjykimi.

Këtë po e them si shqetësim që në të ardhmen kjo të mos përsëritet. Dhe, ne nuk duhet të bisedojmë në logjikën e asaj, sepse po dëgjojmë nganjëherë këtu, këto universitete nuk janë universitete lagjesh, por janë universitete në qytete të mëdha, të rëndësishme. Kosova nuk është e madhe, edhe prej Prishtine nuk është keq të shkohet e të studiohet, pse jo, edhe në Prizren nesër, po edhe në Gjakovë, por nuk duhet të flasim me logjikën tash në secilën komunë, sepse do të fillojë kërkesa që në çdo komunë të kemi nga një universitet të tillë. Por, të mos ndodhë në të ardhmen që universitetet të hapen ose të merren vendime dhe të punojnë para se të kalojë në organin kompetent dhe ky është Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Kjo nuk ka ndodhur me universitetet për të cilat po flasim. Faleminderit!

KRYESUESI: E ka fjalën zonja Rexhepi.

EMILIJA REXHEPI: Zahvaljujem se, predsedavajući!

Uvaženi zamenice premijera,

Gospodo ministri,

Izuzetno mi je velika čast da kao građanin Prizrena pozdravim i podržim formiranje javnog univerziteta u Prizrenu, jer naš grad to zaslužuje kako po broju stanovnika, koga Prizrenski region poseduje tako i po nacionalnom sastavu, ali pre svega zbog ekonomskog razvoja našeg grada, zato što je Prizren edukativni centar u kome su se vekovima unazad školovali studenti iz Novog Pazara, Crne Gore, Makedonije i Albanije.

Koristim priliku da uputim realnu sliku ministru za obrazovanje o položaju bošnjačke zajednice u gradu Prizrenu, a ne onu koju godinama to ministarstvo ima od strane zamenika ministra...

Gospodine ministre, molim vas da obratite više pažnje oko otvaranja drugih smerova u nastavi na bosanskom jeziku, poput pravnog, ekonomskog, da zaustavite reprodukciju učiteljskog kadra koga imamo od strane profesora Sadika Idrizija već deset godine, a njemu to služi kao jako dobra profitabilno zanimanje, iako mu je u nekoliko navrata pokrenuta krivična prijava.

Gospodine ministre, bošnjački obrazovni sistem je u fazi vrlo ozbiljne degradacije jer je Edukativni fakultet postao jako dobro profitabilno zanimanje, a nama je jako važno, gospodine ministre da se naša deca trebaju školovati na bosanskom jeziku, uz maksimum svoje obrazovanje i jezičke afirmacije da trebaju tražiti u tom okviru radi opstanka na ovim prostorima i ostanka našeg stanovništva, pa još jednom koristim priliku da obratite više pažnje oko zloupotrebe službenih položaja pojedinih profesora na Edukativnom

fakultetu veš deset godina i eliminisanjem određenih doktora profesora Bošnjaka sa ovih prostora radi svojih ličnih interesa. Zahvaljujem se.

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Pra, edhe unë, edhe si anëtar, në cilësinë e anëtarit të Komisionit përkatës kur kemi shqyrtuar këto propozim-vendime, po edhe tani si anëtar i Grupit Parlamentar të LDK-së, pajtohem që ne ta mbështesim këtë vendim, por të vetëdijshëm se çka edhe sikur të kishim thënë jo, domethënë cilat do të ishin pasojat.

Por, në përgjithësi, pajtohem edhe me idenë, sepse këto qytete në këtë distancë, kanë pasur nevojë që të hapen këto universitete dhe ta japin kontributin e tyre, atje.

Çështje e dytë është që tani kemi dy universitete dhe dy vendime të ndryshme. Ndoshta ka qenë mirë që sot të sqarohet nga ministri që të identifikohen, pra të barazohen, sepse del se një universitet do të ketë të drejta nga diploma deri te grada shkencore, doktor, ndërsa tek universitetet nuk përshkruhet. Dhe, shtrohet dyshimi se a planifikohet, pra tek Universiteti i Pejës, që të ngritën kapacitetet dhe të akreditohet deri në këtë masë, ndërsa ky i Prizrenit jo, por besoj se ministri do ta sqarojë.

Ndërsa, çështja e tretë dhe kryesore, ne e kemi diskutuar edhe në kuadër të Komisionit dhe nuk kemi marrë përgjigje. Nëse sot nuk e ka ministri, unë jam shumë i interesuar ta dëgjojmë përgjigjen se cilat janë planifikimet, sepse të themi Prizreni e Peja, në rregull si universitete dhe ne do të votojmë dhe u dëshirojmë punë të mbarë.

Diskutohet se gjatë fushatës iu ka premtuar që nga Mitrovica, Ferizaj, Gjilani, Gjakova e tjera, dhe asnjëri nuk kishim dëshiruar, ani pse janë tempull të dijes, sikurse pra edhe Universiteti, sikur edhe shumë institucione të fuqishme, ato dalin si rezultat i planifikimeve, nevojave dhe mundësive, pra, të mos dalin në emocionet e fushatave. Ne e dimë që edhe këto janë propozuar dhe kanë dalë të qëlluara. Çka nëse nesër nxehemi në fushata dhe fillojmë ta propozojmë universitete dhe komuna ku të shkojmë e të shohim që i kemi punët pak më ligshat dhe nëse na ndikon në votë të fillojmë të propozojmë universitete? Pse ministri tash nuk e sjell një planifikim dhe të themi për vitin 2013, s'është e paraparë, viti 2014, 2015, dhe ta kuptojmë se cila është strategjia dhe cila është perspektiva e universiteteve, sa është kostoja, cilat janë rezultatet, sepse ka edhe një mospërputhje deri sa Universiteti i Prishtinës, është i stërngarkuar, ka mungesë të kushteve, ne po propozojmë në secilin qytet, apo ndoshta ky është qëllimi, dekoncentrimi i studentëve, konsiderohet se Universiteti i Prishtinës, do të jetë komod. Pra, të gjitha këto, unë nëse jo sot, ministrit, do të kisha dëshirë shumë shpejt dhe atë para se të dihen datat e zgjedhjeve, cilat do të jenë planifikimet për universitete?

Përndryshe, po të jetë për ashtu, po sot ta dini, më shumë kemi për të premtuar ne se sa ju, sepse u mësuam çka domethënë për të premtuar e për të mos realizuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi e ka fjalën.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministër,

Të nderuar deputetë,

Duke qenë se jetoj në Prizren, unë dëshiroj që t'i vlerësoj të gjitha shqetësimet që u ngritën për proceset e fillimit të ndërtimit të institucioneve arsimore edhe në Pejë e në Prizren, po nëse do të kisha mundësi të zgjedh ndërmjet shqetësimeve që u ngritën dhe emocioneve, e përmallimit siç u tha, i profesor Eqremi për Universitetin e Prizrenit, unë iu kisha bashkëngjitur emocioneve të komshiut tim profesor Eqremi, prandaj ju ftoj të gjithëve, që ta ratifikojmë vendimin për themelimin e këtyre universiteteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Dua të flas pak për dy gjëra, të cilat i kam paraqitur edhe në mbledhjen e Qeverisë të vitit 2009, kur është biseduar për këtë, jo për të shprehur emocion, jo për të kujtuar, rikujtuar premtimet e kryeministrit Thaçi, jo për t'ia vrarë veshin dikujt me atë mentalitetin provincial për të përmendur diçka, por diçka që unë e kisha quajtur si strategji nacionale në zhvillimin e arsimit, që duhet ta ketë Qeveria e Republikës së Kosovës.

Hapja e Universitetit në Gjilan, për dy arsye, për zbutjen e diskriminimit që ekziston në atë pjesë nga politika diskriminuese të kufijve në Luginën e Preshevës, atje dhe pjesën e Maqedonisë, që u tha këtu edhe në pjesën e paradites dhe u përsërit sot, por këtë po e them duke e quajtur si politikë nacionale, duhet të mendohet mirë kush përfiton në atë pjesë. Dhe, e dyta që po ashtu mendoj që prek politikën nacionale, është që edhe e kam përmendur në mbledhjen e Qeverisë të vitit 2009, ka qenë që duke e parë kompleksitetin e trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe duke ditur rajonin e Prizrenit që është i pasur me trashëgimi kulturore, do të ishte mirë që Universiteti i Prizrenit, ta kishte edhe të veçantën e vet dhe më konkretisht të hapet drejtimi për trashëgiminë kulturore, që është më se e nevojshme thashë për ta zbutur këtë kompleksitet të kësaj fushe në Kosovë, e nevojshme që të kemi kuadër në këtë drejtim, që të ketë studiues më shumë në këtë fushë edhe aq më tepër që jemi afër edhe me kufirin e Shqipërisë, që do të ndihmohet edhe me plotësim të kuadrit që të plotësohet kjo.

Mendoj është një propozim që duhet të mendohet dhe do ta pasuronte mjaft Universitetin e Prizrenit dhe për fund uroj që të kenë punë të mbarë, ani se kanë mjaft minuse, me kalimin e kohës, besoj se do të jenë në rrugën e mbarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit,

Të nderuar deputetë,

Hapja e universiteteve në Kosovë është një e mirë që neve na afron përparësi në raport me vendet tjera edhe ofron mundësi që edhe përmes vendeve që janë rreth nesh, t'u ofrohen mundësi njerëzve që të punojnë, që të aftësohen bashkë për të menaxhuar, për të qeverisur, për të administruar me vendet nga vijnë.

Për mua është me interes, domethënë, përshëndes hapjen e këtyre dy universiteteve, por që do të ishte shumë mirë që hapja e universiteteve të përshtatet me mundësitë, me resurset që i kanë regjionet e caktuara me qëllim që ato të bëhen, të japin mundësi që kuadrot e dala nga këto universitete, të kenë mundësi punësimi të shpejtë dhe të jenë kreativë në dhënien e mundësive të zhvillimit dhe të krijimit të mirëqenies sociale për njerëzit. Për mua është të bëjë një thirrje, që është një nevojë e hapjes së universitetit, diku në universitet të Fakultetit të Pylltarisë për shkak se Kosova i ka 42% të sipërfaqes me pyje, kurse ne si Kosovë nuk e kemi një fakultet të tillë, që është një hendikep, një mungesë e madhe.

Po ashtu, mendoj që është mirë të kemi më shumë fakultete të teknologjisë ushqimore për shkak se është një trend në Kosovë që të prodhohet ushqimi, por ky ushqim, për fatin e keq ne po na shkon si i papërpunuar dhe ne nuk po kemi një kohë më të gjatë të furnizimit të tregut me këto ushqime. Po ashtu do të ishte mirë që dikush të kujdeset edhe për shkencat e reja që tash së fundi po zbatohen kudo nëpër botë, siç është ajo e bioteknologjisë e tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Haziri, i fundit.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër, zëvendëskryeministër,

Dua të konfirmoj edhe një herë që Qeveria po del më e fortë, por kohën e transmetimit që duhet ta ketë seanca e ka marrë konferenca që po mbahet në "Gërmia Hill".

Kjo është shumë e rëndësishme, për zotin ministër Buja ta dijë që megjithatë involvimi i deputetëve të ndihmojë që ky proces të finalizohet, të ratifikohet sot mirë, publikut i mbetet të njoftohet më shumë nga ministrit, sepse Kuvendi veç po e përballon këtë situatë ndryshe.

Nën dy, për t'ia ia kujtuar Qeverisë premtimin e mos mbajtur për universitet të Gjilanit. Është një premtim i thënë, ka qenë prioriteti numër një pas Prizrenit, është anashkaluar. Është mirë po ashtu të thuhet që Universiteti i Prizrenit është zbatim i vendimit të Qeverisë së kaluar, sepse veç ka filluar procesi, por është vazhduar nga ju.

Dhe, jam i prirë që të ju kujtoj prapë se nëse fëmijët në shkollën fillore nuk mund të shkojnë për shkak të bindjeve fetare, do të kemi shumë problem të garantojmë studime më të larta.

Zoti ministër, duhet të fillojmë prej ciklit fillor e për të shkuar më lart, sepse qysh është duke ndodhur tash, vërtet jemi skeptikë shumë se jemi kah bëjmë mirë me rolin tonë si deputetë. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri i Arsimit, zoti Buja e ka fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: Zoti kryesues,
Zëvendëskryeministër,
Ministër Mujota,
Të nderuar deputetë,

Meqë u bënë disa pyetje, unë thjesht dola më shumë për t'iu falënderuar për debatin shumë përmbajtjesor, por nganjëherë më ndjeni dhe më kuptoni dhe me kërkim faljeje paraprake, më bëhet sikur nuk jetoni në Kosovë dhe nuk i dini kapacitetet tona si janë dhe flisni në mënyrën dëshirore. Faleminderit shumë edhe për këtë, por problemi është që përse ajo pyetje konkrete që u bë, përse Qeveria dhe përse Ministria...

Në njëfarë mënyre u tha direkt edhe nga zoti Haziri, sepse para tre vjetësh ka marrë vendim Qeveria për themelimin e Universitetit të Prizrenit dhe ai universitet në themelim vazhdon të jetë themelatë e Qeverisë që vjen sot për t'u ratifikuar në Kuvend dhe për ta marrë formën e vet, ndërsa me ligjin e vjetër, me ligjin e ri, e drejta për themelim të Universitetit apo të universiteteve, është e Ministrisë së Arsimit dhe vendimi i ministrit që kalon nëpër Qeveri për t'u ratifikuar në Kuvend.

Një pyetje tjetër që u bë, pa zë emra në gojë, se përse vjen tash kjo e vonuar, ky ratifikim i vonuar? Po çka të ratifikojmë nëse s'kemi të themeluar diçka? Duhet të themelohet, duhet të akreditohet nga Agjencia e Akreditimit, duhet të licencohet dhe të dihet ku jemi dhe për këtë arsye akreditimi ndodh për një vit.

Për këtë arsye nga Agjencia e Akreditimit, ndodh veprimi njëvjeçar i akreditimit për të parë ku i ka pozicionet institucioni. Dhe, tash kemi ardhur në pozicion të një pjekurie të domosdoshme, jo të dëshiruar për t'i realizuar dhe legjitimuar këto dy institucione.

Andaj kemi ardhur në këtë pozicion që unë besoj të gjithë, të mos themi, jemi të lumtur, po të gëzuar besoj shumë, duhet të jemi bashkë, që po i bëjmë këto themelata dhe po i legjitimojmë sot, sepse detyrë e Kuvendit është ta ratifikojë vendimin e Qeverisë dhe të Ministrisë. Kaq.

Dhe, tash çështja tjetër, ku jemi me planet që tha zoti Sadriu? Ne kemi një plan nacional, një plan strategjik që është Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2011-2016, ku kemi përfshirë këtu objektivat tona jofushatore, por e kemi synim që para tetorit ose në tetor të vitit të ardhshëm ta bëjmë Gjilanin. Kemi formuar komisionin, dhe para fushatës do ta bëjmë zoti Ahmeti.

(Ndërhyrje)

Unë nuk e kam thënë, nuk e di që e kam thënë ndonjëherë, do ta bëjmë gjithsesi Gjakovën dhe me një formë shumë specifike, të veçantë, jo si të tjerat, për faktin e një partneriteti publiko-privat që do të jetë nismë e veçantë, do ta bëjmë Mitrovicën dhe pastaj mbyllet cikli i universiteteve dhe besoj të gjithë do të jemi të kënaqur pse i realizuam këto gjëra, këto themelata, këto themelime të këtyre institucioneve që na janë shumë të nevojshme.

I them zonjës deputete Emilija, që të gjitha, ama të gjitha kërkesat e pakicave i kemi përmbushur për regjistrim në të gjitha universitetet, tanimë tri universitetet tona, të gjitha. Unë nuk i di nuancimet politike partiake, të gradave e ç'gradave, por po them të gjitha i kemi përmbushur.

Dhe, çështja tjetër, u tha se ka ligjërues me bachellor. Unë ju them me plot përgjegjësi që nuk ka më, grada më e vogël e ligjëruesit është masteri. Dhe ju lus, singërisht ju lus, që të më gjeni dikë që ka kapacitete për të qenë ligjërues, profesor dhe nuk është i përfshirë, dhe unë ju garantoj që sot se ai do të jetë i përfshirë.

Unë, që më parë, ende pa e bërë votën, ju falënderoj shumë për disponimin e mirë, për diskutimin e mirë, shumë përmbajtjesor, shumë logjik dhe ju lus që ta jepni votën dhe unë jam i sigurt se do ta jepni. Ju falënderoj shumë.

KRYESUESI: Fjalën për replikë e ka kërkuar nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti ministër,
Kam kënaqësi që t'i sqarojmë dy probleme, sepse këtu jemi për të argumentuar, jo për të luajtur me fjalë "muftas", aq më tepër unë e ti që njihemi tash e një shekull.

Problemi i legalizimit dhe problemi i akreditimit janë dy gjëra krejt të ndryshme. Edhe programet ideale, nëse gjenden, pa u legalizuar institucioni nuk mund të akreditohen, pos me kusht. Këtu është problemi.

Prandaj, unë isha me plot gojën që t'i legalizojmë, në mënyrë që të kalojmë në faza tjera të akreditimeve, sepse ato e kanë një akreditim me kusht dhe thuhet saktë në vendim - duhet të bëhen ligjore, që i bie të merret ky vendim, që e marrim tash, dhe tutje të krijohen statutet e tyre dhe të kalojnë këtu. Ende ato s'janë legale, të plota. Pastaj vijnë punët tjera.

Sa i përket punësimit, unë e dëgjova. Po kjo është pak, e them rrëmbim, se edhe po ta kesh dëshirën e krejt dynjasë, ti s'mund ta punësosh askënd, se je ministër. Po them që ti parashikon që ka kushte që më të mirët të hyjnë. Kjo është dëshirore, këtë ta pranoj, sepse edhe po deshe apo s'deshe, nuk mund t'i futësh, se s'e ke atë punë.

(Ndërhyrje)

Po, atje duhet të bëhen konkurse dhe të shkruhen referate, e të hyjnë njerëzit. Dhe, e dyta, kjo puna e profesorëve që shkojnë. Këtu janë dy ministra, a e dinë ata që japin mësim në

Universitet të Pejës, për shembull, po më intereson mua? A e dinë që janë profesorë në Universitetin e Pejës? Dy ministra. Kush? E dinë ata. Unë e di kush janë ata emra.

Pse e them, sepse universitetet janë duke nxjerrë emra formalë të njerëzve për të mbuluar tituj, e ata as që e dinë, as që mbajnë orë. Këtu është ajo që unë po kërkoj - seriozitet. Faleminderit, zoti ministër!

KRYESUESI: Kundër-replikë, ministri Buja.

MINISTRI RAMË BUJA: Këto janë gjëra elementare që duhet të sqarohen. Kuvendi nuk e themelon Universitetin, e themelon Ministria, përkatësisht Qeveria dikur me ligjin e vjetër dhe ratifikohet vendimi i Ministrisë në Kuvend.

Atëherë, tash konsiderohet legale kjo punë, por, megjithatë, çka të legalizojmë ne nëse s’kemi themeluar kurrgjë, s’kemi akredituar kurrgjë, s’kemi licencuar kurrgjë. Çka të themelojmë, çka të ratifikojmë? Kështu që, unë ju falënderoj shumë.

(Ndërhyrje - reagime)

KRYESUESI: Konstatoj që debati është shteruar. Ismet Beqiri është paraqitur. Armend, a do të flasësh?

(Ndërhyrje)

Në rregull, konstatoj se në sallë janë 75 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! Konstatoj se me 72 vota për, 1 abstenim, asnjë kundër, Kuvendi e ratifikoi vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universitetit “Ukshin Hoti” të Prizrenit dhe të Universitetit “Haxhi Zeka” të Pejës. Faleminderit!

Pika e dhjetë e rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, gjegjësisht zëvendëskryeministrin zotin Kuçi, edhe ministër i Drejtësisë, që ta sqarojë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Sipas kompetencave që ka Ministria e Drejtësisë, unë kam propozuar në Qeverinë e Kosovës dhe pastaj Qeveria e ka propozuar në Kuvendin e Kosovës, Komisionin për Jurisprudencën. Ne kemi propozuar kohë më parë këtë komision dhe natyrisht që kemi pasur parasysh që për një kohë, ka disa muaj që nuk funksionon për shkak se i ka skaduar mandati.

Në anën tjetër, më lejoni që përveç emrave që i keni ju të gjithë këtu, të them se gjatë propozimeve i kam respektuar disa kriterë. Kriteri i parë ka qenë që njerëzit kompetentë për provimin që do ta mbajnë dhe kompetencën e kam bartur mbi dy baza. E para, njerëzit kompetentë në kuptimin praktik që ushtrojnë profesione për çështje të tillë dhe këtu kemi propozuar kryetarë të Gjykatës Supreme, Gjykatës Ekonomike apo të tjerë që janë kompetentë për trajtimin e atyre lëndëve, duke bashkuar me atë që janë kompetentë në aspektin teorik. Dhe, nëse i shihni, me përjashtim të një lënde që është tërësisht teorike, të gjitha të tjerat e kanë një përfaqësues të asaj që unë e quaj, jep lëndë praktike dhe tjetri që jep lëndë teorike.

Po ashtu, kam përfaqësuar mendimin e njerëzve edhe për respektimin e barazisë etnike. Me ligj është e paraparë që duhet të ketë anëtarë edhe të komuniteteve jo shumicë dhe jam i bindur që ky komision do të jetë adekuat për ta kryer punën e vet dhe njëkohësisht do ta mandatoj që të bëjë përgatitjen edhe për doracakun e ri për këtë provim, pasi tanimë është miratuar Kodi Penal i Procedurës Penale dhe të tjerët.

Ju ftoj që pas miratimit që e ka bërë edhe Komisioni, ta miratoni edhe ju. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit Funkcional, si duket është i ngarkuar lidhur me këtë zoti Zemaj, apo zoti Selimi?

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë i kam dy alternativa, njëra e gjatë ta lexoj gjithë materialin dhe e dyta e shkurtër, por nga droja që mbetemi pa kuorum, po i bie shkurt. Komisioni për Legjislacion i ka rekomanduar Kuvendit që të aprovohet propozimi të cilin e kanë përpara, për të gjithë kandidatët, konsideron që janë kompetentë, prandaj ju ftoj që ta aprovon. Kaq.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Ne si Grup Parlamentar, duke marrë parasysh rëndësinë që e ka provimi i jurisprudence dhe reforma në sistemin e drejtësisë, kemi shqyrtuar dokumentacionin veç e veç të secilit kandidat të propozuar për anëtarë dhe zëvendës-anëtarë të Komisionit, si dhe për sekretarin e tij dhe konstatojmë se i plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj për të qenë anëtarë dhe zëvendës-anëtarë të Komisionit, prandaj edhe vota jonë është për. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Vetëvendosje”, e ka fjalën zonja Gashi.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryesues!

Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do t’i votojë emrat e kandidatëve të propozuar nga Ministria e Drejtësisë, për shkak se ne e kemi bërë të qartë qëndrimin tonë rreth organizimit të provimit të jurisprudencës gjatë kohës sa është shqyrtuar ky projektligj.

Aktualisht, komplet procesi për dhënin e provimit të jurisprudencës varet nga ministri i Drejtësisë e për ne është e papranueshme, pasi nënkuptohet si ndërhyrje e ekzekutivit në tërë procesin. Qëndrimi ynë është se do të duhej të hartoni një ligj, i cili do të themelonte një shkollë të veçantë për këtë çështje, shkollë e cila do të kishte këshillin e saj drejtues në përbërje të së cilës do të duhej të ishte: kryetari i Gjykatës Supreme, Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial, dekani i Fakultetit të Drejtësisë dhe drejtuesi i Odës së Avokatëve.

Pra, këto janë disa nga arsyet për të cilat ne nuk do t’i votojmë këta kandidatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës i ka shikuar me kujdes CV-të e kandidatëve, prandaj do t’ua japë votën për.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Zoti Kuçi dëshiron të flasë.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit! Desha vetëm një sqarim për zonjën apo zonjushën Gashi.

E para, dua të them që ky është propozim me ligjin e vjetër, jo me këtë që është në procedurë, dhe këtu e keni një shkarje.

Dhe e dyta, duhet të them që në Kosovë është një Institut Gjyqësor i Kosovës, që është tërësisht apo qind për qind i pavarur nga Ministria e Drejtësisë dhe po ju njoftoj që kam dhënë propozim që të themelohet Akademia e Drejtësisë, me kryetar të Komisionit, kryetarin e Gjykatës Supreme.

Për informatën tuaj, në këtë komision, që për opinionin publik është anëtar i Komisionit kryetari i Gjykatës Supreme, është anëtar i Komisionit, kryetarja e Gjykatës Ekonomike, që besoj e njihni mirë, është anëtar dekani i Fakultetit Juridik, është anëtar - përfaqësuesi apo nënkryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës, janë njerëzit më kompetentë që unë kam mund t’i gjej. Besoj se edhe ju po të ishit i kishit gjetur vetëm këta ose më të këqij, por jo më të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në sallë janë 70 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 61 vota për, 5 vota kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e formoi Komisionin për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, në këtë përbërje:

- Doktor Fejzullah Hasani, anëtar i Komisionit, pyetës për lëndën e Drejta Penale;
- Zëvendës-anëtar i Komisionit, doktor Bajram Ukaj;
- Adem Vokshi, anëtar i Komisionit pyetës për lëndët E Drejta Civile, Materiale e Procedurale, Familjare, Trashëgimore dhe e Drejta Detyrimore, zëvendës-anëtar i Komisionit; doktor Haxhi Gashi.
- Suzana Sejdiu, anëtare e Komisionit, pyetëse për lëndën E Drejta Tregtare, Ekonomike, doktor Korab Sejdiu, zëvendës-anëtar i Komisionit
- Profesor doktor Ivan Çukallovqi, anëtar i Komisionit, pyetës në lëndën Primet, struktura kushtetuese dhe organizimi i gjyqësorit; doktor Visar Morina, zëvendës-anëtar;
- Meleqe Behxheti, anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndës E Drejta e Punës; mr. Rafet Haxha, zëvendës-anëtar
- Profesor doktor Merlida Batalli, anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndës E Drejta Administrative; Nebojsha Boriçi, zëvendës-anëtar;
- Asllan Bilalli, anëtar i Komisionit, pyetës i lëndëve E drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane për të Drejtat e Njeriut, doktor Qerim Qerimi, zëvendës-anëtar, dhe
- Elbasan Dervishi, sekretar i Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës.

Mandati i të emëruarve zgjat dy vjet, sipas nenit 7, pika 5 e Ligjit.

Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas

Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 11 dhe 12 pika 3 të Ligjit numër 04/L-017 për ndihmë juridike falas, i ka shqyrtuar propozimet për emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional, Arben Gashi, për ta arsyetuar raportin.

(Ndërhyrje)

Atëherë, zoti Selimi, si zëvendës.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Po ashtu, po them në mënyrë të shkurtër, rekomandimet u janë dorëzuar me kohë deputetëve dhe rekomandimi i Komisionit thotë se kandidatët të emërohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike i kemi shqyrtuar të gjitha materialet dhe e mbështetim propozimin e Qeverisë dhe kandidaturat.

KRYESUESI: Zoti Zemaj, nga LDK-ja, e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Në fakt, Këshilli për Ndihmë Juridike Falas, të emëruarit vijnë nga dikasteret e ndryshme, siç janë: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Oda e Avokatëve, Gjykata Supreme dhe nga OJQ.

CV-të e kandidatëve dhe të tjerëve, të cilët i ka eliminuar Komisioni, sepse ne kemi bërë përzgjedhjen nga 3 kandidatë të propozuar nga këto organizata, si Grup Parlamentar mendojmë se Komisioni e ka kryer punën e vet në mënyrën më të mirë të mundshme dhe konform ligjit në fuqi, prandaj edhe vota jonë është për.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Edhe ne do t'i votojmë këta kandidatë dhe mendojmë që i kanë plotësuar kushtet dhe e plotësojnë këtë komision shumë të nevojshëm për qytetarët e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës do ta japë votën për.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Në sallë janë 71 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Konstatohet se me 67 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi emëroi anëtarët e Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, me mandat trevjeçar, si në vijim:

- Alban Sutaj, Ministria e Drejtësisë;
- Fadil Racaj, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Nenad Stojçetović, Ministria për Komunitete dhe Kthim;
- Bahrije Berisha, Ministria e Financave;
- Armend Krasniqi, Oda e Avokatëve të Kosovës;
- Afrim Shala, Gjykata Supreme e Kosovës;
- Shukrije Gashi, OJQ "Partners Kosova".

Me kaq po i mbylлим punimet e mbledhjes. Mirupafshim në mbledhjen e ardhshme!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë